

FEJZI BOJKU - ZIHNI OSMANI

GJUHA
SHQIPE
4

për klasën e 4-të të arsimit fillor 9-vjeçar

Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë
SHKUP - 2009

Për botuesin:?

Redaktor: ?

Recensentë:

Hasan Hoda,

Gëzime Shehu,

Beije Ajrullai,

Me vendim të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës së Republikës së Maqedonisë nr..... të datës..... lejohet përdorimi i këtij libri në klasën e katërt të shkollave fillore nëntëvjeçare të Republikës së Maqedonisë

GJUHA SHQIPE 4



SHKOLLA JONË

Porsi zogjtë n'çerdhen e vet
Ne kthehemi përsëri,
Të freskuar – gaz e shëndet,
Ti na pret me dashuri.

Erdhëm, erdhëm, shkolla jonë
Shkoi vera dhe pushimet,
Zëri i zileve po jehon
Përsëri nisin mësimet.

Mësuesja jonë, ja ku jemi!
Si një nënë të kemi sy,
Fjalët tua s'i harruam
Ne kudo folëm për ty.

Erdhi vjeshta, zverdhi gjethet
Shpezët ikin me shpejtësi,
Ne tubohemi nga çdo anë
Ta kthejmë jetën përsëri...

Fejzi Bojku



BISEDË RRETH VJERSHËS

Si ndjehesh në fillim të vitit shkollor?
Pse ndjehesh i gëzuar në ditët e para të vitit shkollor?
Çfarë ngjyrë marrin gjethet në vjeshtë?
Cilat shpezë ikin në vjeshtë dhe pse?
Çka kupton nga dy vargjet e fundit:
“Ne tubohemi nga çdo anë
Ta kthejmë jetën përsëri...”



DETYRË

Mësojeni vjershën përmendësh!



DITA E PARË E SHKOLLËS

Sot është dita e parë e shkollës. Tre muajt e pushimeve kaluan nëpër fusha e kodra si nëpër ëndrra. Sot në mëngjes shkova me mamanë në shkollë që të regjistrohesh në klasën e katërt. Udhët e qytetit zienin nga zërat e fëmijëve që mbanin çanta në duar. Libraritë ishin mbushur me prindër që blinin libra e fletore për fëmijët e tyre. Edhe përpara shkollës kishte aq njerëz, sa mezi hymë brenda. Në korridore pashë plot prindër që bisedonin me mësuesit, nxënës që qeshnin me njëri-tjetrin; mësues me regjistra në dorë që kalonin nga një klasë në tjetrën. Mësuesja ime e klasës së tretë më përshëndeti te dera dhe tha:

- Enrik, sivjet do të shkosh në katin e sipërm dhe do të kesh një mësues tjetër, - dhe më shikoi me trishtim. Edhe unë u trishtova. Pranë nesh, drejtorin e kishin vënë në mes disa mama shumë të mërzitura. Ato nuk gjenin vende të lira për fëmijët e tyre. Disa nga shokët ishin zgjatur dhe shëndoshur. Vetëm në orën dhjetë arritëm të futemi në klasë. Gjithsejt ishim pesëdhjetë e katër veta. Ndërsa mësuesi i ri filloi mësimin, unë mendoja me vete: “Sot është dita e parë. Edhe nëntë muaj të tjerë! Sa punë e sa provime do të kemi!”

- Kur dola nga shkolla, po më priste mamaja. Ajo e kuptoi shqetësimin tim dhe më tha:

- Guxim e zemër, Enrik. Edhe unë do të të ndihmoj.

Fjalët e saj më gëzuan. Por përsëri ndihesha i trishtuar që nuk do të kisha më mësuesen time.

Edmond de Amicis



FJALË DHE SHPREHJE

u regjistrova në shkollë – shënova emrin në listën e nxënësve.
ç'vuri re rrugës – ç'diktoi, çfarë pa rrugës.
udhët zienin nga zërat – rrugët ishin plot me njerëz.
shokët ishin zgjatur – shokët ishin rritur.



BISEDË RRETH TEKSTIT

Djali me kë shkoi ditën e parë në shkollë?
Çfarë i tha Erikut mësuesja?
Çfarë vuri re Eriku rrugës, po në bibliotekë, po në shkollë?
Kush e priste djalin në shkollë?
Çka i tha Erikut mamaja?



DETYRË

Shkruani në fletore si e ndjenit veten ditën e parë në shkollë?



NJOHIM GJUHËN TONË

TEKSTI DHE FJALIA

Lexoni tekstin e mësipërm dhe vëreni me kujdes si janë radhitur fjalitë.

Rikujtobuni!

Nga ky tekst po veçojmë disa fjali:

Sot është dita e parë e shkollës. Tre muajt e pushimeve kaluan nëpër fusha e kodra si nëpër ëndërr. Sot në mëngjes shkova me mamanë në shkollë që të regjistrohesha në klasën e katërt.

Thoni me se kanë filluar dhe me se kanë mbaruar këto bashkësi fjalësh.

Ç'shpreshin ato?

Po kur lidhen njëra me tjetrën, ç'formojnë ato?

Çdo gjë që ne e shohim ose e mendojmë mund ta tregojmë ose ta shkruajmë me një ose me shumë fjali, që lidhen sipas kuptimit me njëra-tjetrën.

T'i lexojmë dhe t'i analizojmë vargjet e strofës së dytë të vjershës “Shkolla jonë”.

Çdo varg shpreh një mendim të caktuar. Ai përbëhet nga fjalë dhe kështu formojnë fjali. Fjalitë lidhen me njëra-tjetrën dhe formojnë një tekst.

Si në fjalitë e tekstit, ashtu edhe në vargjet e vjershës fjalët janë bashkuar sipas rregullave të gjuhës shqipe dhe kështu kanë formuar fjali. Por kur fjalitë bashkohen në një tërësi formojnë një tekst.



MBANI MEND

Fjalja përbëhet nga një ose më shumë fjalë dhe shpreh një mendim të caktuar.

Teksti përbëhet nga një ose më shumë fjali, sipas kuptimit, që lidhen me njëra-tjetrën dhe shpreh një kuptim të plotë.



USHTRIME

1. Bashkoni fjalitë e mëposhtme në një tërësi kuptimore:

Drini kalonte ngadalë dhe qetë.

Ai di të bëhet edhe i rrëmbyeshëm.

Uji i tij ishte i kaltër si në të errët.

Në të notonin peshqit e vegjël. Kur rrotullohej ndonjë peshk, shkëlqente nga dielli sikur të ishte prej argjendi.

2. Lexoni tekstin e mëposhtëm dhe dalloni ato që nuk janë fjali.


Zilja ra. Nxënësit po rreshtohen. Ne korridor ka shumë lëvizje. Shumë nuk e dinë nxënës ende klasën. Këta janë nxënësit e rinj. Ata vijnë përherë. Mësuesit thërresin emrat. Filloi viti i ri shkollor.

3. Formoni fjali me këto grupe fjalësh:

a) Shkolla ime, nxënës i rregullt, shkollë e re,

korridor i gjerë, kopsht shkollor, mjet mësimor.

b) ditëlindja e Artës, Arta e vogël, përgatitet për ditëlindje
thërras shokët e shoqet rregulloj dhomën i ndihmoj nënës.



DORA E NJERIUT

Asnjë ndërtesë në atë qytet nuk mund të krahasohej me të. Kishin vendosur njerëzit ta ngrinin deri lart, afër resh.

Ata sollën vinça të mëdhenj dhe nisën ta çonin lart kat më kat.

Një ditë prej ditësh, kur punëtorët majë godinës dukeshin fare të vegjël, kaloi mbi ta Reja e Zezë, e ngarkuar plot e përplot me shi. Kur e pa këtë godinë që kishte ngritur kokën aq larg, qeshi me të madhe sa bubulloi tërë qielli:

- Po ti na qenke një ndërtesë mendjemadhe, oj! – i tha pastaj me një habi të papërmbajtur.

- Ndërtesa ku punonin punëtorët e dëgjoji me vëmendje dhe ia ktheu pa u trazuar:

- Unë nuk jam ndërtesë, oj Re e Zezë. Mua më quajnë Rrokaqiell.

Reja e zezë qeshi sërish. U lëkund sa andej e këndej nëpër atë kaltëri të gjerë:

- Ani çka?! – i tha me të qeshura e me të dridhura, sa gati duke iu derdhur tërë uji që e kishte përpirë. – A nuk e ditke ti se rrufetë që shkrepin nga unë mund të të rrafshojnë për tokë? Sa më shumë që ngre kokën përjetë, aq më në rrezik e ke jetën.

Rrokaqielli nuk u brengos as tash. Iu përgjigj me zë të qetë:

- Mua më ngre dora e njeriut, oj Re e Zezë. Ajo është më e fuqishme se ti.

- Ah, dora e njeriut! – u habit Reja e Zezë. Shkreptimat e mia mund ta lënë njeriun edhe pa atë dorë. Nuk i ditke ti huqet e mia kur gjuaj nga lart?

- Të kam parë disa herë. Megjithatë nuk të frikësohem, oj Re e Zezë. Për mua kujdeset dora e njeriut.

Reja e Zezë u hidhërua.

- Do të më shohësh, pra! Vetëm sa të thërras edhe disa shoqe. Do të shkrepim qindra vetëtima mbi ty!

Rrokaqielli qeshi i qetë dhe tha:

- Mos harro, oj Re e Zezë, dora e njeriut do të vërë mbi mua rrufepritësin. Kot lavdërohesh dhe kot më kërcënohesh. Me atë rrufepritës unë do të rrëmbej ty e do të të fus në fund të tokës. S' ke ç'më bën, ta dish!

Reja e Zezë murmuriti me hidhërim dhe u nis t'i gjejë shoqet e saja. Ndërsa rrokaqielli i pa me kënaqësi punëtorët, që e ngrinin dhe e bënin aq madhështor me duart e tyre të fuqishme.

Qamil Batalli



FJALË DHE SHPREHIJE

vinç-i – makinë e fuqishme që lëviz dhe përdoret për të ngritur lart pesha shumë të rënda.

rrokaqiell ose prekaqiell i thonë një ndërtesë të lartë shumëkatëshe.

kaltëria – hapësirë e gjërë e kaltër.



BISEDË RRETH TEKSTIT

Pse nuk u frikësua fare rrokaqielli nga reja e zezë?

Çka kishte vënë dora e njeriut në majë të rrokaqiellit?

Pse është aq e fuqishme dora e njeriut?



DETYRË

Gjej dhe nënvizo në tregim disa fjalë të formuara prej dy fjalësh, si p.sh. mendjemadhe (mendje+madhe).

Njohim gjuhën tonë

GJUHA E FOLUR DHE GJUHA E SHKRUAR

Kujtohuni në atë që keni mësuar më parë.
Si mund të merremi vesh me njëri – tjetrin?
Me se do të shërbehemi?

Nëse duam të themi diçka, që të na marrin vesh të tjerët, atë mund ta shprehim me të folur ose me të shkruar. Në të dyja rastet do të përdorim fjalët. Kështu, p. sh., Arta duke e parë dallëndyshen që po ndërton folenë thotë :

Dallëndyshja e bukur
po ndërton folenë.

Arbana shkruan:
*Dallëndyshja e bukur
po ndërton folenë.*

Fjalët që i thotë Arta i dëgjojmë. Fjalët që i shkruan Arbana i shohim.

Kur flasim shqiptojmë ose (dëgjojmë) tinguj dhe kur shkruajmë shohim shkronja.

Si tingujt, ashtu edhe shkronjat janë bashkuar dhe kanë formuar fjalë. Me anë të fjalëve të radhitura, sipas rregullave të caktuara të një gjuhe, formojmë fjali e kështu shprehim mendimet tona, pra komunikojmë.



MBANI MEND

Komunikimi bëhet me gojë ose me shkrim. Me anë të tij japim porosi (mesazhe) të ndryshme.



Naim Frashëri

GJUHA SHQIPE

Vëllezër shqiptarë,
Qasuni. Më dëgjoni,
Sa të mundni më parë,
Gjuhën tuaj mësoni!
Pa shihni sa është e mirë!
S'u vjen mall e dëshirë?

GJUHA SHQIPE

Vëllezër shqiptarë,
Qasuni. Më dëgjoni,
Sa të mundni më parë,
Gjuhën tuaj mësoni!
Pa shihni sa është e mirë!
S'u vjen mall e dëshirë?
Gra, burra, djem e vasha,
E ju pleqt' e uruar,
Mos rrini pa mësuar,
Kjo do të na nderojë,
E do të na bashkojë.
Këtë gjuhë, që flasim,
Këtë zë të këndojmë,
Gjënë tënë të qasim.
Ju shkëmbenj e ju male,
Ju brinja e bregore,
Dhe ju lumenj ngadale,
Ju fusha gjelbërore
Shqip të flisni përherë
Thjesht' e të papërzjerë!
Edhe bilbili vetë
Këtë gjuhë të ketë!

Naim Frashëri



FJALË DHE SHPREHJE

qasuni – afrohuni.

brinja – shpat bjeshke, mali.



BISEDË RRETH VJERSHËS

Pse gjithkujt i duket aq e ëmbël gjuha e vet?
Sipas poetit kush mund të na nderojë?

Poeti ynë i shquar, Naim Frashëri, ka shkruar shumë libra për të rritur, por ai i ka dashur shumë edhe të vegjëlit. Prandaj edhe për ta ka shkruar shumë vjersha e tregime.



DETYRË

Librin “Të vegjëlit” nga Naim Frashëri gjeje dhe në të lexo edhe vjersha të tjera.

Mësoje përmendsh këtë vjershë!



HARTIMI

Shkruaj hartimin
gjithnjë me frikë,
hutohem e s' di
ku duhet vënë pikë.

Dridhem e dridhem
e shtohet frika,
s' më bie ndërmend
as për dy pika.

Për notë të mirë
sa herë kam shpresë,
fare e harroj
të gJORËN presë.

Shpejt ikën koha
o, ç' po trishtohem,
me pikëpyetësin
a do t' takohem?

Ku m' je pikëthirrës,
mëshirë or burrë,
më rrjedhin djersët
porsi një gurrë!

Lëvizë në bankë
porsi një plesht
me germë t'vogël
nisi n'kryerresht.

N'oborr të shkollës
jam porsi tigër
n'orë të hartimit
as sa një kitër?

Rifat Kukaj



BISEDË RRETH VJERSHËS

Ka nxënës që nuk dinë t'i shënojnë mirë shenjat e pikësimit. Për një nxënës të tillë e ka shkruar edhe poeti këtë vjershë, që ju bën më tepër të qeshur.

Pse kish frikë nxënësi?

Çfarë krahasimi bën poeti në strofën e fundit?

Po ti, a di t'i shënosh ku duhet shenjat e pikësimit?



DETYRË

Bëj edhe ti një hartim, dhe përdori si duhet të gjitha shenjat e pikësimit. Pastaj pyete mësuesin a i ke shënuar si duhet ato.



Njohim gjuhën tonë

DREJTSHKRIM

SHENJAT E PIKËSIMIT

Lexoni me vëmendje vargjet e vjershës së mësipërme dhe tregoni se çfarë shenjash ka përdorur poeti .

Rikujtohuni !

Çfarë shenjash përdoren në fund të fjalive ?

A përdoren edhe shenja të tjera pikësimi përveç këtyre që ka përdorur poeti në këtë vjershë?

Lexoni me vëmendje tekstin e mëposhtëm dhe vëreni shenjat e përdorura.

Djaloshi dukej që që zgjatur kohët e fundit : këmbët e pantollonave mezi i çiknin këpucët, mëngët e xhaketës i rrinin të shkurtra.

Ylberi është një nxënës i mirë. Ai mëson në shkollën fillore “Liria“, në Shkup.

Kushriri i tij jeton në Strugë. Ai është nxënës i klasës së tretë në gjimnazin “Ibrahim Temo“, në Strugë.

Në këtë tekst janë përdorur këto shenja pikësimi: presja, dy pikat dhe thonjëzat. Po ka edhe shenja të tjera që përdoren brenda një teksti, si: pikëpresja (;), kllapat (), viza (-) etj.



MBANI MEND

Në thonjëza (“ “) vihen titujt e veprave, gazetave, revistave, shkollave, rrugëve etj.



USHTRIME

1. Plotësoni fjalitë dhe vini aty ku duhet thonjëzat.

Unë jetoj në rrugën _____

Vëllai im mëson në shkollën _____


Në televizor pashë filmin _____

2. Kopjoni fjalitë dhe vini shenjat e pikësimit.

Kaluan ditët e nxehta Dita e parë e shkollës filloi

Sa brohoritje e madhe dëgjohet Paskan ardhur disa nxënës të rinj. Sa qenka rritur Arditi

Cili është atje A kanë ardhur të gjithë



DEGA E HARDHISË

Petriti mbante i mërziur në duar një degë hardhie.

- Ah, ç'desha që renda aq shumë! – thoshte ai me vete. – Pse nuk pashë hardhinë e pastaj të hidhja këmbën! Pse? Po edhe ai lepurushi, sa i prapë që është! Do t'ia shkul veshët ndonjë ditë. Nuk e di ai se është kopshti i shkollës, se këto hardhi mezi i kemi mbjellë vjet!? Sikur e kemi lënë pa ngrënë!

Dora me të cilën mbante degën e hardhisë, iu lag nga lëngu i hollë që pikonte pika-pika. Dhe aty iu kujtua përsëri ajo që kishte ndodhur.

- Po si t'ia bëj tani? A ta lë degën e hardhisë këtu?

Hodhi vështrimin përreth e u bind se nuk e kishte parë njeri. “Sikur të iki, askush nuk do ta marrë vesh që isha unë”, mendoi.

Po, s'i erdhi mirë kur mendoi kështu dhe tha me vete: “S'bën ta fsheh gabimin. Unë jam fajtor”.

Petriti hodhi hapat ngadalë, doli nga vreshta dhe u drejtua për në shkollë me degën e hardhisë në dorë. Te hyrja e pa mësuesin.

“Si t'ia them mësuesit?! Ai do të më qortojë. Po më mirë të them të vërtetën se sa t'ua hedh fajin shokëve”, thoshte me vete Petriti.

- Petrit, kush e theu atë degë? – pyeti mësuesi, kur e pa.

Djali uli kokën dhe nuk u përgjigj menjëherë. Pastaj tha me ndrojtje:

- Unë...

- Si? Ti e këpute degën e hardhisë?... Shih, shih, kjo paska zënë rrush!

Petriti kokulur vazhdoi:

- Kur i hodha ushqim lepurit, ai doli nga kafazi, u hodh në kopsht dhe filloi të hante degët. Unë renda pas tij për ta kapur, por duke vrapuar, shkela hardhinë dhe kjo u këput. –Kaq tha ai dhe vështroi

mësuesin.

Mësuesi i vuri dorën në sup dhe i tha:

- S' ka gjë, Petrit, kjo ndodhi pa dashur. Tjetër herë besoj se do të tregohesh më i kujdesshëm...

- Po, shoku mësues, - u përgjigj si i lehtësuar nga një barrë e rëndë.

Sulejman Fuga



FJALË DHE SHPREHJE

hodhi vështrimin përreth – shikoi rreth e rrotull.

s'i erdhi mirë kur mendoi kështu - u pendua që mendoi në atë mënyrë.
me ndrojtje - me frikë



BISEDË RRETH TEKSTIT

Pse nuk i erdhi mirë Petritit, kur mendoi ta fshihte gabimin e vet?

Ç'mendon ti për këtë veprim të Petritit?


Ç'mësim nxjerrim nga ky tregim?



DETYRË

Përpiqu ta ndash këtë tregim në pjesë dhe shënoje me nga një pikë planin për secilën pjesë.

Lexoje me ton të duhur atë pjesë ku tregohet pendimi i Petritit për pakujdesinë që ka treguar.



DHEU ËSHTË FLORI

Një bujk plak, para se të vdiste, thirri tre djemtë e tij dhe u tha:

- O bijtë e mi. Në arën para shtëpisë unë kam punuar gjithë jetën time dhe me drithin e saj ju kam ushqyer e ju kam sjellë gjer në këtë vërsë.

Tamam në këtë arë kam fshehur një qyp me florinj. Mihni thellë dhe kërkoni në të gjitha anët e saj për ta gjetur qypin, që pastaj të mos hiqni varfëri kurrë.

Të tre bijtë e plakut, pas vdekjes së babait, zunë ta gërmonin arën në të gjitha anët. Ata e gërmonin dheun dhe mot për mot e thellonin nga një pëllëmbë më tepër. Po qypin përsëri nuk e gjenin dot.

Sa më shumë që e punonin arën, aq më tepër prodhime jepte ajo. Nga prodhimet e saj vëllezërit jo vetëm që jetonin, por u tepronte shumë edhe për të shitur. Të hollat që merrnin nga prodhimet e shitura i hidhnin në një qyp për t'i kursyer.

Për pesë vjet qypi u mbush plot me florinj. Vetëm atëherë vëllezërit e kuptuan se ku ishte qypi me florinj, që u tha i ati.

Sami Frashëri



FJALË DHE SHPREHJE

qyp – enë e madhe prej balte.

vërsë – moshë e njeriut.

mihni – gërmoni, punoni tokën.

të mos hiqni – të mos vuani.



BISEDË RRETH TEKSTIT

Ç'u tha plaku djemve?

Çka kish fshehur plaku në tokë?

Me punën që bënë vëllezërit ç'fituan?

Me prodhimin e tyre a e mbushën qypin me flori?

Kur e kuptuan atë që u tha plaku?

Populli: Kush punon - fiton.

NË MANASTIR

Sikur dy flutura të bardha
nëpër livadhe e nëpër ara,
nënë e bir,
shëtisin
nëpër
Manastir...
E një zë sikurse vjen nga mali,
prej fushe
e
are:
- Abetare, Abetare
edhe ne duam
Abetare.

- Nënë, ç'është ky zë?!
Mali, fusha e ara
dëgjon si flet?!

Edhe shqiptarët
e duan
alfabetin e vet!
Me këto shkronja
do të shkruajmë
abetare,
letra
e gazeta.
Me abetare e me libra
më e bukur dhe më
e ëmbël
bëhet jeta.

Ali Huruglica



BISEDË RRETH VJERSHËS

Për cilin qytet bën fjalë poeti?
Çfarë ka ndodhur në këtë qytet?
Cili është libri i parë që mësojmë në shkollë?
Për cilin libër e ka fjalën poeti?
Si e fitojnë njerëzit diturinë?



COMMISSIONE DELL'ALFABETO MONASTIR 1908

Foto Kel Marubi

- | | |
|--|-------------------|
| 1. Presidente P. Giorgio Fishta O. M. | 6. G. Cilka |
| 2. Mid - Frasheri | 7. Taqi Buda |
| 3. Luigi Gurakuqi | 8. Shahin Kolonja |
| 4. D. Qiriaz | 9. Sotir Peci |
| 5. D. Ndre Mjedja | 10. Bajo Topulli |
| | 11. Nyzhet Vrioni |

Anëtarët e Komisionit të Kongresit të Manastirit, v. 1908

Njohim gjuhën tonë

EMRI

Emrat konkretë dhe abstrakë

Në familjen tonë

Katër **çupa**
Dhe një **çun**
Gjyshja, gruaja dhe unë,
Një **shtëpi**,
e mbushim plot!
asnjë **bukën** s'e ha kot!

Ç'emërtojnë fjalët e shkruara me ngjyrë të zezë?

Fjalët me të cilat emërtojnë frymorë a sende ose kuptime quhen emra.

Emrat mund të jenë:

- konkretë, kur i shohim, i prekim;
- abstraktë, kur nuk i shohim, nuk i prekim, por vetëm i marrim me mend (emra kuptimi)

Emrat e përveçëm dhe të përgjithshëm

Lexoni me vëmendje tekstin e mëposhtëm dhe gjeni emrat.

Drita, Vera dhe Agimi po prisnin shokun e tyre, Bekimin. Ata do të shkonin së bashku në qytetin Sarandë për të kaluar pushimet verore. Baloja, qeni i Agimit, i përcolli gjer në fund të rrugës.

Në tekst dallojmë emrat: Drita, Vera, Agimi, Bekimi, Sarandë, Baloja, të cilët tregojnë si quhet një njeri, një send ose një kafshë e

veçantë janë **emra të përveçëm** dhe shkruhen me shkronjë të madhe.

Emrat: shok, qytet, qen, rrugë tregojnë çdo qytet, çdo shok, çdo qen, çdo rrugë janë **emra të përgjithshëm** dhe shkruhen me shkronjë të vogël.

1. Plotëso në fletore fjalitë me emra të përveçëm .

Unë jam (emri / mbiemri) dhe jam nga (qyteti / fshati).

Po ti si quhesh dhe nga je ?

Unë quhem _____ dhe jam nga _____.

TRAJTAT E EMRIT

Kush troket në derë?

- Jeton, shiko kush po troket në derë!
- Baba, **një njeri** po thërret.
- Kush është ai **njeri**, nuk e njeh?
 - Jo baba, nuk e njoh. Kurrë s'e kam parë.
- Baba, cili ishte ai **njeri**?
- **Njeriu** që trokiti në derë ishte babai i Afrimit.

Pse Jetoni thotë një **njeri**, e babi thotë **njeriu**?



MBANI MEND

Emri ka dy trajta: trajtën e pashquar dhe trajtën e shquar. Emri është në trajtën e shquar kur mbaron me mbaresat: **i, u, a, t ose të**.

GJINIA E EMRIT

Një **nxënës** dhe një **nxënëse** e klasës sonë, duke shkuar rrugës panë një **plak** dhe një **plakë**, që mezi po ecnin. Ata u afruan i kapën për **dore** dhe i shoqëruan deri në **shtëpi**.

Në ç'trajtë janë emrat e nënvizuar?

Në trajtën e shquar cilën mbaresë marrin emrat:

- nxënës, djalë, njeri, plak
- nxënëse, klasë, rrugë, dorë, shtëpi.



MBANI MEND

Emrat që marrin mbaresën **i** ose **u** janë të gjinisë mashkullore.
Emrat që marrin mbaresën **a** dhe **ja** janë të gjinisë femërore



USHTRIME DHE DETYRA

2. Lexoni këtë tekst dhe ktheni emrat e gjinisë mashkullore në emra të gjinisë femërore (vetëm ata emra që janë nënvizuar).


Në një kodër gjendet një shkollë e vogël. Në atë shkollë jep mësim **një mësues** i ri. Ai ka shkuar vullnetarisht në fshat bashkë me **një shok** të tij, që punon si **mjek**. Mësuesi dhe mjeku ndihmuan përparimin e fshatit.

3. Formoni çifte duke i lidhur emrat e gjinisë femërore me ata të gjinisë mashkullore.

| | | | |
|-----------|----------|---------|-------|
| motra | babai | lopa | ariu |
| mamaja | gjyshi | arusha | dashi |
| mësuesja | vëllai | ulkonja | kau |
| dentistja | mësuesi | delja | kali |
| gjyshja | dentisti | pela | ujku |

4. Shkruani në trajtën e shquar dhe të pashquar në numrin njëjës dhe në numrin shumës emrat e mëposhtëm, sipas këtij shembulli:

| (një) luan | luani | (disa) luanë | luanët |
|--------------|-------|----------------|--------|
| top | _____ | _____ | _____ |
| djalë | _____ | _____ | _____ |
| mi | _____ | _____ | _____ |
| zog | _____ | _____ | _____ |
| flamur | _____ | _____ | _____ |
| bilbil | _____ | _____ | _____ |
| mik | _____ | _____ | _____ |



NUMRI I EMRAVE

Djali shikon një aeroplan.

Djemtë vizatojnë aeroplanë.

Vajza luan me kukull.

Vajzat luajnë me kukulla.

Dalloni emrat dhe tregoni sa njerëz, sende a kafshë emërtojnë ata.



MBANI MEND

Fjalët që emërtojnë vetëm një frymor apo një send janë emra të numrit njëjës. Fjalët që emërtojnë shumë frymore ose sende janë emra të numrit shumës. Pra, emri ka dy numra; numrin njëjës dhe numrin shumës.

Emrat e përveçëm nuk kanë numër shumës.

1. Shkruani në fletore shumësin e këtyre emrave:

| | |
|---------------------|-----------------------|
| një lule disa _____ | një shtëpi disa _____ |
| lutje _____ | qershi _____ |
| punë _____ | kala _____ |
| vajzë _____ | mollë _____ |
| grua _____ | dorë _____ |

2. Shkruani këta emra të gjinisë femërore në trajtën e shquar të numrit shumës.

| | |
|-----------------|---------------|
| kutia _____ | shtëpia _____ |
| nxënësja _____ | qershia _____ |
| punëtorja _____ | nëna _____ |
| lutja _____ | macja _____ |

Shumësi i emrave të gjinisë femërore

Lexoni vargjet e kësaj vjershe dhe gjeni emrat e gjinisë femërore

Në Manastir

Sikur dy flutura të bardha
nëpër livadhe e nëpër ara,
nënë e bir,
shëtisin
nëpër
Manastir.

Në këto vargje kemi tre emra të gjinisë femërore; flutura, ara, nënë.

Dy emrat e parë janë në numrin shumës, kurse i treti në numrin njëjës.

Disa emra të gjinisë femërore shumësin e pashquar e bëjnë me mbaresën – a, (një) flutur – (disa) flutura, (një) arë – (disa) ara, (një) nënë – (disa) nëna.

Ka edhe emra që në trajtën e pashquar mbarojnë me – e, shumësin e bëjnë njësoj me njëjësin si p.sh.: (një) lule – (disa) lule, (një) mësuese – (disa) mësuese, (një) nxënëse – (disa) nxënëse etj.

Edhe emrat: punë, bukë, bletë etj. nuk ndryshojnë në numrin shumës.



USHTRIME

Shkruani në numrin shumës këta emra:

| Njëjës | Shumës |
|---------------|--------------|
| (një) dritare | (disa) _____ |
| (një) dele | (disa) _____ |
| (një) motër | (disa) _____ |
| (një) vepër | (disa) _____ |
| (një) javë | (disa) _____ |



DREJTSHKRIM

Ktheni në numrin shumës këta emra:

| | |
|-------------|--------------------|
| një hero | disa <u>heronj</u> |
| një mulli | disa _____ |
| një ari | disa _____ |
| një lumë | disa _____ |
| një mi | disa _____ |
| një gjarpër | disa _____ |
| një shkëmb | disa _____ |



MBANI MEND

Ka emra që në trajtën e pashquar në numrin shumës mbarojnë me – nj.

1. Shkruani tekstin në fletore duke i kthyer në numrin shumës emrat në kllapa.

Nga (një shkëmb) të thepisur rridhnin (përrua) të shpejtë. Në rrjedhjen e tyre ishin ndërtuar (një mulli). Fshatarët aty bluanin grurin e tyre. Ujërat e (një mulliri) derdheshin në (një përrua). Përrenjtë derdheshin në (një lumë) dhe të gjithë derdheshin në det.

Sipas këtij shembulli: Nga disa shkëmbinj të thepisur rridhnin përrenj të shpejtë.

Lakimi i emrave

Lexoni fjalitë e mëposhtme dhe gjeni emrat

Gjahtari shkon për gjah. (Kush) Qeni i gjahtarit shkon pas tij. (I kujt, i cilit?)

Gjahtarit i kaloi një lepur pranë, Qeni vrapoi dhe ia solli lepurin gjahtarit shtiu dhe e vrau. (Kujt, cilit) (Kujt)


Gjahtari ia dha lepurin vogëlushit Ai e mori lepurin prej gjahtarit dhe u dhe e përshëndeti me buzëqeshje falënderua. (Prej kujt?) (Kë)

Vëreni me kujdes si është shkruar emri gjahtar në fjalitë e dhëna? A ka të njëjtën formë emri në të gjitha rasat.



MBANI MEND

Ndryshimi i emrit sipas rasave quhet **lakim**. Emrat lakohen në rasia. Gjuha shqipe ka pesë rasia, ato janë: rasia emërore, gjinore, dhanore, kallëzore dhe rrjedhore.



USHTRIME

Lakoni emrat : Jetoni, mësuesi, libri, plaku, vajza sipas shembullit të dhënë.

| Pyetje: | rrënja: | mbaresa: | rasa: |
|------------------------------------|-------------|-----------|----------------|
| Cili? (Cila?) | kaproll -i | emërore | qershia |
| Cilin? (Cilën, kë?) | kaproll -in | kallëzore | qershinë |
| Cilit? (Cilës) | kaproll -it | dhanore | qershisë |
| I (e, të) cilit? (i, e, së cilës?) | kaproll -it | gjinore | i (e) qershisë |
| Prej cilit? (prej cilës?) | kaproll -it | rrjedhore | prej qershisë |

BUKURIA QË VRET

Hana e zbetë, si fytyra e një të vdekuni, kundron nga kupa e qiellës. Kundron botën e maleve të kristalizueme nga bora. Kundron kasollet e kristalizueme të katundit, të cilat as frymë nuk marrin. Të gjitha janë mbështjellë në bardhsin' e borës. Dhe të vret kjo bukuri e bardhë. Vret shpirtin e malësorit siç vret shpirtin e artistit shtatorja e bardhë e ftoftë e një grues së lakuriqët.

E në kasollë, e cila gjëmon nën barrën e borës, derdhen dy ngjyra, kuq e zi. Kuq zjarmi i votrës në mes të kasollës, e zi rrethi. Të zeza, t' errta janë skutat e kasollës, nga dëgjohet blegrim' e mekun e ndoj dalje ose kombona e lopës. Edhe ata i vret bukuria e bardhë. Nga goja u del avulli i afshevet që ngrihen n'ajr, bie mbi qimet e tyne si brymë dhe kristalizoet. Heshtje. Gjithçkafja e kristalizueme. – Një dorë shtrihet, zen një dru, e shpupurish zjarmin. Rropos një botë gacash. Flaka lëpin errsinën e shkëndijat kërcejn nën tra dhe nëpër fytyra rreth votrës. E trupnat e njerëzvet dridhen, nëpër kurriz u përshkohet të ftoftit që vjen nga skutat, andej nga errsina. Brr...uf...andej mbrapa shpinet përpijnë errsina me të ftoftit e saj.

- Po shiko mos ngrin Laroja?

Dhe çohen, i lëshojnë vend rreth zjarmit Larojës, lopës së shtëpis'. Të nxeht edhe ky pjestar familje në kasollën e kristalizueme. E Laroja din si duhet m'u shtrimë rreth zjarmit. Por, me trupin e saj të madh, gati shtypi dy vocrrakë, të cilët i kish zanë gjumi pranë zjarmit.

E kur andej nga mesnata acarimi arrin dhe kulmin e vet, atëherë ndër bagëti fillon një lëvizje. Po, një lëvizje. Një nga një u aviten njerëzvet e me sytë e vet si me u lutë: “Na lëshoni dhe neve të ngrohemi

pak rreth zjarmit, se u ngrimë”. Dhe njerëzit kundrejt njerëzve s' kanë mëshirë, por kundrejt shtazve – po. Prandaj çohen, ua lëshojnë bagtis vendin rreth votrës, e ata vetë shkojnë n'errsin' që përpin.

... Dhe agimi zbardh me bukurin' e bardhë që vret. Çohen njerëzit me trupnat e mpimë dhe me kujtim në ndërgjegje se u kalue edhe një natë e vështirë. U çuen, por nuk çohet një vocrrak. Dora e s' amës shtrihet mbi të dhe m'at çast një britmë e tmerrshme shpoi zëmrat e kasollës. Dhimba e një nane i shkrin zemrat në vaj, por ç'e do kur nuk shkrin zemrën e ngrime të vocrrakut.

Po, ishte ngrimë lokja e nanës. Gjaku i tij i kuq e i purpur' ish ngri ndër dej dhe në zemër, ish bamë kristal, që të bahet një servis për milionarin!; jo, gjaku ish ba rubis, për gjerdhanet e metresavet. E trupi i vocrrakut, i lokes së nanes, ishte bamë një shtatore e ngurët e zhgulun nga gjini i nanës.



- Mernje dhe çonje në qytet kët shtatore. Vendosnje në një shesh! Dhe si përmendore kushtonja ndokujt! Kushtonja atij që ka ma shumë merita për këtë vend! Po, ndoj ministrit o deputetit o ndokujt tjetër... E në rasë se nuk gjeni ndonji njeri që ka merita të mjaftueshme, atëhere kushtonja atij që ka merita ma pak; perendis' klasike.

Migjeni



FJALË DHE SHPREHJE

kundron – vëren diçka me kujdes.
kasollë – shtëpizë e thjeshtë me pullaz prej kashte, kolibe.
shtatore – statujë.
e mekun – e lodhur.
skutë – kënd, qoshe.
rubis – gur i çmuar.



BISEDË RRETH TEKSTIT

Në cilën stinë ndodh ngjarja?
Çfarë aktorë gjenden në kasollë?
Çka ndodhi me lopën Larë?
Ç'tregojnë fjalët: skamje, papunësi, mjerim?
Kujt duhet t'ia dërgojnë vocërrakun e ngrirë si shtatore?
Çfarë porosi na jep autori, kë fajson e kë kritikon ai?
Në cilin dialekt është shkruar ky tekst?



DETYRË

Shkruajeni këtë tekst në gjuhën e sotme letrare.

Njohim gjuhën tonë

DIALEKTET E GJUHËS SHQIPE

Lexojini me vëmendje dy paragrafët e parë të tekstit “ Bukuria që vret “ dhe vargjet e vjershës “ Bleta “ Vëreni ndryshimet që kanë njëri me tjetrin dhe tregoni cilit dialekt i përkasin.

Teksti i parë është shkruar në dialektin e gegërishtes, ndërsa i dyti në atë të toskërishtes.



MBANI MEND

Gjuha shqipe ka dy dialekte kryesore: gegërishten në Veri dhe toskërishten në Jug. Lumi Shkumbin i ndan të dy dialektet.

Gegërishtja flitet në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, në Malin e Zi e në Luginën e Preshevës; ndërsa toskërishtja në Jug të Shkumbinit deri në Konispol, në të folmet çame në Greqi dhe ato të diasporës arbëreshe të Italisë, të Greqisë etj.

Dallimet ndërmjet dy dialekteve të shqipes nuk janë aq të mëdha megjithatë janë të pranishme dhe ato janë:

Dallime fonetike

Gegërishtja ka:

- togun ue : due, grue, krue, mue,
punue etj.;

- fjalë me zanore hundore : ásht,
ândërr, nânë etj.

- bashkëtingëlloren – n ndërmjet
dy zanreve
p.sh.: bana, ranë, venë etj.
Nuk janë ruajtur grupet e
bashkëtingëlloreve :
mb; nd; ng; ngj: marroj, mys,
nutem, njalë etj.

Toskërishtja ka:

togun ua : dua, grua, mua, punuar
etj.;

– ë : është, ëndërr, nënë etj.;

- bashkëtingëlloren – r :
bëra, rërë verë etj.;

- Janë ruajtur grupet e
bashkëtingëlloreve:
mbaroj, mbys, ngutem, ngjalë etj.

Dallime leksikore

Ka fjalë që përdoren vetëm në gegërisht, por ka fjalë të tjera që i ka vetëm toskërishtja, p.sh :

gegërisht

bibë,
biban
kallamoç
tamël
tlyn

toskërisht

pulë deti
gjel deti
misër
qumësht
gjalpë

1. Ushtrime

Lexoni fjalët e mëposhtme dhe tregoni cilat janë ndryshimet ndërmjet gegërishtes dhe toskërishtes.

gegërisht

fërgoj,
katundar
kam ba
rrej
tinëz

toskërisht

skuq
fshatar
kam bërë
gënjej
fshehurazi



GJUHA STANDARDE (LETRARE)

Lexojini me vëmendje dy paragrafët e parë të tekstit “ Bukuria që vret “ dhe vargjet e vjershës “ Bleta “ Vëreni ndryshimet që kanë njëri me tjetrin dhe tregoni cilit dialekt i përkasin.

Teksti i parë është shkruar në dialektin e gegërishtes, ndërsa i dyti në atë të toskërishtes.

Lexoni tekstet e mëposhtme, krahasoni ato dhe gjeni ndryshimet ndërmjet tyre.

Gjuha standarde shqipe është varianti më i përpunuar i gjuhës së popullit shqiptar. Ajo përfshin gjuhën që përdoret në shkollë, në dokumente zyrtare, në botime si dhe në komunikimin zyrtar. Gjuha standarde po ashtu përdoret nga të gjitha mediat shqiptare dhe stacionet radiotelevizive që emetojnë (flasin) shqip.

Shqipja standarde është pasuria dhe arritja më e madhe e kombit shqiptar. Ajo nis me veprat e para shqipe duke kaluar nëpër një rrugë të vështirë të zhvillimit të saj dhe që u kurorëzua me Kongresin e Drejtshkrimit, që u mbajt në Tiranë, nga 20-25 nëntor 1972.

Përshtateni tekstin “ Bukuria që vret “ në gjuhën letrare.



USHTRIME


Ktheni këtë tekst në gjuhën standarde.

Gjoni asht një djalë i urtë. Gjith sa herë del prej shpijet nuk ndalet rrugëve, por shkon drejt në punë të vet. Sa herë shokët mundohen me i thirrë me luejtë gjithë bashkë, por ai u përgjegjet se nuk asht mirë me u ndalë rrugës.

Nji ditë ishte ngri akull. Gjet, tue shkue udhës, nji tubë fëmi tue britë e tue qeshë.

2. Shkruajini fjalët e mëposhtme në toskërisht dhe në gjuhën standarde.

| | | |
|-----------|-------|-------|
| amël | _____ | _____ |
| baj | _____ | _____ |
| dam | _____ | _____ |
| kam lan | _____ | _____ |
| me këndue | _____ | _____ |
| me shkruë | _____ | _____ |





MIKPRITJA SHQIPTARE

Në kohë kur Turqia sundonte Ballkanin, jetonte një shqiptar. Ai ishte prej Hoti dhe plaçkitte rrugën që shpinte prej Shkodre për në Rashkë. Veziri i Shkodrës kishte premtuar shpërblim të madh për atë njeri që do ta kapte atë shqiptar. Një ditë e zënë dhe e shpien te veziri. Ai e mori në pyetje:

- Ti ke bërë shumë punë të këqija.
- Po, kam bërë! – pohoi shqiptari.
- Pse i ke bërë gjithë këto punë të këqija? - e pyeti veziri.
- Pse kam qenë i detyruar, - thotë shqiptari.
- Unë po të dënoj me vdekje! – ia priti shkurt veziri.
- Ani – i përgjigjet gjakftohtësisht shqiptari. – Më vrit!

Pastaj u kthye nga vendi i caktuar. Pas tij shkoi xhelati me shpatë në dorë. Kur arritën në vendin e caktuar, ku duhej të pritej koka e shqiptarit, veziri, i cili përcillte çdo lëvizje të tij, i thotë:

- Ktheu, o shqiptar, të të pyes edhe një gjë!
- Shqiptari u kthye dhe drejtoi sytë kah veziri.

Veziri bashkë me njerëzit e tij, që gjendeshin aty, drejtuan shikimin nga shqiptari. Ai, ndonëse i kishte duart e lidhura, mbahej krenar dhe as që i luante sytë nga veziri dhe xhelati. Veziri i bëri ca hapa. U ndal para tij dhe tha:

- Po shoh se je trim. Por ti ke bërë shumë faje. Megjithatë ti duhet të më tregosh të vërtetën.

Shqiptari po me atë gjakftohtësi të njëjtë u përgjigj:

- Urdhëroni, pyetmëni.
- Ti ke bërë shumë punë të këqija dhe tani ke rënë ngushtë. Më

thuaj a ke rënë ndonjëherë tjetër ngushtë si sot?

- Po, dy herë, bile edhe më ngushtë se sot! – thotë shqiptari.
- A mund të ketë zor më të madh se ky që të ka gjetur sot?

Ja, prapa shpine të pret xhelati! Ky tani ka për të ta marrë kokën! Por, mendohu mirë, na e thuaj të vërtetën, sa të turpërohesh ti përpara këtyre burrave, le të turpërohet e vërteta!

Shqiptari ktheu kokën. Shikoi xhelatin, i cili qëndronte gati me shpatë në dorë. Lëkundti kokën, ngriti vetullat. Të gjithë të pranishmit filluan të shikojnë njëri-tjetrin. Ata kujtuan se shqiptari do t'i binte ndër këmbë vezirit, së paku sa koka e tij të mos pritët nga xhelati. Por shqiptari nuk e luti vezirin. Atëherë veziri, duke matur lartësinë e krenarisë së tij, thotë:

- Më trego a ke qenë ndonjëherë më ngushtë se sot?

- Ju thashë më parë se kam qenë dy herë, - përgjigjet shqiptari.

- Më thuaj atëherë, çfarë mundimesh kanë qenë ato?—e pyeti veziri.

- Dy herë më kanë ardhur miq në shtëpi. S'kisha bukë t'u qitja. Ata ranë të flenë të urët, pa ngrënë bukë. Ajo ka qenë e rëndë për mua, se kjo e sotmja s'më duket asgjë.

Shqiptari pasi i mbaroi këto fjalë u skuq, u drodh i tëri dhe iu mbushën sytë me lot nga turpi.

Kjo aq shumë e tronditi vezirin sa ia fali jetën.

Mark Millani



FJALË DHE SHPREHJE

vezir – funksionar i lartë në administratën e Perandorisë Osmane.

xhelat – ai që zbaton publikisht dënimin e njeriut me vdekje, duke ia prerë kokën.



BISEDË RRETH TEKSTIT

Ku zhvillohet ngjarja?

Cilët janë personazhët kryesorë në tekst?

Përshkruaji cilësitë e tyre.


Pse veziri e liroi nga vdekja shqiptarin?

Kur shqiptari e ndjente veten më keq?



DETYRË

Gjeji dialogët në tekst.



BLETA DHE ARËZA

(dialog)

Bleta:

Unë jam një bletë
Me krahë të lehtë
Fluturoj si era
Nëpër luleshqera
Gjer në mal të lartë
Për të mbledhur mjaltë.

Arëza:


Ç'e do mjaltën, a s'më thua?

Bleta:

Si ç'e dua?
Mjaltën e uruar
Do ta ha gëzuar
Dimrit, kur të bjerë
Borë e shi, me erë
Veç asaj e dua
Për tim zot të mirë,
Që më mban në zgjua
Kohën e vështirë.

Arëza:

Ha, ah, moj e mjerë
Ç'punon për të tjerë,
Pse s' bën si bëj unë
Nat' e ditë gjumë?
Jam e qet' e lirë
Rroj si jo më mirë,
Kurse ti moj bletë
S' rri një dit' e qetë,



Përher' e kapitur
Nga pun' e mërzhitur.

Bleta:

Jo moj, ç'po më thua?
Puna s' më loth mua,
Puna është për bletë
Nder e gas e jetë
Si dhe për njerinë
Se sjell lumturinë.
Po ti që s' punon,
Thuamë, si jeton?

Arëza:

Unë kur të dua
Vij te ti, në zgjua
Ha nga mjalt' e juaj
Dhe nuk rri të vuaj.

Bleta:

Vjen atje, ti vjen,
Pa e sheh ç' të gjen
Mjaltën un' e mbroj
Dhe, “cëk” të pickoj.

Alqi Kristo



BISEDË RRETH VJERSHËS

Midis kujt zhvillohet bisedë në këtë pjesë?
Cila nga këto del si fytyrë pozitive? Pse?
Cila negative dhe pse?
Çka mësojmë nga kjo bisedë?



DETYRË

Bëhuni dy nga dy dhe njëri t'i thotë fjalët e bletës, kurse tjetri të arëzës.
Biseda mes dy a më shumë personave quhet dialog.

VESHJA ËSHTË PJESË E MIRËSJELLJES

Edhe sipas asaj se si dikush është veshur në një rast të caktuar, mund të shihet se a e ka të „kryer shkollën fillore“ për mirësjellje. Kjo më së tepërmi bie në sy te vashëzat, por jo më pak edhe te djelmoshat.

Ka vashëza të cilat me veshjen e tyre duan të tregohen më të pasura, më mençurake nga e tërë klasa, bile edhe më të bukura nga të gjitha të tjerat. Por, shtrohet pyetja se a është kështu?

Kuptohet se - jo. Vashëza e tillë nga dëshira që të dallohet „stoliset si bredhi i Babadimrit“. Në trup i radhiten vëthë, unaza e byzylykë të ndryshëm dhe ku ta di unë se çka tjetër.

Vashëza e edukuar nuk „pispilloset“, por vishet sikur shoqet tjera. Me rëndësi është shija e veshjes, ndjenja për të bukurën; të ketë shije dhe të jetë në rregull, e pastër dhe e bekuorosur... Ka vajzusha, të cilat gjithmonë duken të bukura si lule maji nëpër kopshte, ndërsa për rrobat e tyre s' kanë shpenzuar shumë të holla.

Shumë djelmosha modën e kanë „vënë në bisht të sorrës“? Atyre dubet t'u thuhet:- veshja me shije është pjesë e tyre... Kjo flet për ata se sa kanë shije për të bukurën. E pa këtë, nuk ka as mirësjellje...



TRE MJEKËT E MËDHENJ

Një mjek plak, por shumë i përmendur për diturinë e zotësinë e tij, kishte rënë i sëmurë. Rreth shtratit të tij ishin mbledhur gjithë mjekët e tjerë të qytetit dhe po kujdeseshin për të. Si e vizituan, mjeku i sëmurë ngriti pak kokën dhe u tha:

- Miqtë e mi! Po e ndjej që m'u sosën ditët, por, me gjithë këtë, nuk më vjen keq, sepse po lë pas tre mjekë më të mëdhenj se unë.

Mjekët që ishin aty, shikuan shoqi-shoqin, secili prej tyre e pandehte veten tani si njërin nga të tre mjekët e mëdhenj dhe njëri prej tyre iu afrua të sëmurit dhe e pyeti:

- Mjeshtri ynë i shkëlqyer, të lutemi, na trego, cilët janë këta tre mjekë të mëdhenj.

I sëmuri çeli pak sytë dhe tha:

- Ata janë: dielli, uji dhe ajri

Tregim popullor



BISEDË RRETH TEKSTIT

Cili dergjej i sëmurë?

Kush kujdesej për mjekun e sëmurë?

Mjeku i sëmurë çka u tha shokëve mjekë?

Pse u tha atyre se s'më vjen keq se m'u sosën ditët?

Në të vërtetë cilët ishin tre mjekët e mëdhenj?



DETYRË

Shkruaj çka di për tre mjekët e mëdhenj.

Njohim gjuhën tonë

NDARJA E FJALËVE NË RROKJE

Lexoni tekstin “Tre mjekët e mëdhenj” vëreni me kujdes si janë lidhur fjalët në fjali.

A mund të ndahen fjalët në pjesë më të vogla?

Në tekstin e mësipërm dallojmë fjalë :

a) me një rrokje (njërrrokëshe) : një, mjek, plak, por, për, rreth etj.;

b) me dy rrokje (dyrrrokëshe): shumë, mjekët, mjeku, ngriti, kokën etj.;

c) me tri rrokje (trirrokëshe) : përmendur, diturinë, zotësinë etj.;


me katër rrokje (katërrokëshe) : kujdeseshim, vizituan etj.



MBANI MEND

Shumica e fjalëve në gjuhën shqipe janë njërrrokëshe, dyrrrokëshe, trirrokëshe dhe katërrokëshe.

Për t'i ndarë fjalët në rrokje do të bazohemi në numrin e zanoreve, sepse zanoret janë tinguj rrokjeformues. Ato bashkohen me bashkëtingëlloret dhe formojnë rrokje.



NDARJA E FJALËVE NË FUND TË RRESHTIT

Lexoni dhe vëreni me kujdes si janë ndarë fjalët në fund të rreshtit në këtë tekst.


P. sh.
Sot është dita e parë e shkollës. Muajt e pushimeve kaluan nëpër fusha e nëpër kodra si nëpër ëndrra, Sot në mëngjes me mamanë shkova në shkollë që të regjistrohem në klasën e katërt.



MBANI MEND

Fjalët në fund të rreshtit ndahen sipas rrokjeve. Fjalët njërrrokëshe nuk ndahen në fund të rreshtit.

Një shkronjë e vetme nuk mund të lihet vetëm në fund të rreshtit ose të kalojë në rreshtin tjetër.



USHTRIME

1. Si mund të ndahen në fund të rreshtit këto fjalë:
pushimeve, mamanë, qytetar, shkollor, fshatar.
P. sh.: pu- shimeve, pushi –meve, pushime- ve
2. Si mund të ndahen në fund të rreshtit këto fjalë:
Vegla, kodra, plumbi, kënga, ëndrra.
P.sh.: ve-gla, veg-la.
3. Si mund të ndahen në fund të rreshtit këto fjalë:
Diell, fyell, muaj, ngjyëj. P. sh.: di- ell.
Vazhdoni t'i ndani fjalët e tjera.

ZANORET DHE BASHKËTINGËLLORET

Lexoni me vëmendje tekstin e mëposhtëm dhe dalloni fjalitë.

Pushimet verore mbaruan. Erdhi shtatori. Rrugët janë gjallëruar. Shkollarët të veshur bukur dhe pastër shkojnë në shkollë. Aty u takuan me shokët dhe shoqet e klasës dhe filluan t`i tregonin njëri – tjetrit se si i kaluan pushimet.

Teksti është i përbërë nga disa fjali. Ato mund të shprehen me gojë ose me shkrim.

Kur flasim shqiptojmë (ose dëgjojmë) tinguj të bashkuar në fjalë, e kur shkruajmë bashkojmë shkronjat për të formuar fjalë e fjali.

Fjalja e parë: Pushimet verore mbaruan, është formuar nga këto tri fjalë: pushimet, verore dhe mbaruan.

Secila prej tyre ndahet në pjesë më të vogla: në tinguj dhe tingujt shënohen me shkronja, si p. sh. fjala pushimet: p-u-sh-i-m-e-t është e përbërë nga shtatë tinguj. Çdo tingull ka shenjën e vet – shkronjën.



MBANI MEND

Shenja ose grupi i shenjave që përdoret për të shënuar një tingull kur shkruajmë, quhet shkronjë.

Sa shkronja ka alfabeti i gjuhës shqipe ?

I shkruani dhe i shqiptoni sipas rradhës.

Ç'vërejtët?

Në gjuhën shqipe tingujt ndahen në zanore dhe bashkëtingëllore..

Zanoret janë 7: a, e, ë, i, o, u dhe y.

Bashkëtingëlloret janë 29: b, c, ç, d, dh, f, g, gj, h, j, k, l, ll, m, n, nj, p, q, r, rr, s, sh, t, th, v, x, xh, z dhe zh.


Zanoret dallohen nga bashkëtingëlloret, sepse shqiptohen më lehtë dhe qesin zë, ndërsa bashkëtingëlloret shqiptohen pak më me vështirësi dhe nuk qesin zë.



MBANI MEND

Gjuha letrare shqipe ka 36 tinguj (fonema) që shënohen me 36 shkronja.

Ato ndahen në zanore që janë 7 dhe në bashkëtingëllore që janë 29.



USHTRIME

1. Lexoni këto fjalë dhe dalloni zanoret nga bashkëtingëlloret:

| | | | |
|------------|--------|------------|-------------|
| xixëllonja | natyra | buzëqeshur | menjëherë |
| shkruaj | mirë | ylberi | margaritarë |

Zanore janë: _____

Bashkëtingëllore janë: _____

2. Lexoni si duhet fjalët:

i përzemërt, tremb, gjemb, e enjte, qendër, mendje, kuvend, përmend, qengj, zemër.

3. Shqiptoni drejt fjalët e mëposhtme:

çark, qark, çaj, qaj, fuçi, fuqi; llambë, hedh, gjedhi, mbjell.

Shqiptoni drejt fjalët:

Meshollë, shtathedhur, biologia, lagje, thënie.

Dalloni kuptimin e këtyre fjalëve dhe formoni fjali:

arë – arrë ;

rimë – rrimë (ne)

NË FAMILJEN TONË

Katër çupa
dhe një çun,
gjyshja, gruaja dhe unë,
një shtëpi
e mbushim plot!
Asnjë bukën s'e ha kot!

Njëra çupë,
e madhja fare,
mbahet si llogaritare.
Çupa tjetër bën pazar,
na mbush shporta, na mbush enë,
për të blerë e për kandarë
unë them, shoqen nuk ia gjen!



Vajza e vogël,
makiniste
makinëlarësen komandon,
larje rrobash edhe shtrydhje
me sahat në dorë drejton!
Gruaja vetëm na gatuan,
pastaj ulet dhe shkruan.

Unë,
babai
me trupin div,
vendos drutë stivë-stivë,
gjithë të trashat me hanxhar
i çaj vetë si druvar,
shkund qilimat çdo të shtunë,
nuk kam turp për asnjë punë!
Kurse gjyshja në minder
qep e shqep dhe rron me nder.

Bedri Dedja



BISEDË RRETH VJERSHËS

Pse poeti thotë asnjë bukën s' e ha kot?
Ç' bënin çupat (vajzat)?
Po gruaja ç'punë bënte ajo?
Burri ç'punonte?
Çfarë punë bënte gjyshja?
A ka gëzim në këtë shtëpi?



SINONIMET

Sinonimet janë shprehje ku fjalët e ndryshme kanë kuptim të njëjtë:
vajzë, çupë, vashë, gocë, çikë...
Rrugë, udhë, etj.



DETYRË

Shkruani se ç'punë bëjnë prindët tuaj.
Gjeni sinonime të tjera dhe shënojeni në fletore.

Ç'TË MBJELLËSH, DO TË KORRËSH

Ishte një lypsar plak që bridhte derë më derë me një torbë krahut e kërkonte lëmoshë. Plaku thoshte orë e çast: “ Ç'të mbjellësh do të korrësh”.

Një ditë sosi në një fshat e trokiti te dera e një kamësi. Doli e shoqja e kamësit, e pa lypsarin e i tha të priste pak, pastaj hyri prapë në shtëpi. Pas një copë here doli përsëri me një pite të ngrohtë në duar. Ia dha lypsarit e i tha:

- Bukë s'na u ndodh në shtëpi. Merre këtë pite e haje. Kur të vish njëherë tjetër, do të të jap bukë.

Plaku mori piten, e futi në torbë, uroi e shkoi mëtej. Si lypi derë më derë, la fshatin e shkoi më tutje. Udhës gjeti ulur në një gur një djalosh që rënkonte e gulçonte. Djaloshi dukej shumë i lodhur. Lypsari e pyeti:

- Ç'ke që rënkon e gulçon, o djalosh?

Djaloshi i tha:

- Unë jam udhëtar e po vij nga një vend i largët. Më ka marrë uria mezi mbahem në këmbë.



Plakut i erdhi keq për këtë djalosh. Nxori nga torba piten që i kishte falur në fshat e shoqja e kamësit e ia dha.

- Merre haje, o djalë i mirë, që të marrësh fuqi e të shkosh më tej.

Pastaj plakut shikoi udhën. Ne po e lëmë lypësin në punë të tij e po kthehemi të shohim se ç' bëri udhëtari.

Si hëngri një copë pite të butë dhe e mori pak veten djaloshi, që ishte i biri i kamësit, u ngrit dhe u nis për në fshat. Bëri një copë udhë, ndenji pak në një gur dhe hëngri copën tjetër të pites që i kishte dhënë plakut. Shko -shko, nisi t'i brejë barku. Shtrëngoi dhëmbët, u ul poshtë, u ngrit përsëri e shkoi më tutje. Kështu arriti në fshat e shkoi në shtëpi të tij. Barku po i dhimte shumë e më shumë. Djaloshi zuri të përpëlitet.

- Oj, nëno, po vdes!

Nëna u trondit shumë dhe e pyeti se ç' kishte ngrënë e ç' kish pirë.

- Më kishte marrë uria, nëno. Mezi çapesha. Udhës gjeta një lypës plak që më dha një pite të ngrohtë. E hëngra.

Kur dëgjoi këto fjalë, nëna mënt u çmënt, zuri të shkullë leshrat. Ç'kishte ndodhur? E shoqja e kamësit i kishte dhënë lypësit plak një pite të helmuar, që të mos i shkelte kurrë më në derë.

Tani ne po e lëmë të shoqen e kamësit të bëjë ç' të dojë që ta shpëtojë të birin, dhe do të kthehemi te lypësi plak...

Ky arriti në një fshat tjetër. Zuri të trokasë derë më derë, të zgjatë dorën për të kërkuar lëmoshë dhe të thotë orë e çast siç e kish zakon:

“Ç' të mbjellësh, do të korrësh. Mos i mih varrin tjetrit se do të biesh vetë brenda.

Tregim popullor



FJALË DHE SHPREHJE

bridhte – endej, ecte andej këndej

gulçonte – mezi merrte frymë

lëmoshë – mëshirë; para, ushqime, a sende që i jepen lypësit, të varfërit

kamësi – pasaniku

rrënkonte – ankohej, vuante


mezi çapesha – mezi mbahesha, mezi ecja.



BISEDË RRETH TEKSTIT

- Çka i dha e shoqja e kamësit lypsarit?
- Pse lypsari ia dha piten djalit në rrugë?
- Çka ndodhi me djalin e kamësit?
- Ç'porosi na jep ky tregim?

POPULLI : Mos ia mendo të keqen tjetrit, sepse ajo të kthehet në vetvete.



NË CIRK

Zhurma e madhe pushoi. Kuajt prej druri që rrotulloheshin me shpejtësi për një çast ndaluan. Një burrë me një lavjerrës në dorë përshëndeti të gjithë njerëzit që ndodheshin rreth tij dhe hipi mbi litar. Filloi të ecë. Në metrat e parë të litarit, unë mbylla sytë për të mos parë ndonjë tmerr që mund të ngjiste... Duke mos duruar më dot me sy mbyllur, i hapa përsëri. Shoh burrin që ecte mbi litar. Ndodhet mbi kokën time. Ai kishte përshkuar gjithë litarin rreth e rrotull, kur unë qëndroja me sy të mbyllur. Nën këmbët e tij litari epej fuqishëm. Burri gjunjëzohej mbi litar, bëri një gjysmë rrotullimi në këtë pozicion, u ngrit më këmbë dhe mori përsëri rrugën e papafingos nga ku ishte nisur. Njerëzit që vështronin nga poshtë, nga dritaret e çatitë ulurinin me tmerr. Më së fundi ai u zhduk dhe doli përsëri, por tani nuk mbante një lavjerrës, por vendosi përpara tij një karrocë dore me një rrotë. Ky objekt i njohur më dha forcë, guxim që unë të mos i mbyllja më sytë, por ta shikoja atë mbi litar. Unë e ndiqja burrin me sytë ngritur lart, në çdo lëvizje që bënte. Dhe nuk ishin këmbët e tij që unë vështroja, por karroca. Tronditja mund ta rrëzonte atë. Kur arriti në mes të litarit, na përshëndeti me kokë. Unë mendoja largësitë: një e treta e distancës, një e katërta, një e pesta. Metrat e fundit ishin për mua një torturë e vërtetë. Por ndodhën ende edhe dy mrekulli. Ai po vinte drejt litarit, metrave të fundit, pa gjë në duar që mund të mbahej. Fare papritur me një shpejtësi të madhe nga krahët e tij të shtrirë në ajër fluturuan dy pëllumba. Kur ai u çfaq përsëri për herë të fundit, mbante në duar lule në vënd të pëllumbave.

Për çudi nuk ndjeja më kurrfarë frike. Zemra më rrihte nga gëzimi. Mendova që nuk kisha bërë mirë që mbylla sytë në fillim.

Gjithnjë njeriu duhet të jetë i guximshëm, trim! Dhe sa bukur, për një çast përfytyrova veten mbi litarin e akrobatit.

Eva Kiri



FJALË DHE SHPREHJE

lavjerrësi – trup i varur në mur.
litari epej – litari lakohej.
akrobat – gjimnast i aftë.
papafingo – vend i lartë.



BISEDË RRETH TEKSTIT

A keni qenë ndonjëherë në cirk?
Ç'bënte burri në cirk?
Pse djaloshi i vogël i mbyllte sytë?
Kur burri gjendej në mes të litarit, duke ecur çka bënte?
Djali pse nuk i mbylli sytë më?
Pse djali thotë që njeriu duhet të jetë trim dhe guximtar?



DETYRË

Me shokët shikoni ndonjë cirk në televizor.



Njohim gjuhën tonë TEKSTI DHE PARAGRAFI

Lexoni tekstin e mëposhtëm dhe vëreni prej sa pjesësh është përbërë ky tekst.

Pushimet po mbarojnë. Drita është sa e lumtur aq edhe e pikëlluar. Ajo bëri shëtitjen e fundit nëpër fshat. Me shumë mbresa e kujtime të këndshme ajo largohej nga fshati.

Kudo mbretëronte qetësia. Lart në qiell lundronin dy-tri re si floku i dëborës. Një erë e lehtë i lëvizte ato si anijen mbi sipërfaqen e detit.

Cicërima e zogjve, zukatja e insekteve, blegërima e deleve, fyelli i bariut ia thonin melodisë së përditshme. Kësaj radhe kjo melodi ishte edhe më madhështore. Ishte melodia e lamtumirës.

Teksti i mësipërm është përbërë nga tri pjesë. Çdo pjesë e tekstit quhet paragraf.

Paragrafët, ashtu si fjalitë lidhen me njëri – tjetrin sipas kuptimit.



MBANI MEND

Çdo paragraf fillon me kryeradhë.

Gjeni sa paragrafë ka në pjesën “Dita e parë e shkollës”



MBRËMË BIJA IME

Mbrëmë bija ime
Dy lule i pruri,
Njërën ma dha mua
Tjetrën n' gjoks e vuri.

Pastaj kur i thashë
Ç' është kjo befasi,
Ashtu buzëqeshur
Se ç' m' u hodh në gj.

Pashë dhe një pako
Tek mbante ndër duar,
Ditëlindja ime
Fort e kish gëzuar.

Dhe t'ju them të drejtën
Më kaploi zilia,
Pse kaq shpejt shkojn' vjetët
Dhe ditët e mia.

Por kur shoh tim' bijë
Shoqet që mësojnë,
Më përtërihet jeta –
Vitet le të shkojnë.

Mehmedali Hoxha





FJALË DHE SHPREHJE

gjoks- i – kraharori.

zili-a – dëshirë e madhe për të pasur a për të arritur atë që ka dikush tjetër.

se ç' m'u hodh në gji – m'u hodh në kraharor, më përqafoi ngrohtë.



BISEDË RRETH VJERSHËS

Përse bëhet fjalë në këtë vjershë?

Çfarë i dha e bija si dhuratë babait të vet për ditëlindje?

A e dini datën e ditëlindjes të prindërve? Po të shokëve dhe shoqeve?

Pse e gëzoi aq shumë prindin dhurata e bijës?



DETYRË

Mos harroni t'ua uroni ditëlindjen prindërve qoftë me një lule, vizatim, apo përqafim të ngrohtë?

KTHIMI I YMER AGËS

Ymer Aga ishte një nga djemtë më trima dhe më të hijshëm të vendit. Ai u martua me më të mirën dhe më të bukurën e vashave të vendit. Por ata nuk e gëzuan dot njëri-tjetrin. Të nesërmen e dasmës Ymer Aga u nis në luftë për të mbrojtur vendin nga pushtuesit. Para se të nisej, ai i tha vashës:

- O e bukura ime! Sa kohë do të më presësh ti mua? Unë po nisem për luftë dhe nuk i dihet a kthehem përsëri.

- Nëntë vjet e nëntë ditë, o im zot, - iu përgjigj e pikëlluar vasha.

- Nëse nuk kthehem për nëntë vjet e nëntë ditë, ti martohu, - i tha Ymer Aga dhe e puthi nusen në ballë.

Lufta ishte e gjatë dhe armiku shumë i egër. Ymer Aga luftoi me trimëri dhe qëndroi si burrat deri në fund. Kur u plagos rëndë, atë e zunë rob. E shpunë në burg dhe mbeti atje për shumë vjet. Po Ymer Aga ishte i ri, trim dhe plot gëzim në shpirt. Ai dinte të qeshte, të këndonte edhe në burg. Por papritur një mëngjes ai u ngrys. Nuk pranoi as të hante, as të pinte. Vetë mbreti u interesua për trimin shqiptar:

- Çfarë ke, o Ymer Agë? Pse nuk ha e pse nuk këndon më?

- Nesër mbushen nëntë vjet e nëntë ditë që nga dita kur u nisa në luftë dhe i dhashë leje vashës sime të martohet.

- Çfarë më lë peng, o Ymer Agë, që të të liroj.

- Unë s' kam pasuri, o mbret, por po të lë besën time. Pas tri ditësh do të kthehem përsëri këtu.

- Pa ta shohim, sa e mbani besën ju shqiptarët! – u tall mbreti dhe dha urdhër që ta lironin.

Tërë ditën e tërë natën udhëtoi Ymer Aga mbi kalë. Kur arriti në shtëpi, nusen po e merrnin krushqit. Ai i tregoi asaj nishanin në vetull e në sqetull dhe nusja iu hodh e lumtur në krahë e pastaj këndoi:

*Udha e mbarë, o krusq bijarë,
se unë njoha fatin e parë...*

Ymer Aga u kthye përsëri në burg. Rojet e kështjellës u çuditën kur e panë, ndërsa mbreti i tha:

- Ta gëzosh lirinë, o Ymer Agë shqiptari, se e meriton atë!

(Legjendë shqiptare)



FJALË DHE SHPREHJE

rob – ai që zihet në luftë nga kundërshtari
lë peng – i lë dikujt diçka me vlerë
jap besën – jap fjalën
nishan – shenjë në trup



BISEDË RRETH TEKSTIT

Për ku u nis në luftë Ymer Aga?
Sa kohë ndejti me nusen ai?
Pse Ymer Aga as hante as pinte në burg?
Si e njohu nusja Ymer Agën?
Pse mbreti ia fali lirinë Ymer Agës?



DETYRË

Ritregojeni tekstin me fjalët tuaja.



FJALË TË URTA PËR BESËN

Besa është më e fortë se vdekja.

Arma më e mirë e armikut është tradhëtia.

Besa e burrit thyen edhe gurin.

Fjala e burrit si guri i murit.

Ku është besa, aty është edhe shpresa.

Tradhëtari prish një mbretëri.

Siç ke besën ke jetesën.

Jepe besën ku duhet e jo ku s'duhet.

Të lan e të lyen, por punë s'të kryen.



BLETË NË MJEKËSI

Edhe ca vite ju motra
do të jeni borëbardha
apo t' ju them bletë
me mantela të bardha.

Nesër në pavijone
si në hoje çdo bletë
me barërat tuaja mjaltë
do të shpëtoni jetë.

Fjala juaj e ëmbël
shpresë për çdo plak
nga dora shpëtimtare
një vdekje më pak.

Tani mblidhni nektar
si polen – dituri
që nesër të bëheni
bletë në mjekësi.

Ramadan Zejneli



FJALË DHE SHPREHJE

pavijone – reparte në mjekësi, sallone
hoje – pite ku bën mjaltin bleta
nektar – lëng ose pluhur i lules



BISEDË RRETH VJERSHËS

Përse bëhet fjalë në strofën e parë?
Si e krahason poeti punën e motrave medicinale?
Cilëve ua çojnë barërat?
Për cilin profesion duhet të përgatiten vajzat në të ardhmen?



DETYRË

Shkruani një tekst se ç'doni të bëheni në jetë?

Njohim gjuhën tonë

KOHA E ARDHME

Lexoni tekstin e mëposhtëm dhe vëreni foljet e shkruara me të zeza.

Nesër **do të shkojmë** në aksion për mbjelljen e pemëve. Aksioni **do të jetë** i vështirë, sepse në rrugë **do të ketë** shumë lëvizje. **Do të nisemi** herët. Po ti nënë, mos u shqetëso, nesër në mbrëmje **do të jem** këtu

Foljet e shkruara me të zeza janë në kohën e ardhme dhe tregojnë një veprim që do të kryhet në të ardhmen .

ZGJEDHIMI I FOLJEVE kam DHE jam NË KOHËN E ARDHME

Shikoni fotografitë dhe tregoni se kur kryhet veprimi.



Tani jam një djalë i vogël dhe kam një top të vogël.



Pas disa vjetësh do të jem një djalë i rritur dhe do të kem një top të madh.


Zgjedhimi i foljes kam dhe jam në kohën e ardhme.

| | | |
|----------|------------|------------|
| Unë | do të kem | do të jem |
| Ti | do të kesh | do të jesh |
| Ai, ajo | do të ketë | do të jetë |
| Ne | do të kemi | do të jemi |
| Ju | do të kenë | do të jeni |
| Ata, ato | do të kenë | do të jenë |



MBANI MEND

Në kohën e ardhme foljet marrin përpara pjesëzat **do, të**.
Foljet kam dhe jam në vetën e tretë njëjës dhe shumës shkruhen me **ë** në fund; ai (ajo) do të ketë, do të jetë; ata (ato) do të kenë, do të jenë.



DETYRË

1. Gjeni foljet në kohën e ardhme në tekstin:” Ç`të mbjellësh, do të korrësh”
2. Lexoni tekstin e mëposhtëm dhe tregoni në ç`kohë, vetë dhe numër janë foljet **kam** e **jam**.

Parashikimi i motit për nesër

- Si do të jetë koha nesër ?
- Do të jetë e mirë. Do të ketë re, por nuk do të ketë shira.
- Sa mirë ! Nesër do të shkojmë në shëtitje.
- Të gjithë do të jemi në shkollë që në mëngjes.

Formoni 4 fjali me foljet kam dhe jam në kohën e ardhme.



SKËNDERBEUN E DONTE GJITHË POPULLI

- Gjergj Kastrioti! Gjergj Kastrioti! – ushtonte gjithë vendi. Ata që thërrisnin, mbanin mbi supe një njeri që dilte deri në brez sipër kokave të tyre. Në fytyrën e tij burrërore pasqyrohej gëzim e mirënjohje. Me një dorë mbahej në supin e njërit dhe me tjetrën përshëndeste popullin që tani thërriste me një gojë të vetme:

- Gjergj Kastrioti! Gjergj Kastrioti!

Njerëzit shtyheshin kush t'i afrohej më pranë, ta shihnin më mirë, ta preknin me duar. Por ai s' kishte si t'ua plotësonte dëshirat të gjithëve, sado që u shtrëngonte dorën njërit e tjetrit që nga supet e atyre që e mbanin. Ai u takonte të gjithëve, ishte i të gjithëve...

* * *

Ngado thirrje, ngado ngazëllim. “ Rroftë Gjergj Kastrioti! I qoftë hallall qumështi i nënës! Të falemi, burrë i dheut!”

Një plak ra përdhe dhe deshi t'ia puthë këmbën. Skënderbeu u ul si vetëtima dhe e ngriti. – Jo, bacë, - tha – jo! Lirinë nuk jua solla unë, por e gjeta këtu ndër ju!

Kastrioti vazhdoi të fliste. Ai i porositi të ngrenë në këmbë gjithë vendin, të ushtojnë malet nga gjëmimi i lodrave të kushtrimit, të gjëmojnë kambanat natë e ditë pa pushuar, të bredhin kasnecët këmbëshpejtë shteg në shteg. Liria ishte në prag të derës, ajo po buzëqeshte...

Ndërsa fliste, i kishte rënë një hije e rëndë. Të gjithë e ndjenin se tek ai njeri duhej mbështetur pa frikë, se ai njeri ia kishte falur jetën atdheut.

Kastrioti foli thjesht dhe tha ato fjalë që i erdhën në mend pa i



menduar më përpara, por foli me gjithë shpirt.

E ndërpre në. Gjëmuan thirrjet:

- Prina, Kastriot! Rrofsh, o Skënderbe!
- Ta kemi falë jetën ty dhe Arbërit!
- Kush vdes për këtë tokë, nuk shkon gjakhupës!
- Prina, he sokol Mali!
- Mbas teje, Kastriot!

Kështu dëgjohej brohoritja e popullit.

Skënder Drini



FJALË DHE SHPREHJE

prina – udhëhiqna
kasnecë – lajmëtarë
ushtojnë – gjëmojnë
me një gojë të vetme – thërresin të gjithë menjëherë, si me një gojë
ngazëllim – gëzim i madh
burri i dheut – trim i shquar dhe besnik
hijerëndë – me pamje madhështore e krenar



BISEDË RRETH TEKSTIT

Pse brohoritnin dhe e donin aq shumë populli
Gjergj Kastriotin?
Ç'kuptim kanë fjalët e Skëndërbeut:
“Lirinë nuk ua solla, por e gjeta këtu, ndër ju!”



DETYRË

Portretizoni me fjalët tuaja figurën e Skënderbeut.



Nga mirësjellja

NË DITËLINDJE

Të gjithë shkojmë diku në ditëlindje. Por, për këtë, sa jemi të kujdesshëm se si duhet të sillemi? Dhe po ashtu sa kujdesemi se çka do t'i dhurojmë shokut tonë?

U mor vesh, këtu s'bëhet fjalë për ndonjë dhuratë të madhe, sepse jo vetëm që nuk jemi në gjendje të blejmë dhuratë të këtillë, bile dikush edhe sikur të kishte mundësi të blejë një të tillë, e “obligon” kremtuesin me të njëjtën “masë” t'ia kthejë peshqeshin.

Ndërkaq, s' mundemi vajzës t' i dhurojmë top këmbë, ose kollare (kravatë). S' ka kuptim po ashtu një djalit t' i dhurojmë ndonjë bizhuteri të bukur, apo jo?

Por, të mos e lodhim trurin, sepse pasi që bëhet fjalë për ndonjë shok tonin, duhet t' i blejmë diçka modeste dhe të vlershme.

Kjo është e para. Rregulla e dytë është se si të sillemi në ditëlindje? Atje – në qendër të vëmendjes është shoku që e kremton ditëlindjen e vet. Sapo të arrimë tek ai, do t' ia dorëzojmë dhuratën. Ai duhet menjëherë ta hapë, kuptohet me kujdes. Në rast se nuk i pëlqen dhurata, këtë nuk duhet ta kuptojnë të tjerët. Por, duhet të gëzohet.

Shumica mendojnë se edhe lulja është dhuratë, por gabojnë. Lulja është kujdes dhe shkon së bashku me dhuratën.



LETËR AGRONIT

Binte borë. Dimri kishte ardhur. Agroni afronte kryet në dritare dhe vërente se si fluturonin fjollat e borës.

Në dritare ra fluturimthi një zog.

- Nënë, çfarë zogu është ky?

- Ky është trishtili, bir. E ka detyruar dimri të bjerë në dritare.

Është i uritur.

- Çka ha trishtili?!

- Ha krimbtha e insekte, por mundet edhe kokërrza dhe thërrmija buke.

Agroni gjeti një kapak teneqeje dhe në të grimcoi pak bukë. Pastaj hapi dritaren dhe e vuri ushqimin në dërrasën e jashtme të saj.

Nuk shkoi shumë kohë dhe trishtili erdhi përsëri. U kthye në njërenë e tjetrenë anë, uli kryet dhe filloi të hajë. Mori një thërrmijë bukë në sqep dhe fluturoi në drurin e mollës. Kur e hëngri, u lëshua përsëri fluturimthi dhe mori një thërrmijë tjetër.

- Sa i bukur që është! – e shikon Agroni dhe kënaqet...

Të nesërmen Agroni vuri përsëri thërrmija buke në dritare. Shpejt erdhën dy trishtila. Pastaj një tjetër.

- U bënë tre, nënë! Shikoji!

- Ani, bir, ata janë zogj të mirë. Zhdukin krimbat e vemjet në kopshte e pemishte.

Kështu Agroni i ushqeui trishtilat gjatë tërë dimrit.

Kur erdhi pranvera, një mëngjes, Agroni vuri re se si nën kapakun ku u kishte vënë ushqim trishtilave, dukej një letër.

Hapi dritaren, mori letrën dhe ia tregoi nënës.

- Shiko, nënë, letër në dritare! A do të ma lexosh se çka shkruan në të.

E ëma lexoi:

E falënderojmë vogëlushin Agron, që na ushqe në ditët e vështria të dimrit. Për këtë ne do t' i këndojmë përditë në mollën nën dritare. Përveç kësaj, gjatë tërë verës do t'i zhdukim vemjet dhe insektet e tjera të dëmshme në pemishte.

- Trishtilat ma paskan shkruar mua këtë letër! Nënë, të lutem, lexoje edhe një herë.

Grigor Vitez



FJALË DHE SHPREHJE

trishtil – zog pylli, zakonisht me ngjyrë të gjelbër, me sqep të shkurtër, që këndon bukur.

thërmijë buke – grimca të vogla të bukës, thërrime.



BISEDË RRETH TEKSTIT

Si e ndihmoi Agroni zogun e vogël kur bora e kishte mbuluar natyrën?

Pse trishtilët janë zogj të dobishëm?

Çka kuptoi Agroni nga letra e trishtilave?



DETYRË

Bëj një hartim me shkrim në këtë temë:

“Si t' i ndihmojmë zogjtë në stinën e dimrit?”

LUSHI SHPËTIMTARI

- Zjarr! Zjarr! Zjarr! – u përhap në klasë thirrja tërë panik e bibliotekares. Në korridor dolën nxënësit dhe mësuesit. Kolliteshin, fërkonin sytë nga tymi e s' dinin ç' të bënin.

- Të hedhim ujë, apo... – tha dikush.

Lushit i shkuan sytë tek aparati për shuarjen e zjarrit, që ishte varur ndërmjet derës së bibliotekës dhe derës së klasës së tij. E rrëmbeu dhe u fut brenda në bibliotekë nëpër tym.

Pas pak Lushi doli duke fshirë djersët. Njëra mëngë e bluzës ishte djegur te bërryli.

- Si je?! e pyetën disa zëra të shqetësuar Lushin.

- E shova, - u përgjigj Lushi sikur s' kishte ndodhur asgjë.

- E shove?! – shprehën habinë shumë zëra përnjëherësh.

- U dëmtuan shumë libra?!

- Jo, - tha shkurt Lushi dhe vari aparatën në mur.

- Ore, ishte Lushi apo më bënë sytë? – pyeti një mësuese.

- Nuk e njoh me emër, - u përgjigj bibliotekarja. – Nuk më kujtohet të ketë marrë ndonjë libër tek unë.

- Sa çudi! – tha një mësuese tjetër.

Të nesërmen klasë më klasë u lexua një fletë falenderimi për Lushin që kishte shpëtuar bibliotekën. Një nxënës e fotografoi dhe një gazetar shkroi për të një shkrim në gazetë me titull: “Lushi shpëtimtar”. Madje dikush iu lut për një intervistë, por Lushi nuk pranoi.

Shoqet dhe shokët e klasës mburreshin me Lushin, por ama edhe donin të ishin në vendin e tij. Të gjithë habiteshin: “Lushi shpëtimtar!? Po ai nuk kishte shkuar asnjëherë në bibliotekë!”

Po më i habitur nga të gjithë ishte vetë Lushi. “Ç' ishte gjithë ajo zhurmë për një grimë zjarr të shuar?! Ja, njëlloj janë këta mësuesit dhe gazetarët. Nuk të ndahen për të mirë dhe as për të keq.”

Arif Demolli



FJALË DHE SHPREHJE

intervistë – pyetje dhe përgjigje me gazetarët
panik – frikë e madhe



BISEDË RRETH TEKSTIT

Ku gjendeshin nxënësit?
Çfarë ndodhi brenda në bibliotekë?
Si veproi ai?
Ku gjendej aparati për shuarjen e zjarrit?
Pse të gjithë habiteshin me Lushin?
Çka i dhanë Lushit për guximin e tij?



DETYRË

Shkruani ndonjë ngjarje të ngjashme si kjo.



QENI DHE BESA E TIJ

Një shitblerës kishte një qen që i kishte vënë emrin Xhuf. Ngado që shkonte, qenin e merrte pas dhe e kishte në vend të shokut.

Një ditë shitblerësi u nis për udhë të gjatë, i hipi kalit, mori edhe Xhufin. Në vapëherë i zbriti kalit. Vetë ndejti në hije të një ahui, ndaj burimit, uji i të cilit ishte i ftohtë si akull e i bardhë si argjend; kalin e pengoi dhe e lëshoi në shesh, që ujitej nga ujët e burimit dhe bari i të cilit ishte deri në gju; Xhufi ndejti më larg, para të zot edhe zu e merrte frymë shpejt e shpejt.

Porsa zu veriu të frynte, u ngrit udhëtari, i hipi kalit edhe mori udhën; po atje tek ndejti harroi strajcën, që e kishte plot me para.

Xhufi e pa strajcën, që e harroi i zoti, dhe vrapoi e doli përpara edhe zuri të lihte. I zoti i ra kalit dhe iku me vrap, po Xhufi nxitoi dhe prapë i doli përpara edhe iu hodh kalit, duke lehur e s' e linte të merrte udhë. I zoti e ndali, e përgëzoi dhe donte ta prapste, po qeni i varfër s'donte ta linte të merrte udhë.

- Popo! tha shitblerësi, m'u tërbua Xhufi i varfër edhe prapë rrahu ta zbuste e të merrte udhë, po Xhufi më tepër ashpërsohej.

- Ah! – tha, - vate Xhufi, u tërbua. Edhe duke psherëtitur heq edhe i bije; Xhufi u plagos rëndë, po s'angulliti fare dhe u hoq nën udhë e ra. I zoti u mallëngjye, po dita ishte duke ngrysur, andaj i ra kalit dhe shkoi.

Kur eci më tutje, kujtoi strajcën edhe sheh që s' e ka; po kthehet me vrap prapë e vjen ku goditi qenin.


Sheh që Xhufi ishte ngritur e kishte marrë udhën drejt burimit, edhe duke ikur kishte bërë një vazhdë prej gjaku.

Kur iu qas burimit, pa Xhufin, që kishte rënë mbi strajcë dhe e kishte vënë këmbën e djathtë sipër. Zbriti me nxitim nga kali dhe e

fërkoji e e përgëzoi; Xhufi i varfër i puthi dorën të zot edhe mbylli sytë e shoi.

- Ah! – tha i zoti, - m'u thaftë dora; më mirë të kisha humbur paratë, se sa vrava të zinë Xhuf!

Naim Frashëri



PYETJE

Pse ky tregim e ka titullin: “Qeni dhe besa e tij?”

Pse shitblerësi tha në fund këto fjalë: “M'u thaftë dora; më mirë të kisha humbur paratë, se sa vrava të zinë Xhuf!”?



DETYRË

Shkrimtari ynë i njohur Naim Frashëri ka shkruar shumë vjersha edhe për fëmijë. Disa nga këto janë përmbledhur e botuar në një libër me titull “Të vegjëlit” Lexoje këtë libër, mbasi ky është paraparë edhe si lektyrë shkollore për klasën IV.

TRE FËMIJËT

Thonë se kjo legjendë ka lindur një të shtune tash e shumë vjet më parë. Ky është rrëfimi për tre fëmijë dhe për tre fyej magjikë...

Fëmija i parë i donte erërat...

Fëmija i dytë e donte shiun...

Fëmija i tretë i donte diellin dhe hënën...

Kur i binte fyellit fëmija i parë, çoheshin erëra dhe e shpërndanin melodinë e fyellit. Ai dëshironte melodia e tij t'i puthte gjithë zemrat e njerëzve në botë. Kënga e tij kishte fjalë të arta.

“Fjalët e njerëzve duhet të jenë dukat,

Në zemrat e tjerëve për t'u shkri'

Fjalët e njerëzve duhet të jenë si lule

Vesuar me dashuri.”

Fëmija i dytë i binte fyellit dhe thërriste shiun. Ky i donte lulet dhe ngjyrën e gjelbër. Melodia e tij fluturonte kah qielli dhe atëherë fillonte të rigojë shiu. Shiu i rriste lulet dhe tokës i vishte gjelbërimin. Dëshironte që këngën e tij ta mësojnë të gjithë fëmijët e planetit. Të gjithë barinjtë që i kullosin tufat nëpër lugina dhe gjithë zogjtë e pyllit:

“Njerëzve të mirë u çelin si lule

Dhe rriten si blerimi –

Njerëzve të mirë zemrat u bëjnë dritë

Në to buron gëzimi.”

Fëmija i tretë i binte fyellit dhe thirrte diellin e hënën. Melodia e tij ishte peri magjik që zgjatej prej gishtave të tij deri në zemrën e diellit. Atëbotë, dielli bëhej baloni i tij i artë.

Kënga e tij, thonë i dehte zanat dhe gjithë njerëzit që e dëgjonin:

“Ta marrim ngjyrën e diellit.

Ta veshim këmishën e qiellit...”

Një natë, thotë legjenda, kur tre fëmijët ranë në gjumë për të ëndërruar hënën, erdhi dikush tinëz dhe ua vodhi fyejt. Ai sigurisht ua

kishte zili këngëve të tyre. Kur fëmijët u zgjuan, filluan të qajnë. Legjenda mandej thotë se prej mërisë ngrinë dhe u shndërruan në gurë. Duart i mbajnë të shtrira dhe secili kërkon fyellin e vet. Që të tre shikojnë kah qielli. Fëmija i parë duket se thërret erërat! Fëmija i dytë shiun! Fëmija i tretë diellin e hënën!

Njerëzve u duket se kënga e tyre ende jehon nëpër pyll.

Rrahman Dedaj



FJALË DHE SHPREHIJE

magjike – e mrekullueshme
planet-i – rruzulli tokësor që sillet rreth diellit
zanat – sipas besimeve popullore quhen vashat e bukura dhe luftarake
që u vijnë në ndihmë trimave, drangonjve
jehon – kumbon, tingëllon. ★



BISEDË RRETH TEKSTIT

Cilat ishin dëshirat e tre fëmijëve?
Ç'mendon ti për këto tri dëshira?
Kur binte shi si ndryshonte natyra?



AFËR BUSTIT TË HEROIT

Në kraharorin tim
Po rreh zemra jote trimëreshë
Sa i fuqishëm që jam!
Askush s' guxon t' më dalë në pritë,
Askush s' guxon t' i shkelë livadhet tona të bukura
Askush s' guxon ta turbullojë qiellin tim,
Askush s' guxon ta ndalë këngën tonë të re
Se në kraharor e kam:
Zemrën
Dhe trimërinë tënde.

Afër bustit tënd -
Afër bustit tim,
Këndoju në gjuhën tënde
Këndoju në gjuhën time.

Ku e ke pushkën?
- Pushka ime
Është lapsi yt.
- Ku i ke duart?
- Duart e mia
Janë duart e tua.
- Të lutem a sheh?
- Unë shoh
Me sytë e tu.
- A luan ti?
- Unë përherë jam
Në lojën tënde.

Ali Hurnglica



FJALË DHE SHPREHJE

bust – skulpturë që paraqet kokën e një njeriu nga beli e përjetë.



BISEDË RRETH VJERSHËS

Duke qëndruar fëmija para bustit të heroit bëhet edhe vetë trim. Trego pse bëhet ai kaq trim e guximtar para bustit?

Lexoje me vëmendje bisedën e heroit me nxënësin.

Ç'pyetje i bën nxënësi bustit të heroit që ka rënë dëshmor, e çfarë përgjigje i jep ai?

Ç'kuptim kanë ato përgjigje?



DETYRË

Bëni një vizitë parkut dhe shihni bustet e heronjve.



Njohim gjuhën tonë

ZGJEDHIMI i FOLJEVE kam dhe jam NË KOHËN E TASHME

Lexoni vjershën “ Afër bustit të heroit “ dhe gjeni foljet kam dhe jam.

Foljet **jam, kam, ke, janë**, janë në kohën e tashme.
Këto zgjedhohen kështu :

| | | |
|----------|------|-------|
| Veta | kam | jam |
| unë | kam | jam |
| ti | ke | je |
| ai, ajo | ka | është |
| ne | kemi | jemi |
| ju | keni | jeni |
| ata, ato | kanë | janë |

Koha e shkuar

Lexoni me vëmendje tekstin “Vajza e panjohur” në faqen 136 dhe gjeni foljet. Në ç`kohë janë ato?

Ndani në shtylla P. sh.:

| I | II | III |
|--------------|---------------|--------|
| përshëndeste | kishte vrarë | u nis |
| s'kishte | kishte parë | doli |
| kthente | kishte gjetur | u skuq |
| njihte | | ktheu |

Të gjitha foljet janë në kohën e shkuar. Ato tregojnë veprime që kanë ndodhur në të kaluarën. Foljet dallohen për nga forma.

Foljet e shtyllës I dhe III janë të thjeshta, ndërsa ato të shtyllës II janë të përbëra.

Folja kam dhe jam në kohën e pakryer

Lexoni dhe vëreni me kujdes fjalët e shkruara me të zeza .

Ishim në Ohër, buzë liqenit. Atje takuam shumë nxënës që kishin ardhur për t'i kaluar pushimet verore. Liqeni **shkëlqente** nga rrezet e arta të diellit. Të gjithë **ishin** të gëzuar e mezi **prisnin** të zhyten në ujin e pastër. Nga uji dolën grumbuj djemsh e vajzash. **Ishin** të gëzuar, **qeshnin** dhe **këndonin**. Trupat i **kishin** të shëndetshëm, lëkurën e **kishin** ngjyrë bronzi.

Fjalët e shkruara me të zeza janë folje në kohën e pakryer.



MBANI MEND

Folja në kohën e pakryer tregon një veprim në kohën e shkuar.

Më poshtë po zgjedhjmë foljen **kam** dhe **jam** në të pakryerën.

| | | |
|----------|--------|-------|
| unë | kisha | isha |
| ti | kishe | ishe |
| ai, ajo | kishte | ishte |
| ne | kishim | ishim |
| ju | kishit | ishit |
| ata, ato | kishin | ishin |

Nga mirësjellja

ALO. FATON, SI JE?

Fëmija me edukatë të shëndoshë dallohet për shumë “imtësira”. Njëra sosh është – telefonimi. Njëmend – si telefonojmë.

Para ca ditësh, shokun tim e kërkoi mikesha e vet.

- Alo! Faton! Si je? – menjëherë “cicëroi” ajo.

- Këtu është Krenari, e jo Fatoni – iu përgjigja.

- A ti qenke Krenar? Dëgjo, kur të kthehet Fatoni, kujtoja që të më lajmërohet!

- Por, unë s'e kam të qartë se kush e kërkon – i them.

- Dhe kështu biseduam, e në fund të bisedës, ajo lëshoi kufjen, ndërsa unë s' munda ta përcjell porosinë, meqenëse në të vërtetë, nuk e kisha të qartë se me kë bisedoja. Çdo gjë do të ishte në rregull, nëse biseda fillonte kështu:

- Alo, këtej është Valdetja, më duhet Fatoni...

Të mos flasim fare për ata që “flejnë” në telefon. Jetojnë, të themi në të njëjtën lagje, ndërsa zhvillojnë biseda “maratonike” me anë të telefonit.

Me telefon bisedojmë aq sa duhet, që të merremi vesh për diçka, kurse gjerë e gjatë do të bisedojmë kur të takohemi...



MACJA JONË KITI

(intervistë)

Sigi, Ana, Belisa dhe Ina janë shumë shoqe të mira. Me to shpesh rri dhe vëllai i vogël i Inës, të cilin ajo e merr me vete. Ato na u lutën t'u bënim disa fotografi me macen e tyre të përbashkët, Kitin për revistën tonë. Ndërsa ne u morëm atyre një intervistë.

Gazetarja: E kujt është kjo mace?

Vajzat: E të gjithave.

Gazetarja: Po kush e mban, kush e ushqen?

Ana: Këtë mace e kemi gjetur. Një të diel ne kishim dalë të luanim dhe e pamë macen te rrugica e lagjes.

Sigi: Ne na erdhi shumë keq për të, se ishte shumë e vogël dhe e pambrojtur.

Belisa: Ajo kishte humbur mamanë. Si mund ta linim në mes të rrugës?

Gazetarja: Po ju çfarë bëtë?

Ina: Ne e morëm ngadalë në dorë, e përkëdhelëm dhe vendosëm ta ushqenim derisa të rritej.

Ana: Ne e mbanim me radhë në shtëpi, megjithëse prindërit na shanin.

Gazetarja: Çfarë ju thoshin ata?

Sigi: Pse ju doni t'i mbani tërë kafshët e rrugës? Ne nuk jemi të përgatitur për të mbajtur mace.

Ana: Ne qanim, atyre u vinte keq dhe kështu shtynim ditët, macja po rritej nga pak.

Gazetarja: Me çfarë e ushqeni atë?

Sigi: Me sakrifica, nga lekët që na japin prindërit, ne blejmë qumësht dhe ushqim për macen.

Gazetarja: Po emrin kush ia vuri?

Belisa: Ia vuri Sigi. Ajo ka dhe një qen që quhet Ledi.

Sigi: Po më shumë nga ne të gjitha për të kujdeset Ana.

Ana: Një herë unë dhe Sigi po luanim me çunat futboll dhe e lamë macen në bar. Aty pranë kaloi një qen i madh dhe iu sul Kitit. Ajo mjaulliu e frikësuar. Sigi iu sul me shkop qenit, ndërsa unë e mora Kitin dhe i thosha: “ Shpirt i vogël, mos qaj se na ke ne këtu!.

Ina: Tani nuk e mbajmë ne macen. E gjetëm mamanë e saj dhe e lamë të lirë. Për kujtim po bëjmë këto fotografi.

Ana: Unë kam shkruar diçka në ditarin tim për Kitin. A do të ma botoni?

Gazetarja: Patjetër. Dhe tani, mirupafshim vajza.




BISEDË RRETH TEKSTIT

- Përse bëhet fjalë në tekst?
- Cilat kafshë i doni ju më shumë?
- Me kë e bëri intervistën gazetarja?
- Si e kishin gjetur macen vajzat?
- Pse u erdhi keq për macen?



DETYRË

Bëj një hartim për kafshët.



Njohim gjuhën tonë

MBIEMRI

Lexoni tekstin e mëposhtëm dhe vëreni me kujdes fjalët e shkruara me të zeza.


Fshati im është **i vogël** po **i bukur**. Shtëpitë e tij janë **të ulëta** e **të pastra**. Mbi fshat ngrihet një kodër **e veshur** me pyje **të gjelbër** e drunj **të lartë**. Fshati im ka një shkollë **të re**. Këtë shkollë e kemi ndërtuar pas çlirimit të vendit.

Ç'emërtojnë fjalët e shkruara me shkronja të zeza?



MBANI MEND


Fjalët që tregojnë se si janë njerëzit, kafshët dhe sendet quhen mbiemra - fjalë cilësie.



DREJTSHKRIM

Mbiemrat e tipit: i mirë, i drejtë, i lartë, i butë, i gjatë, i zbehtë, i bardhë shkruhen me ë.

Ndërsa mbiemrat e tipit: i bukur, i ditur, i fshehur, i vogël, i ëmbël, i ndershëm etj. shkruhen pa ë në fund.



USHTRIME DHE DETYRA

1. Ktheni këta emra në mbiemra, sipas shembullit të dhënë:

ligësi – i lig

dinakëri - dinak

afërsi

fatëkeqësi

largësi

kokëfortësi

befasi

mendjelehtësi

uri


mendjemadhësi

Në se dallohen mbiemrat e shtyllës së parë prej atyre të shtyllës së dytë?



MBANI MEND

Disa mbiemra marrin përpara nyjën – i ose – të dhe janë mbiemra të nyjshëm; kurse disa mbiemra nuk kanë nyje përpara dhe quhen mbiemra të panyjshëm.



DETYRË

Ktheni këta mbiemra në gjininë femërore.

i qetë, i lumtur, i kënaqur, i pikëlluar, i hidhëruar, i madh, i kuq, i zi, i tmerrshëm, i vetëm, bardhosh, dinak, ushtarak, zemrak, përtac



MBANI MEND

Në përgjithësi mbiemrat gjininë femërore e formojnë duke i shtuar mbiemrit të gjinisë mashkullore mbaresën – e për trajtën e pashquar dhe - a ose – ja për trajtën e shquar.

Lexoni mirë këtë tekst, dalloni mbiemrat dhe zëvendësoni me mbiemra me kuptim të kundërt.

Kalojmë lumin e gjerë me ujë të turbullt. Futemi në një pyll të vogël. Pylli i dendur me pisha shekullore fëshfërin. Lart, në një pllajë të vogël është një kasolle e ulët, e vjetër.

P.sh: Një shtëpi e madhe duket prej së largu.
Një shtëpi e vogël duket prej së largu.



MBANI MEND

Mbiemrat pëlqehen në gjini, në numër dhe në rasë me emrat që i shoqërojnë.

1. Plotësoni vijat me mbiemra në mënyrë që sa më mirë të përshkruhet njeriu, kafsha a sendi që emërton ai.

Një nxënës.....,....., shkonte me vrap në shkollë.

Syri s'ngihet së pari qiellin.....,.....

Gjuha jonë.....,....., sa e vlerë.

Nëna ime është.....,....., si

asnjë grua tjetër.

Ajo i ka sytë....., vetullat....., flokët....., ballin..... dhe trupin.....



MBANI MEND

Mbiemri në fjali plotëson kuptimin e emrit dhe është pjesë plotësuese e tij.

SINONIMET

Lexoni me kujdes vargjet e kësaj vjershe dhe tregoni ç` shprehin fjalët e shkruara me shkronja të zeza..

Kohën e kurse

Se **vete** e më s`vjen

Shkon e më s`vjen

Ikën e të le.

Fjalët e shkruara me shkronja të zeza janë folje dhe shprehin pak a shumë të njëjtin veprim, por kanë formë të ndryshme

Në fjalor kuptimi i këtyrë fjalëve shpjegohet kështu:

Vete – lëviz në një drejtim të caktuar; shkoj diku.

Shkon (shkoj) – lëviz nga një vend në një tjetër; eci.

Ikën (iki) – lëviz nga një vend në një tjetër; shkoj, nisem, mërgoj.



MBANI MEND

Fjalët që kanë kuptim të njëjtë ose shumë të afërt, por formë të ndryshme, quhen sinonime.



USHTRIME

1. Lidhni fjalët që kanë kuptim të njëjtë.

| | | |
|---------|---|----------------|
| vajzë | ← | shkoj |
| djalë | → | gocë |
| vete | | tepsi |
| kurriz | | shpinë |
| dritare | | rrugë |
| udhë | | sini |
| koprrac | | dorështrënguar |
| | | çun |
| | | penxhere |

2. Gjeni sinonime në tekst.

ANTONIMET

Lexoni vargjet e kësaj kënge popullore dhe vëreni me kujdes fjalët e shkruara me shkronja të zeza.

Hanko mos kalo mbi vare
Se **të vdekurit i ngjalle**
Të gjallët i vdiqe fare.

Fjalë e mësipërme: të vdekurit – të gjallët; i ngjalle – i vdiqe janë fjalë me kuptim të kundërt, janë **antonime**.

Antonimet mund të jenë:

Emra – natë – ditë
dritë – errësirë,
Mbiemra – i bardhë – i zi
i bukur - i shëmtuar,
Folje - ngjitem – zbres
ngul – shkul,
Ndajfolje - mirë – keq
pak - shumë



MBANI MEND

Fjalët me kuptim të kundërt quhen antonime



USHTRIME

1. Gjeni emrat me kuptim të kundërt.

mashkull _____

burrë _____

djalë _____

gjel _____

kalë _____

dash _____

2. Gjeni foljet me kuptim të kundërt.

mbath _____

mbuloj _____

ngrin _____

vishem _____

zgjeroj _____

flas _____

3. Shkruani mbiemra me kuptim të kundërt.

Pëllumbi është shpend i bardhë.

Molla është pemë e vogël.

Kjo dhomë është e ngrohtë.

Korbi është shpend _____.

Arra është pemë _____.

Ajo dhomë është _____.


4. Shkruani antonimet e këtyre fjalëve:

trim _____

i zhdërvjellët _____

i shkathët _____

mendjelehtë _____



MËMË E BIR

- Nëno!...
- Bir!
- Dua bukë!
Mëma hesht.
- Nëno!
- Bir!
- Më dhemb koka!
Mëma s' përgjigjet.

S' ka bukë. S' ka zjarr, s' ka të holla për doktor. Dhe djali psherëtin. Mëma s' përgjigjet. Psherëtin dhe ajo me ngadalë. Djali nuk i dëgjon psherëtimat e mëmës. Mëma dëgjon tiktaket e zemrës së të birit. Një grua plakë e rreckosur me fytyrën rrudha-rrudha, rri mbi kokën e një djali dhe e vështron me sy të zgurdhulluar. S' guxon të qajë; ka frikë mos zgjojë djalin që porsa filloi të flejë. Rri dhe e vështron! Dy lot helmi shkasin prej syve të neveritur. Me ngadalë, pa zhurmë, mbështet dorën e vet mbi ballin e djalit dhe djali zgjohet përsëri.

- Nëno!
- Bir i nënës!
- Dua bukë!
Mëma hesht!
- Nëno!
- Xhani i nënës!
Mëma psherëtin.

Dhe djali fle përsëri; dhe nëna rri dhe e vështron dhe ngadalë qan dhe psherëtin. Në heshtjen tragjike të një nate dimri, në odën pa dritë luhet një nga mijëra tragjeditë e jetës njerëzore. Dhe çdo tragjedi është një poemë e gjallë! Poema e shekullit njëzet!

Një mëmë; pranë saj një djalë; mbi një dhogë kora e Shën Mërisë. Mëma e shikon korën e shenjtë, i afrohet, e puth dhe kthehet pranë djalit. Një shkëndijë shprese shkëlqen në sytë e saj.

Shën Mërija hesht!

- Nëno!

- Bir!

- S' jam mirë!

- T' u bëft nëna, fli!

Dhe djali fle përsëri. Dhe mëma qëndron si shtatore! Hedh sytë tej e përtej, vështron korën, vështron djalin dhe psherëtin thellë. Dhe djali fle! Mëma i vë dorën në ballë! Balli është i ftohtë! Mëma i trazon dorën. Dora ka ngrirë. Mëma e puth në buzë. Buzët janë mbyllur për jetë. Mëma qan me zë, por djali nuk zgjohej.

Dhe zërit të mëmës i përgjigjet heshtja e natës. Kora për karshi vështron dhe hesht. Një trup i ngrirë! Një mëmë me sy pa lot. Një natë dimri vdiq i biri i një lypëseje. S' u prish bota as fukarallëku mori fund.

Nonda Bulka



FJALË DHE SHPREHJE

tragjedi – pjesë teatrale me fund të keq, të dhimbshëm

poemë – vjershë më e gjatë

dhogë – dërrasë

korë – ikonë, fotografi shenjtoreësh nëpër kisha

shtatore – statujë



BISEDË RRETH TEKSTIT

Kur kërkon djali bukë, pse nëna s'përgjigjet?

Shën Mëria është shenjtore fetare, për atë shkrimtari thotë se gjendej në mur dhe se nëna me shpresë i kthen sytë kah fotografia e saj në mur.

A mund ta ndihmojë shenjtorja?

A mund t'i japë ajo bukë atij që nuk ka?

Kë dënon autori në këtë tekst?

KROI I FSHATIT TONË

Kroi i fshatit tonë, ujë i kulluar,
Ç' na mburon nga mali duke mërmëruar.

Venë mbushin ujë vashat anembanë,
Cipëzën me hoja lidhur mënjanë;

Cipëzën e bardhë, cipëzën e kuqe,
Gushën si zëmbaku, buzët si burbuqe.

E si mbushin ujë, bubu ç' m' u ka hije,
ndaj kthehen prap me hap nusërie,
ndezur yll i ballit si yll shentërije.

Kroi i fshatit tonë ngjyr' ergjënd i lyer,
Që nga rrëz' e malit ç'na mburon rrëmbyer.

Vejnë pijnë ujë trimat anembanë
Takijen me lule, përmbi sy mënjanë.

Lazgush Poradeci



SHËNIM

Poeti me shprehjet dhe fjalët që përdor në këtë vjershë, si me brushë piktori na e pasqyron bukurinë e kroit të fshatit, ashtu sikundër e sheh dhe e përjeton ai.

Gjeni fjalët me të cilat krahasohet pastërtia e ujit.



FJALË DHE SHPREHJE

mburon – buron
mërmëruar – gurgulluar
venë- shkojnë
cipëz me hoja – shami e qëndisur me lule
shëntëri – diç e shenjtë
rrëmbyer - me vrull
takija – kapela
ergjënd – argjend




BISEDË RRETH VJERSHËS

Si quhet vendi ku njerëzit takohen?
Vendtakim i kujt ishte kroi?
Gjeni vargjet ku përshkruhet bukuria e vajzave shqiptare.
Si i kuptoni fjalët “Kthehen prap me hapa nusërije”?
Lexoni dhe tregoni si i përshkruan poeti vashëzat dhe trimat në kroin e fshatit?



DETYRË

Po t'u pëlqejë shumë, mësojeni përmendsh vjershën.
Këtë vjershë mundohuni ta shkruani sipas drejtshkrimit dhe gjuhës së sotme letrare.



Njohim gjuhën tonë PJESËT KRYESORE TË FJALISË

Kryefjala dhe kallëzuesi

Lexoni tekstin e mëposhtëm dhe vëreni fjalët e shkruara me shkronja të zeza dhe ato të shkruara me shkronja të dorës (kursive).

Rikujtohuni me cilat pyetje do t'ì gjeni ato.

Nxënësit e klasës sonë *vizituan* kopshtin zoologjik.

Ata *panë* kafshë dhe shpendë të ndryshëm. Të gjitha **kafshët** *qëndronin* në dhoma të rrethuara me hekura.

Arinjtë e murrmë silleshin si të mërzitur. **Dhelprat** dinake *lëviznin* pa pushim. **Ato** *donin të gjenin* vrimë për të dalë.

Fjalët e shkruara me të zeza janë kryefjalë, të cilat u përgjigjen pyetjeve: Kush? Cili? Cila? ... etj., që u drejtohen foljeve (kallëzuesve).

Fjalët e shkruara me shkronja kursive janë kallëzues, që u përgjigjen pyetjeve: Ç`bën?, Ç`bëri? etj., që u drejtohen kryefjalëve.



MBANI MEND

Kryefjala është pjesë kryesore e fjalisë që tregon për kë flitet në fjali.

Kallëzuesi, po ashtu, është pjesë kryesore e fjalisë, që tregon se ç`bën kryefjala.

GRUPI I KRYEFJALËS DHE GRUPI I FOLJES (Kallëzuesit)

Rikujtohuni!

Cilat janë pjesët kryesore të fjalisë?

Ç'punë bëjnë pjesët plotësuese?

Analizoni fjalinë e mëposhtme. Gjeni pjesët kryesore duke u shërbyer me pyetjet që i keni mësuar dhe pastaj lidhni pjesët që plotësojnë kuptimin e kryefjalës dhe ato që plotësojnë kallëzuesin.

Rezari i vogël luan me top. Kush?

Kush luan me top?

Rezari i vogël – grupi i kryefjalës.

Babai i Bardhylit punon në fabrikë. Ç'bën?

Ç'bën babai i Bardhylit?


Punon në fabrikë - grupi I foljes.



MBANI MEND

Çdo fjali përmban dy grupe fjalësh:

- **grupin emëror (grupin e kryefjalës), i cili gjendet me pyetjen “kush” dhe grupin foljor (grupin e kallëzuesit), i cili gjendet me pyetjen “ç'bën”**



USHTRIME DHE DETYRA

1. Kopjoni këto fjali dhe dalloni grupin që i përgjigjet pyetjes “kush” ose grupin emëror.

Kësulëkuqja e vogël e do gjyshen.

Nxënësit e vegjël luajnë në oborrin e shkollës.

2. Kopjoni këto fjali dhe dalloni grupin që i përgjigjet pyetjes
ç'bën?, ç'bëri?

1. Gjyshi qeshi me zë të lartë.
2. Nëna rrezikoi jetën për të birin.
3. Ylli u gëzua shumë.
4. Dy shokë të vegjël u takuan te ura.

3. Lidhni grupin e kryefjalës me grupin emëror.

| | |
|------------------------------|-------------------------------------|
| Punëtorët | rriten në pyll. |
| Livadhët | piqen në stinën e vjeshtës. |
| Pemët | gjelbërojnë në pranverë. |
| Drunjtë | shkojnë në uzinë. |
| Një zog i vogël i sapolindur | rrinte struktur pranë nënës së tij. |

2. Zgjeroni grupin emëror dhe grupin foljor me fjalët tuaja.

| | |
|---|---------------------------------|
| Nxënësi i vogël i klasës së katërt | mëson në shkollën fillore |
|---|---------------------------------|

| | |
|-----------|--|
| Një djalë | luan me top në oborrin e shkollës |
|-----------|--|

| | |
|----------------------|----------------------------|
| Gjyshi i Petritit | mbolli një dru molle |
|----------------------|----------------------------|

5. Me ndihmën e fjalëve të dhëna formoni 5 fjali dhe nënvizoni me ngjyrë të kuqe grupin emëror dhe me të gjelbër grupin foljor.
p.sh. ...vijne prej, nga...

Nxënësit e vegjël vijnë nga Struga.

6. Në këta shembuj është bërë ndarje e gabuar e grupeve të fjalëve. Kopjoni fjalitë dhe ndani si duhet grupet e fjalëve.

Macja / e vogël qëndron mbi çati.


Dallëndyshet janë / renditur në tela.

Mjeku shëron / të sëmurët.

Kafshët / e egra fshihen në pyll.

Kali / i zi kullot / në livadh.

7. Përshkruani 5 fjali nga copa e leximit që e keni marrë dhe dalloni grupin emëror dhe grupin foljor.



DHURATA PËR NËNËN

Vetat: Xheni, Bili, Ketri, Drenusha, Lepuroshi, Arithi, Huti i Urtë.

Skena: Pyll, lëndinë, trup në mes i rrethuar me shkurre.

Bili: Oh! Eja të ulemi dhe të pushojmë!

Xheni: (Ulet duke psherëtirë): Vërtet duhet të ulemi.

Ketri: (Paraqitet prapa shkurrës): Mirëdita! – Ç' kërkoni ju të dy në pyll?

Bili: O, tungjatjeta, Ketër!

Xheni: - Kërkojmë dhuratë për nënën. Të dielën është festa e nënës.

Ketri: - Ç' është ajo, Festa e nënës”?

Xheni: - Oh, ajo është dita kur kujtohem i sa e mirë është nëna...

Bili: - E pastaj i japim një dhuartë të vogël, me të cilën i tregojmë dashurinë tonë.

Xheni: - Veçse... ende nuk kemi vendosur çfarë t'i dhurojmë.

Ketri: - O, po kjo është e vështirë! Jepni një kokërr të madhe arre. Unë atë ia kisha dhënë nënës sime.

Xheni: (Duke qeshur) – Mirëpo, nëna jonë nuk është ketër.

Drenusha: (Duke ngritur kokën) – Cila nënë nuk është ketër?

Bili dhe Xheni: - Jona!

Ketrusha: - A! Po ku e kishit fjalën?

Xheni: - Të dielën është festa e nënës...

Bili: - Kurse ne ende nuk kemi zgjedhur dhuratën.

Ketri: - Kjo është dita kur ia rrëfejme dashurinë.


Drenusha: - Pse nuk i jepni një duaj me bar të njomë? Unë nënës time do t'i kisha dhënë një dhuratë të këtillë.

Xheni: - Po, veç se nëna jonë nuk ha bar!

Bili: - Nëna jonë nuk është drenushë!

Drenusha: - Oh! ... Unë e zgjodha gjënë më të mirë

Lepuroshi: (Vjen duke kërcyer rreth trungut) : - Kuptohet. Drenushë! Ti gjithnjë bën ashtu!



Bili: - Tungjatjeta, Lepurosh!

Xheni: - Ndoshta ti do të na propozosh diçka?

Ketri: - Çfarë mund t'i dhurojnë fëmijët nënës së vet për festën e saj?

Drenusha: - Ajo është dita kur me të ndan barin më të mirë që ke gjetur, së paku unë kështu do të kisha vepruar.

Ketri: - Ose ia jep arrën më të madhe.

Lepuroshi: - Kuptoj!... Jepni një karrotë të madhe nga kopshti!

Të gjithë: - O, jo! Jo!

Xheni: - Nëna jonë nuk është lepur!

Bili: - Ende jemi larg përgjigjes së vërtetë...

Arithi: (Paraqitet) - Çfarë përgjigje? Gjë e lehtë. U dëgjova kur bisedonit!...Jepni mjaltë. Këtë do t'ia kisha dhënë nënës sime. Pak mjaltë të ëmbël, të artë.

Xheni: - Mirëpo, nëna jonë nuk është arushë! Ajo, kuptohet, e ha mjaltën, por...

Drenusha: - Nuk u ndihmuan shumë.

Ketri: - M' u kujtua! Haj ta pyesim Hutin Urtak!

Lepuroshi: - Kuptohet! Ai di çdo gjë!

Arithi: - Ai do t'u japë përgjigjen e duhur!

Xheni: - Mirë, të shkojmë tek ai!
(Të gjithë shkojnë te trangu i vjetër i shpuar)

Ketri: - Unë jam mikeshë e mirë e tij. (Thërret): - Zotëri Hut! Zotëri Hut!

Huti: - Kush është? Cili thërret? (Nxjerr kokën nga vrima.)

Ketri: Jam unë, Ketri dhe disa miq të tjerë. Na duhet ndihma jote!

Huti: - Ç' kërkoni prej meje?

Xheni: - Këto ditë kemi festën e nënës, zotëri Hut.

Bili: - Dhe nuk dimë çka t'i zgjedhim për dhuratë.

Lepuroshi: - U përpoqëm t'i ndihmojmë, por...

Ketri: - Asnjëri nga ne nuk gjet diçka të qëlluar për të.

Arithi: - As mjaltën.

Drenusha: As barin.

Ketri: - As arrën.

Lepuroshi: - As gjethin e lakrës.

Huti: - Mirë, mirë... Ka një përgjigje të lehtë e të thjeshtë!

Të gjithë: - Tregoni... Tregoni...

Huti: - Çdo ditë shihni sende për të cilat mendoni se janë të bukura dhe të rralla, ose interesante... apo jo?

Xheni: - Po, ashtu është vërtet!

Huti: - Po, ashtu është vërtet! Ndonjëherë edhe do të thoni: “O, nëna do të kishte dashur të shohë këtë!”

Xheni dhe Bili: - Po! Po!

Huti: - Dhe herën tjetër, kur të gjeni diçka të cilën do të dëshironi që ta shihnte edhe nëna juaj... ajo le të jetë dhurata për të!

Xheni: (E gëzuar): O, e di ç' dëshironi të thoni! Kur vinim kënde, gjatë kohë qëndruam në skaj të pyllit, në një vend përplot me lule fushë. Ishin aq të bukura sa menjëherë dëshirova t'i shikonte edhe nëna.

Bili: - Më kujtohet! Haj të shkojmë t'i mbledhim, Xhen!

Xheni: - Eja, eja pra! (nisen) – Ju falënderojmë, zotëri Hut!

Bili: - Edhe ne ju falënderojmë, Arith, Drenushë, Ketër, Lepurosh!

Do të mbledhim lule të bukura për nënën tonë.

Ketri: - Kurse unë për nënën time do të gjej një arrë të madhe.

Drenusha: - E unë do të mbledh bar të lëngshëm!

Lepuroshi: - Unë do t' i jap nënës një lakër!

Arithi: - Unë do t' i jap nënës pak mjaltë të ëmbël.

Xheni: - Kështu të gjithë do ta kremtojmë ditën e nënës!

Bili: - Sa bukur do të jetë!

(Shkojnë.)



BISEDË RRETH TEKSTIT

Xbun Bar (SHBA)

Pse shkuan Bili dhe Xheni në pyll?

Me cilin u takuan ata në pyll?

Pse u pëlqyen këshillat e kafshëve të pyllit?

Me çka vendosën t'ia urojnë festën nënës?



DETYRË

Përpiquni këtë tekst ta luani në klasë.

PUTHJET E HUMBURA

Na ishte njëherë një djalë që quhej Mark. Ai ishte me sy të zinj, flokë të kuq e me një fytyrë në formën e vezës.

Sa herë që pinte një filxhan çaj, i kujtohej diçka, po nuk arrinte ta qartësonte. Për shembull, i vinin ndërmend biskotat me formën e lepurushëve. Por më shumë se biskotat e kuptonte që i mungonte një gjë mjaft e rëndësishme: puthja e çdo mbrëmjeje. Ajo asnjëherë nuk i vinte në orare të njëjta. Madje kishte raste që flinte dhe pa puthje. Kur kishin njerëz për darkë, mamaja nuk ngjitej në dhomën e tij për t'i dhënë puthjen e shumëpritur. Atë natë ajo puthje quhej e humbur. Gjatë asaj nate Marku shihte ëndrra të tmerrshme.

Ai ishte një fëmijë që mendonte më shumë se sa duhej për moshën që kishte. Vuante nga astma dhe shpesh në pranverë i merrej fryma. Po ilaçi më i mirë për të, ishte puthja e mamasë së tij.

Kur ishin me pushime, Marku dhe vëllai i tij shkonin gjithmonë te halla e tyre, që e kishte shtëpinë mes gjelbërimit e ajrit të pastër. Të dy vëllezërve u pëlqente shumë të hanin luleshtrydhe. Në mbrëmje, ata shikonin filma të mrekullueshëm dhe imagjinonin sikur ishin edhe vetë aktorë.

Të gjitha këto që lexuat më sipër, i tregon tani Marku i rritur. Ai u bë një shkrimtar i madh dhe kjo ndodhi, sepse ai gjeti një bllok ku kishte shënuar të gjitha puthjet e humbura. Në këtë bllok ai kishte pikturuar dhe një filxhan çaji si dhe disa luleshtrydhe. Tani nuk ka ndryshuar ndonjë gjë e madhe në fytyrën e Markut, përveçse i kanë rënë flokët dhe mban syze.

Rita Petro



FJALË DHE SHPREHJE

imagjinoj – mendoj sikur bëj diçka, fantazoj
astma – sëmundje e frymëmarrjes
aktor – ai që luan një rol në teatër, film



BISEDË RRETH TEKSTIT

Ç'pinte më shumë Marku?
Çfarë mendonte Marku kur pinte çaj?
Çfarë ëndrrash shihte Marku kur mamaja nuk e puthte?
Kur filloi Marku të shkruajë libra?
Si ndryshoi Marku kur ishte i ri dhe kur u plak?



DETYRË

Përshkruaje portretin e Markut.



Njohim gjuhën tonë
LLOJET E FJALIVE
(Sipas përbërjes)

Bardhyli dhe Luljeta i kaluan pushimet në fshatin e gjyshit dhe të gjyshes. Koha ishte shumë e freskët. Bardhyli e çonte kopenë e lopëve në fushë. Ngandonjëherë ndalej pranë një lumi dhe me kënaqësi e shikonte ujin e kthjellët.

Fatmiri luan. Gjeli këndon. Rrushi vilet në vjeshtë.

Vëreni fjalitë e tekstit të mësipërm.

Krahasoni këto fjali me fjalinë e fundit të tekstit „Në fshat”. Ngadonjëherë ndalej pranë një lumi dhe me kënaqësi e shikonte ujin e kthjellët.

Veçoni grupin emëror dhe atë foljor në këto fjali.

Sa grupe fjalësh përmbajnë këto fjali.

Sa grupe fjalësh përmban fjalia e fundit e tekstit?

1. Dielli rrezeartë perëndoi prapa maleve.
2. Anëtarët e rinj diskutuan për rregullat e klubit.
3. Gurgullima e lumit dëgjohet gjer në shtëpinë e tij.

Zgjerimi i fjalisë më të vogël

Një fjali jo vetëm që mund të thjeshtohet (shkurtohet) duke hequr pjesët e saj plotësuese, por edhe mund të zgjerohet. P.sh. Iliri luan. Arta shkruan. Iliri luan futboll në oborrin e shkollës. Arta e vogël shkruan një letër.



USHTRIME

1. Zgjeroni dy fjalitë e mëposhtme me fjalët e dhëna nën to.

Fëmijët notojnë .

i vogël një valë

nga ujë

të gjitha i freskët

anë i liqenit

vendi i bukur

ynë Ohër

Qengjat kullosin.

i vogël në livadh

i shkruar i gjelbër

me lloj-lloj i qëndisur

ngjyrë me lule

– të ndryshme

–

2. Përshtatni kryefjalën me kallëzuesin.

Sot unë (kemi) ditëlindjen. Ne po (festoj). Unë po (bën) listën e gjërave. Nëna me motrën po (bëj) një tortë të madhe. Unë (presim) shokët. Ata më (dhurove) një robot.



MBANI MEND

Kryefjala dhe kallëzuesi përshtaten njëri me tjetrin.

Po të jetë kryefjala në numrin njëjës edhe kallëzuesi (folja) vihet në numrin njëjës. P. sh.: Nxënësi shkruan.

Po të jetë në numrin shumës edhe kallëzuesi do të jetë në numrin shumës. P. sh.: Nxënësit shkruajnë.



NA LUSIN MALET

Shpesh eci malit e më duket,
se një dru më lut ngadalë:
- Mbylle briskun, vëlla i vogël,
unë marr vesh edhe me.....

Kopshtit dal që të shëtis,
endem parkut të qytetit,
më lut lulja ta.....,
vetëm që s' qan prej sikletit.

Endem, endem, nëpër botë,
kur ja, vij te një djerrinë,
ndi'j si m' thotë: paj, do fidane
do të ma shtonin.....!

Kam qëlluar zemërbutë,
për bimë të blerta kam kujdes,
ato s' flasin por do zogj
..... për çdo mëngjes!

Agim Deva



SQARIM

Në katër vargje të kësaj vjershe mungon nga një fjalë. Mendo dhe nëse i gjen shkruaji ato fjalë ku gjenden pikat. Në qoftë se nuk mund t'i gjesh, atëherë këto fjalë i ke të shkruara në fund të faqes. Vëre çdo fjalë në vargun e vet!

Fjalë ujis hijeshinë cicërojnë

KLASA E ZBUKURUAR

Cingërima e ziles u përhap nëpër korridoret e gjata dhe të qeta të shkollës. Dyert e klasëve u hapën dhe qetësia u prish saora. Nxënësit, me çanta në duar dhe gëzim në fytyrë u shpërndanë nëpër shtëpitë e veta.

Vetëm në klasën e mësueses Fatbardha dëgjoheshin ende disa zëra. Vajzat ishin tubuar tok dhe nuk donin të dilnin nga klasa, kurse djemtë kishin ngulur këmbë të kuptonin se ç' kishin ato që atë ditë donin të veçoheshin e të bënin diçka tinëzisht – fët e fët.

- Jo, nuk dalim kurrë pa na treguar se ç' doni të bëni – u thonin ata.

- O, e pamundshme! Ju kërkoni shumë prej nesh – ua pritni Alisja, më e vogla e klasës.

- Këso shoqesh na qenkeni ju! –ua ktheu Visari duke u endur nëpër klasë me shqetësim dhe shtoi: - Megjithatë, unë e di se pse doni të ndaleni.

- Kurrë nuk mund ta dish! Hë, pse? – iu drejtuan vajzat me një zë.

- Doni të mësoni pa ne. Jeni bërë ziliqare dhe doni të tregoni se dini më shumë se ne. A nuk është kështu? A nuk ia qëllova?...

Vajzat, të gjitha të habitura, kërcyen gati me një hov:

- O, jo, nuk e kemi për atë! Pse të të bëhemi ziliqare?!

- Po mirë, tregoni pra, ç' keni kështu? - pyeti dikush tjetër.

- Kurrë nuk jeni ndarë prej nesh, ndërsa sot, të gjitha përnjëherë...

Vajzat nuk donin të thonin asnjë fjalë se ç' mendonin. Ato kundërshtuan edhe njëherë:

- Ajo është punë për ne. Tani mund të shkoni!...

- O, jo! Kurrsesi! – thanë djemtë me vedosmëri. – Ne nuk dalim aq lehtë, si po mendoni ju.

- Nuk ka kuptim të ngulni këmbë për asgjësend – u ankuan ato.

- Mirë, vetëm tregoni qëllimin dhe po shkojmë – ua ktheu prapë

Visari, që të shuante kërshërinë, e cila i qe futur thellë në zemër, si diçka therëse dhe e gjallë.

- Do të kuptoni nesër – u thanë ato.

- Po ju betohemi! – shtoi Alisja plot sinqeritet. – Vetëm duroni deri nesër.

Djelmoshat shikuan njëri-tjetrin. Kurrsesi nuk ua merrte mendja të shkonin. Nuk do të dinin të ecnin të qetë nëpër rrugë, nuk do të mund të drekonin, nuk do të dinin të mësonin gjë e ndoshta as natën nuk do të mund të flinin! Aq e gjatë do të dukej ajo kohë gjer nesër!

Mirëpo atë çast ndodhi diçka e papritur.

- Ih, nesër! – thirri Galdimi si i zgjuar. – Njëmend ju jeni të çuditshme. Nesër, hë? Tani e di se ç' mund të ndodhë nesër!

- Të gjithë u drejtuan kah ai dhe e shikuan gati pa frymë.

- Hë, fol! Ia qëlllove?

- Kurrë nuk mund t'ia qëllojnë kësaj gjëje djemtë – ua ktheu prapë Alisja, duke kërcyer me llastim.

- Doni të zbukuroni klasën për tetë marsin, apo jo?

Në klasë shpërtheu një zhurmë e madhe. Vajzat nuk mundën ta ruajnë më fshehtësinë e tyre.

- Eh, mirë, mbasi e kuptuat, dilni nga klasa dhe na lini të qetë – u tha Zana kur mori fund zhurma.

- Jo, nuk dalim! – prapë djemtë ngulën këmbë.

- Bëhuni shokë të mirë! – iu lutën ato.

- Po pse, edhe ne mund të zbukurojmë klasën – murmuritën ata.

- Ju nuk keni të drejtë të përziheni në punën tonë. Kjo është festa jonë, andaj – jashtë! – urdhëruan vajzat.

- Festa na takon edhe neve – kundërshtuan djemtë.

- Nuk ju takon!

- Na takon!

- Jo!

- Po!

- Ne nuk punojmë gjersa nuk shkoni ju.

- Mos doni të thoni se mësuesja është vetëm juaja.

Vajzat heshtën. Dëshën të kundërshtojnë, por fjalët u mbetën në fyt.

- A nuk kemi nëna edhe ne? A nuk paskemi të drejtë të gëzohemi edhe ne për festën e tyre? – vazhduan kundërshtimet si rafal.

Vajzat u detyruan t'i pranojnë në zbulimin e klasës.

Dhe ç'të shohësh mandej! – puna shkoi më mbarë se e bletëve dhe më e shpejtë se e fluturave. Njëri vrapoi për letra, tjetri për ngjyra, dikush solli gërshtërit nga shtëpia, disa të tjerë sollën lule... dhe klasa u bë si një lulishte e bukur magjike...

Të nesërmen mësuesja Fatbardha, porsa u gjend në prag të klasës, mbeti pa frymë nga habia. Mandej hyri ngadalë, duke buzëqeshur dhe duke soditur klasën e zbuluar me aq mjeshtëri e kujdes. Shikoi fytyrat e gëzuara të nxënësve dhe në secilën prej tyre lexoi urimin drejtuar asaj për të kremten e dashur...

Qamil Batalli



BISEDË RRETH TEKSTIT

A vepruan mirë vajzat e kësaj klase që dëshironin vetëm ato të befasonin mësuesen?

A kishin të drejtë djemtë, që me aq ngulmim dëshironin të dinin se ç'përgatitnin vajzat?

A duhet të ketë këso fshehtësish ndërmjet shoqeve dhe shokëve të klasës?

Kush e zbuloi se ç'dëshironin të bënin vajzat?

Përse e befaso i aq shumë mësuesen kjo dhuratë?

Çfarë kremte është 8 Marsi?



DETYRË

Mos veproni edhe ju si vajzat e kësaj klase. Bashkëpunoni me djemtë dhe përgatitni një befasi të tillë për arsimtaren tuaj për 8 Mars.

Lexoni ndonjë tregim a vjershë për 8 Marsin.

ATDHEU IM

Nxënësit posa ishin ulur nëpër banka, kur mësuesi bërtiti me zë të fortë si bori:

- Mësim edukativ!

- Mësim edukativ. Omeri dëshironte që orën ta shfrytëzonte për të ngrënë copën e bukës, që e kishte ruajtur në xhep dhe që nuk mund t'ia jepte Vesitit.

Mësuesi bëri disa hapa midis bankave. Fërkimi i shurdhët i thembrave nëpër banka, zhurma, qeshja, shushuritja – krejt pushuan. Si për çudi në mësojtore zotëroi qetësia e plotë. Frymëmarrja u ngadalësua dhe nxënësit u shndërruan vetëm në veshë. Po, përveç palëvizshmërisë së tyre, nëpër mësojtore ndihej njëfarë gëzimi i lehtë, i ëmbël dhe i purpurtë.

I kënaqur, zotëri Hasani shkoi te katedra dhe shfletoi fletoren e trashë.

- Mëmëdheu!

Kjo fjali u prit me njëfarë ftohtësie. Nxënësit nuk kuptuan gjë.

- Cili nga ju di se ç' është **mëmëdheu**?

Nxënësit u ngjallën dhe e prishën qetësinë e klasës. Mësuesi i ra me thupër njërës bankë, që t' i qetësonte. Nxënësit përgjuan rreth e përçark, shikimet u kryqëzuan midis bankave, nëpër muret, në dritare e rrëshqitën nëpër fytyrën e mësuesit. Kuptohej se atdheu nuk ishte në mësojtore. Nxënësit vështronin njëri - tjetrin. Disa s' merrnin pjesë fare, por pritnin me durim dhe kureshtje.

Brahim Bali e çoi gishtin. Shiko, shiko! Ai të dijë. Sigurisht, e ka përsëritur klasën.

- Franca është atdheu ynë i dashur! – murmuriti Brahimi.

Ai fliste nëpër hundë si çdo nxënës tjetër kur lexonte. Kur dëgjuan

këtë, të gjithë filluan t'i çojnë gishtat; tani të gjithë filluan të përsëritnin të njëjtën frazë.

Me buzë të shtrënguara Omeri përtypte një kafshatë bukë. Franca, me kryeqytetin, Parisin. Ai e dinte atë. Francezët që i shihte nëpër rrugë, kishin ardhur prej atij vendi. Që të shkosh atje ose të kthehesh që andej, duhet ta kalosh detin, të udhëtosh me anije... deti – deti Mesdhe. – Omeri kurrë nuk kish parë det, as anije. Por ai e di: deti është një hapësirë e madhe me ujë të shllintë e anija diçka si dërrasë që noton. Franca – vizatim shumëngjyrësh. Si mund ai vend aq i largët të jetë mëmëdheu i tij? Ai nuk lindi atje. Ai nuk leu në dy vende. Vendlindja e tij është Franca. Omeri vetëm që hëngri një rrenë. Mëmëdheu ose jo – Franca s' ishte mëmëdheu i tij. Ai mendonte rrena vetëm që të shpëtonte prej purtekës së ullirit...

Nxënësit ndërmjet tyre thanë: ai që di më së miri të rreshtojë rrenat e veta, ai është nxënësi më i mirë i klasës.

Omeri mendonte për shijen e bukës që e kishte në gojë. Mësuesi kishte qëndruar afër tij dhe mendohej që përsëri ta qetësonte klasën. Një luftë e madhe po ngjallej në shpirtin e fëmijëve. Zotëri Hasani e fillonte mësimin.

- Mëmëdheu është vendi i etërve tanë, vendi ku jetojmë qysh para shumë brezave.

- Mësuesi foli gjatë dhe tregoi se ç' është mëmëdheu. Nxënësit e qetësuar shkruanin çdo fjalë të tij...

- Kur të huajt vijnë nga jashtë dhe dëshirojnë ta pushtojnë, atëherë mëmëdheu është në rrezik. Ata, të huajt janë armiq, prej të cilëve gjithë populli duhet ta mbrojë atdheun e trembur. Atëherë parashtrohet çështja e luftës. Njerëzit duhet ta mbrojnë atdheun dhe për të ta japin edhe jetën – tha mësuesi.

Cili ishte mëmëdheu i tij? Omeri dëshironte që mësuesi këtë t' ia tregonte, që ta dinte. Cilët ishin armiqtë e atdheut të tij? Omeri s'kishte

guxim ta hapte gojën dhe të pyeste...

Ata që e duan shumë mëmëdheun e vet dhe punojnë për të mirën e tij quhen – atdhetarë.

Zëri i mësuesit tingëllonte solemnisht dhe përhapej nëpër mësojtore.

Zotëri Hasani ecte para e prapa ndërmjet bankave.

A ishte edhe ai atdhetar? A ishte atdhetar edhe Hamit Saraji? Si mund të jenë që të dy atdhetarë? Mësuesi të ishte, të themi, njëri nga pishtarët, kurse Hamit Saraji – njëri, të cilin policia e kërkonte shpesh. Atëherë cili nga ata të dy është atdhetar?...

Omeri u çudit kur dëgjoji mësuesin të flasë arabisht. Ai që i ndalonte të flitnin këtë gjuhë! A është e mundur! Për të parën herë mësuesi fliste arabisht.

Me zë të ngadalshëm, por të vendosur, mësuesi tha:

- Nuk është e vërtetë nëse ju thonë se Franca është mëmëdheu i juaj. Ajo është rrenë!

Më në fund Omeri e dinte se ajo ishte rrenë.

Zotëri Hasani u habit. Një kohë ai qëndroi si i habitur. Sikur përgatitej të thoshte edhe diçka. Por çka? A s' e pengonte ndonjë fuqi më e madhe?

Dhe kështu ai s' u tregoi fëmijëve se cili ishte atdheu i tyre.

Ata e dinin: Algjeria.

Mubamed Dib



SHËNIM

Ngjarja është e vendosur në Algjeri para se ky shtet të fitonte pavarësinë.



BISEDË RRETH TEKSTIT

Cilën pyetje e kishte bërë mësuesi?

Po si u përgjigj nxënësi Brahim Bali?


A u pajtua Omeri se Franca është atdheu i tyre?

Pse u befasuan nxënësit kur mësuesi filloi të flasë arabisht?
A e dinin nxënësit se kush ishte atdheu i tyre?
Kush e pengonte mësuesin që t'ua shpjegonte nxënësve se cili ishte atdheu i tyre?



DETYRË

Gjeni në tekst se ku janë dhënë shpjegimet për fjalën atdhetar.
Nënvizoni me laps të thjeshtë fjalët me të cilat përshkruhet se çfarë duhet bërë kur atdheu është në rrezik.



TREGIMI PËR SHIUN

Retë i mbushën cisternat e veta me ujin e oqeanit dhe u ngritën në qiell. Në lartësi të qiellit u rrokën dorë për dorë, bënë një kompozicion të gjatë dhe morën rrugën kah fushat e largëta të thara. Një lokomotivë e fuqishme e zjarrtë i tërhiqte nëpër hekurudhën e padukshme qiellore.

Posa arrinë mbi një luginë, para tyre doli milici i qarkullimit i mrrolur në fytyrë.

- Stop! – e ngriti tabelën e kuqe para hundës së lokomotivës. – Të shoh se çka bartni?

- Nuk kemi gjë tjetër veç ujit të oqeanit, u përgjigj makinisti.

- Mirë, - tha milici i qarkullimit. – Por, sipas rregullave të qarkullimit ajror, ju i kini ngarkuar rëndë cisternat! Nuk u lejoj të vazhdoni udhëtimin me atë barrë të rëndë! Stop!

- Kemi detyrë të shkojmë te Lugina e thatë dhe ta ujisim – u përgjigj makinisti. – Jemi të detyruara... Na lejo të kalojmë!

Fjalë pas fjale, makinisti me milicin e qarkullimit ranë në mosmarrëveshje të rëndë. Meqenëse nuk u morën vesh me fjalë, i nxorrën shpatat dhe filluan dyluftimin. Nga goditjet e fuqishme buçiste tërë qielli. Shpatat e zjarrta prisnin çdo gjë që u dilte para, kështu që nuk i kursyen edhe cisternat e mbushura me ujë.

Dhe ç' ndodhi pastaj me ujin? Po, asgjë. Nisi të rrjedhë, të derdhet dhe të vërshojë...

Fëmijët që nuk e dinin shkakun e vërtetë pse rridhte aq shumë ujë, thirrën plot gëzim:

- Ç' na kënaqi ky shi i mirë!

Vidoe Podgorec



FJALË DHE SHPREHJE

cisternë – enë e madhe për bartjen e ujit dhe lëngjeve të tjera
bënë një kompozicion të gjatë – bënë një varg të gjatë



BISEDË RRETH TEKSTIT

- Ky është një tregim i imagjinuar.
- Ç'është e vërteta dhe ç'është e pavërteta në këtë tekst?
- Në çka u shndërrua mosmarrëveshja ndërmjet makinistit dhe milicistit?
- Kush u gëzua për shiun që binte?



DETYRË

Gjeji dialogët dhe kopjoji në fletore!



JEMI KOPSHTARË

Bela dhe lopata
Gjithë kemi marrë,
Dimë të punojmë,
Jemi kopshtarë.

Ja dhe nëpër grupe
Mësuesja na ndan'.
Njëri çel një gropëz,
Tjetri brazdën çan.

- Mbille grurin mirë!
- Mbille mirë, panxharë!
- Hidhe plehun imtë!
- Mos e ngjish ugarë!

- Mos e ngjish ugarë,
Se mban lagështirë!
Pastaj far' e mbjellë
Të mbetet pa mbirë.

- Dil, o diell, ngrohi!
Bjer', o shi, ujiti!
Kopshti shpejt e shpejt
Bimët të na rriti.



FJALË DHE SHPREHJE

bel – mjet për punë si lopata
brazdë – vijë e gropuar në tokë, ulli
mos e ngjish ugarë – mos e lër pa punuar

Xhevat Beqaraj



BISEDË RRETH VJERSHËS

Çfarë bënin nxënësit në kopsht?
Me se punonin ata?
Shpjegoni strofën e fundit.



DETYRË

Nëse shkolla juaj ka kopsht, përshkruaj me fjalët e tua se ç'punë keni bërë ju bashkarisht në të dhe ç'dobi keni prej asaj pune.



Nga mirësjellja

NË EKSKURSIONIN SHKOLLOR

Eni tani “të udhëtojmë” në ekskursionin shkollor. Aty do të qëndrojmë disa ditë. Për këtë duhet të përgatitemi. Ta miratojmë planin, si do t'i kalojmë ato ditë të pakta.

Nëse nisemi pa plan, pa përgatitje, menjëherë që në ditën e parë, do të shohim se kemi bërë “buti”. Pse?

Dhe të fillojmë nga higjiena. Më parë do të betoni se nuk e keni marrë brushën për dhëmbë. Po brusha për dhëmbë nuk huazohet, këtë mirë e dini. Nuk është higjienike. Megjithatë, do ta blini. Dikush ka marrë me vete mjaft të holla, dikush jo. Dhe të hollat gjithashtu nuk huazohen kur jeni jashtë shtëpisë. Atje nuk janë prindërit tuaj që t'u kërkonin. Duhet të mbani llogari se për çka i shpenzoni.

Mbani mend atje ku ja behin “ekskursionistët”, hëpërhë gjendet ndonjë “tregtar” që ju ofron “xhingle-mingle” e nëse fluturoni si miza në mjaltë, ju fluturojnë edhe të hollat...Ekskursioni juaj sapo ka filluar. Prandaj mos shpejtoni. Është mirë që në fund të ekskursionit t'u mbetet ndonjë qindarkë në xhep, dhe me të të keni mundësi të bleni ndonjë dburatë për të afërmit tuaj.

Kuptohet se këtu ka vend të flitet edhe për shumë gjëra të tjera të ekskursionit shkollor... për të cilat mund të bisedoni me shokët, mësuesen dhe prindët tuaj.



FITON MENDJA, JO FUQIA

Një luan plak u nis të shkojë te bishat e pyllit. Ecte e mburrej me të madhe, brruronte sa tundej dheu.

- S'ka e s'ka në botë më trim e më të fortë se unë! Jam mbret mbi të gjithë! – thoshte luani plak.

Udhës gjeti një ari plak, të çalë: s' di se kur e kish goditur me sëpatë një bari. Ariu tha:

- Mos u mburr kështu, o luan. Në botë ka një trim më të fortë se ti.

Luani u zemërua:

- Kush është më i fortë se unë? Fol!

- Njeriu, - u përgjigj ariu.

- Ku është njeriu? Dua ta shoh.

- Dil në fushë e do ta gjesh, - i tha ariu.

Luani zuri të bredhë fushave për të kërkuar njeriun. Në një luginë pa një kalë që po kulloste. Këmbët i kish të lidhura. Luani iu afrua dhe i thirri me të madhe:

- Cili je ti, o barngrënës?

- S' më she? Jam kali.

- Kush të ka lidhur kështu me tërkuzë?

- Njeriu.

- Ku është njeriu?

- Shkoi në mal për dru.

Luani u nis për në mal. Udhës pa dy qe të mbrehur në parmendë.

“Patjetër, tha luani, këta janë njerëz?, dhe iu afrua.

- Hej, ç'jeni ju që rrini të mbrehur në zgjedhë? - i pyeti ai.

- Ne jemi qe.

- Ç'bëni këtu?

- Gjer tani lëruam tokën. Tani po çlodhemi pak.

- Kush ju ka vënë në zgjedhë?

- Njeriu.

- Ku është njeriu?
 - Ja, andej, prapa atyre drunjve. Po gërmon një gropë të thellë që të bien brenda bishat e pyllit.
 Luani u nis e shkoi te njeriu. Ky e kish mbaruar së gërmuari gropën dhe e kish mbuluar me degë plot fletë. Luani e pa dhe brruroi me të madhe para tij. Njeriu u tremb.
 - Pse ke ardhur tek unë? – e pyeti njeriu luanin.
 - Dua që të matemi bashkë e të shohim kush është më i fortë, ia ktheu luani: - Më kanë thënë se gjoja ti qenke më i fortë se të gjithë.
 - Po si të matemi?
 - Me luftë. Do të luftojmë bashkë e do të shohim se kush do të dalë më i fortë.
 - Mirë, iu përgjigj njeriu. – Po më parë hajt të shohim kush do të kërcejë më shumë.
 - Hajt, të shohim, - ia ktheu luani. – Fillo ti.
 Njeriu mori hov, kërceu dhe arriti gjer në buzë të gropës që kish gërmuar vetë. Vuri atje si shenjë një gur dhe u hoq mënjanë.
 - Tani e ke radhën ti, o luan.
 Edhe luani mori hov; kërceu shumë më larg sesa njeriu dhe ra brenda në gropë.
 Njeriu qeshi dhe iu afrua gropës, ku po përpëlitej mbreti i bishave të egra. Njeriu mori sëpatën, mbyti luanin, ia rropi lëkurën, bëri opinga dhe rripa. Kështu, me mendje, njeriu e mundi luanin.

Tregim popullor



FJALË DHE SHPREHJE

brrurëronte – zëri që nxirte luani
 mburej – lëvdohej
 tërkuzë – litar
 të mbrehur – të vënë në zgjedhë
 plot fletë – plot gjethe



BISEDË RRETH TEKSTIT

Cila është kafsha më e fuqishme në botë?

Kë e takoi luani rrugës?

Çfarë i tha ariu luanit?

Pse luani u zemërua?

Çka i ndihmon njeriut që të jetë më i fuqishëm se çdo krijesë?



DETYRË

Ritregojeni me shkrim këtë përrallë.



FJALË TË URTA PËR DITURINË DHE LIRINË

Delen që ndahet nga tufa e ha ujku.

Liria s'falet, por me gjak fitohet.


Ku s'ka shkolla, ka burgje.

Dituria të del zot gjithkund.

Dituria është drita e jetës.

Më mirë të dish se të kesh.

Ku s'ka dituri ka varfëri.



DUART MË TË BUKURA

Personat: Miranda, Lirika, Plaku, Edlira.

Dekori: Në sfond një kopsht. Duken dy vajza të bukura e të vogla. Janë Miranda dhe Lirika. Pak më tej është Edlira duke larë disa plaçka. Miranda dhe Lirika bisedojnë. Edlira nuk i vë

MIRANDA: Shiko, shiko se ç' duar të bukura kam unë (ia tregon shoqes).

LIRIKA: Më të bukura se të miat nuk i ke kurrë. Shiko se ç'gishtrinjtë hollë e të gjatë kam unë.

MIRANDA: Sa lart po e ngre veten, moj Lirie!

LIRIKA: E ku mund të maten duart e tua me bardhësinë e duarve të mia!

MIRANDA: Oj, ç' na thënke!

LIRIKA: Ashtu si të thashë, ashtu është.

(Hyn në skenë një burrë i hipur mbi një karrocë të ngarkuar me dërrasa. Vajzat sa e shohin, ngrihen dhe i drejtohen atij).

MIRANDA: O xhaxhi, na trego se cila nga ne të dyja i ka duart më të bukura!...

PLAKU: (I vështron) Jua tregoj unë, moj vajza. Po më parë më ndihmoni të shkarkoj këto dërrasa, se u duhen atyre të peshkimit.

LIRIKA: (Vështron shoqen). Të ndihmojmë ne?!... Dërrasat na i prishin duart. Po shiko ç' duar të mrekullueshme kam unë, duar që nuk duhet të bëjnë punë tjetër, vetëm t'i bien pianos dhe violinës!

MIRANDA: Mua më nxihen dhe kam frikë se mos më futet ndonjë ashkël në gisht. Nuk mund të të ndihmoj.

PLAKU: Mirë, moj bijat e xhaxhait. Kur është kështu, prisni sa të shkarkoj karrocën dhe, si të ha një kafshatë bukë, do t'ju them se cila nga ju i ka duart më të bukura.

(Plaku largohet dhe i drejtohet Edlirës që është duke larë rroba në anën tjetër të skenës).

PLAKU: Të qoftë puna e mbarë, moj bijë!...

EDLIRA: Ja, po laj shamitë dhe çorapet.

PLAKU: Pse s'ia le nënës?

EDLIRA: Ajo shkon në punë. Unë çorapet dhe shamitë mund t'i laj shumë mirë vetë.

PLAKU: Të lumshin duart, bijë. Po a do të më ndihmosh dhe mua të shkarkoj këtë karrocë me dërrasa.

EDLIRA: E si mos të të ndihmoj, xhaxha!...

PLAKU: Rrofsh, moj bijë, dhe të falemnderit shumë për ndihmën tënde.

EDLIRA: S' ka pse të më falënderosh, xhaxha. Ne e kemi për detyrë që të ndihmojmë çdo njeri kur ka nevojë.

PLAKU: Jo, jo, duhet të të falënderoj. I shikon ato dy vajzat atje, që po rrinë?...

EDLIRA: Po xhaxha. Ato nuk bëjnë punë tjetër: gjithë ditën vetëm i tregojnë duart njëra-tjetrës.

PLAKU: Hajde me mua, bija ime.

(Shkojnë te të dy vajzat).

MIRANDA: Jo... Unë i kam më të bukura.

LIRIKA: Jo, unë...

MIRANDA: Unë, xhaxha.

PLAKU: Më dëgjoni. Shikoni këto duar! (Merr duart e Edlirës dhe ua tregon të dyja vajzave). Këto duar që ndihmojnë nënën, janë një mijë herë më të bukura se duart që ndihmojnë nënën, janë një mijë herë më të bukura se duart tua të bardha, me gishtrinjtë të hollë dhe të gjatë. Për këto duar ka nevojë familja dhe vendi. Më kuptuat?!...

(Edlirës) Ikim, bijë!...

Plaku dhe Edlira largohen. Të dyja vajzat ulin kokën dhe dalin të turpëruara.

Bie perdja.



FJALË DHE SHPREHIJE

sfond – fusha e një tabloje
plaçka – tesha
nuk i vuri re – nuk i pa, s'i diktoi
skenë – binë ku luajnë aktorët



BISEDË RRETH TEKSTIT

Për se bisedonin Miranda dhe Lirika?
Ç'bënte Edlira?
Kush hyri në skenë?
Çfarë i thanë dy vajzat plakut?
Po plaku çfarë u tha atyre?
Pse ato dy vajzat nuk i ndihmuan plakut?
Po Edlira a e ndihmoi plakun?
Çfarë u tha plaku dy vajzave që s'e ndihmuan atë?



DETYRË

Shkruaje shkurtimisht përmbajtjen e kësaj pjese.



LULJA E PYLLIT

Shëtija pyllit
Dhe mirë e di,
Doja të mbetem
Vetë në qetësi.

Porse një lule
Pashë në një hije,
Si syri të bukur,
Yll mrekullie.

Desha ta këpus,
Por ma preu vrik:
“Kaq herët duhet
T' vyshkem, o mik?”

Por prapë s'e lash,
Me rrënjë e nxora,
Në shtëpinë time,
Lulen e mora.

N' saksu e mbolla
Me këto duar,
Ku dhe sot ajo
Lulëzon e gëzuar.

Johan V. Gete (Gjermani)



BISEDË RRETH VJERSHËS

Ku shëtiste djali?

Çfarë i tha lulja kur deshte ta këpusë?

Si e nxorri nga rrënja?

Pse kudo nëpër parqe shkruan “Mos i këputni lulet”!

Çfarë kujdesi kërkojnë lulet nga ne, njerëzit?

Ekologjia na mëson të kujdesemi për bimët, kafshët dhe gjithë ambientin jetësor.

BASHKIMI ËSHTË I NEVOJSHËM EDHE NË LOJË

Një ditë fëmijët dolën përjashta për të luajtur.

- Ejani të ngjitemi përpjetë deri tek ai lis i madh – tha Vera.

- Jo, ejani më mirë të zbresim teposhtë deri në liqen – tha Iliri.

- Nuk duam! Nuk duam! – ia priti Vera.

- Duam! Duam! – tha Iliri.

- Meqenëse nuk patën mundësi të merren vesh, të gjithë ngelën ku ishin. Kurrkush nuk shkoi kurrkund.

- I ati i tyre, që i dëgjoi këto fjalë mosmarrëveshjeje, u tha:

- Nëse nuk pajtoheni në mendime, nuk mund të bëni asgjë. Duhet të merremi vesh. Mos u ngutni! Mendoni pakëz, që ta gjeni ju vetë se si është më mirë.

Ndërkaq u kujtua Mentori.

- Ejani më parë të ngjitemi përpjetë deri tek ai lis i madh, e pastaj të ngarendim teposhtë deri në liqen.

- Ky është një mendim i mirë – tha i ati, dhe e pyeti më parë Verën:

- A pajtohesh ti?

- Pajtohem, u përgjigj Vera.

- Po ti Ilir, a pajtohesh?

- Pajtohem, u përgjigj Iliri.

- A pajtoheni të gjithë? – pyeti edhe një herë i ati i tyre.

- Pajtohemi! – u përgjigjën me zë të lartë të gjithë fëmijët.

- Në këtë mënyrë të gjithë u ngjitën përpjetë deri te lisi i madh.

- Pastaj ngarendën teposhtë, në liqen.

Të gjithë mbetën të kënaqur.

Sipas Perl Bak (SHBA)



BISEDË RRETH TREGIMIT

Pse s'u morën vesh fëmijët?

Si i këshilloi babai ata?

Pse mbetën të kënaqur në fund, të gjithë fëmijët mbasi u morën vesh njëri me tjetrin?

Ç'do të ndodhte sikur të mos e dëgjonin babanë e tyre?



DETYRË

Vëri këtë tregimi një titull tjetër, që mendon se i përshtatet edhe më mirë.



FJALË DHE SHPREHJE

e plotësonte në çast – e plotësonte menjëherë, aty për aty

ndërkohë – në atë kohë

ilaçe – barna



GËZIMI I VERËS

Sa e mërzhitur dukej atë ditë Vera! Gjatë katër orëve të mësimit s'e pa njeri të qeshë. Kishte lënë Arbenin, vëllanë më të vogël, të sëmurë, prandaj ishte mërzhitur. Kur tingëlloi zilja e orës së fundit doli e para nga klasa dhe shkoi shpejt në shtëpi.

- Nënë, si u bë Beni? - e pyeti nënën me një frymë.
- Vazhdon të ketë ethe, Vera!
- Po fle? – pyeti përsëri vogëlushja e pikëlluar.

* * *

Kur Vera u ul në karrige pranë shtratit të vëllait, ky hapi sytë e skuqur e të ndritshëm nga ethet.

- Si je tani? – e pyeti Vera me zë të ëmbël e plot dhimshuri.
- Më mirë jam! – u përgjigj Beni si i lodhur.
- Vera buzëqeshi e lehtësuar.
- Të dhemb koka?
- Pak! – u përgjigj Beni.
- Vera filloi t'ia fërkojë lehtas kokën, e Beni dalngadalë u qetësua dhe e zuri përsëri gjumi.

* * *

Tërë ditën Vera i qëndroi te koka të vëllait të sëmurë. Mësonte aty, pranë tij. Sa herë që Benit i duhej diçka, ajo ia plotësonte në çast. Ajo i tregonte edhe përralla të bukura, që e kënaqnin aq shumë Benin e nganjëherë e bënin edhe të qeshte.

Kaluan pesë ditë. Tanimë Arbeni i vogël e ndjente veten shumë mirë. Sa u gëzuan prindërit dhe e motra!

* * *

- Kur të jetë më mirë, silleni edhe një herë për kontroll! - i kishte

porositur mjeku.

- Kështu, nëna e Vera e çuan Benin te mjeku.

- Po kjo, e motra është? – pyeti mjeku, duke përkëdhelur vogëlushen.

Nëna pohoi me kokë dhe i buzëqeshi së bijës.

- Është kujdesur shumë për të vëllanë, doktor. Edhe tani që erdhëm për vizitë s' donte të ndahej nga ai.

- Ti je kujdesur më shumë, - vërejt i vogëlushja. S' ke fjetur fare. Shih si të janë skuqur sytë!...

Nëna buzëqeshi. Ndërkohë mjeku vizitonte të voglin. Kur mbaroi vizitën, fytyra e tij shndriti.

- S' e prisja një shërim kaq të shpejtë! – tha ai. – Ilaçet kanë bërë punën e tyre, por shërimin e kanë shpejtuar dashuria dhe kujdesi juaj i madh.

Vera s' e përmbajti dot gëzimin. Iu hodh në qafë të vëllait dhe e puthi fort, plot dashuri.

Flamur Topi



BISEDË RRETH TEKSTIT

Për se bëhet fjalë në tregim?

Cili kujdesej më shumë për Benin e sëmurë?

Ç'kupton nga ky tregim?

Që t'i përgjigjesh drejt kësaj pyetjeje, lexoi edhe njëherë fjalët që i tha mjeku në fund.

Ç'kuptim kanë këto fjalë: “E pyeti me zë të ëmbël”.



DETYRË

Ritrego ngjarjen sipas katër pikave të këtij plani.

Njohim gjuhën tonë

PËREMRRAT VETORË

Lexoni tekstin e mëposhtëm dhe tregoni në vend të cilëve emra janë përdorur fjalët e shkruara me shkronja më të zeza: Tërë ditën Vera i qëndroi te koka të vëllait të sëmurë. Mësonte aty pranë tij. Sa herë që Benit i duhej diçka, **ajo** ia plotësonte në çast.

Ajo i tregonte edhe përralla të bukura, që e kënaqnin aq shumë Benin edhe nganjëherë e bënin edhe të qeshte. Kaluan pesë ditë. Tanimë Arbeni i vogël e ndjente veten shumë mirë. Sa u gëzuan prindërit dhe motra! **Ata** mezi prisnin që **ai** të dalë sa më shpejt nga spitali.

Fjalët **ajo, ata, ai**, zëvendësojnë emrat **Verë, prindër** dhe **Ben**, janë **përemra**.

Përemrat unë, ti, ai, ajo, ne, ju, ata, ato quhen përemra vetorë.



USHTRIME

Lexoni tekstin e mëposhtëm dhe gjeni përemrat vetorë.

Ylberi me Valonin përgatitnin mësimin.

- Oh! – tha Ylberi. Unë e lexova një herë mësimin edhe e kuptova. E ç`më duhen të gjitha këto. Mjafton që i di rasat e emrit. Me kaq marr një pesë.

- Pse, për të marrë një pesë mëson ti? – e pyeti i çuditur Valoni. Këto që mëson sot në shkollë, a nuk të duhen për më vonë në jetë?

Pastaj ai vazhdoi:

- Ne duhet të mësojmë për të fituar dituri e jo për nota.

- Fjalët **unë, ti, ne, ai**, janë përdorur në vend të emrave **Ylber** dhe **Valon**.

Fjala unë tregon vetën e parë, njeriun që flet.
Fjala ti tregon vetën e dytë, njeriun të cilit i drejtohet folësi.
Fjala ai tregon vetën e tretë, njeriun për të cilin flitet.



MBANI MEND

Fjalët që zëvendësojnë emrat quhen përemra.
Fjalët që tregojnë vetat quhen përemra vetorë .

Përemrat vetorë kanë tri veta në njëjës dhe në shumës.

Pasqyra e përemrave vetorë

| Njëjës | | Shumës |
|--------------|---------|----------|
| veta e parë | unë | ne |
| veta e dytë | ti | ju |
| veta e tretë | ai, ajo | ata, ato |

Përemri vetor unë shkruhet me **ë** në fund.
Përemri i vetës së parë shumës shkruhet **ne**.
Përemri i vetës së tretë njëjës shkruhet **ai**.



USHTRIME

1. Zëvendësoni emrin ose grupin emëror me përemrat : ai ,ajo.
Lejleku është një shpend shtegtar.
Dallëndyshja e vogël shkon në vendet e nxehta.
Trumcaku i vogël mbetet këtu.
Një qukapik fluturoi në follenë e dallëndyshes.
Zana e vogël i ushqen zogjtë e uritur.

FJALA ËSHTË E VOGËL SHUMË

Fjala është e vogël shumë:
disa shkronja, disa rrokje...
Ajo rrjedh si mjaltë e qumësht
midis miqve, midis shokëve.

Fjala është e vogël shumë:
dhe e ashpër, dhe e brishtë...
I ngre valët perçeshkumë,
kur vërsulet mbi armiqtë.

Fjala është e vogël shumë:
t' ëmbëlson a vret si plumbi...
Fjala është si një urë
që lidh brigjet e një lumi.

Odbise Grillo



FJALË DHE SHPREHJE

e brishtë – që thyhet, thërrmohet lehtë
perçeshkumë – që ka valë të shkumëzuara, valëshumë, e dallgëshumë
vërsulet – turret a lëshohet, kërcënon dikë



BISEDË RRETH VJERSHËS

Si është fjala midis miqve dhe shokëve?
Po fjala ndaj armikut?
Ç'kuptim kanë fjalët “dhe e ashpër, dhe e brishtë”?



DETYRË

Lexojeni vjershën dhe bisedoni rreth strofës së fundit!

VAJZA E PANJOHUR

Një vajzë shpeshherë e përshëndeste me nderim detarin e vjetër, pensionistin Braho Buna. Ajo e përshëndeste me aq përzemërsi, sa plaku s' kishte si mos ia kthente përshëndetjen. Xha Brahua nuk e njihte fare dhe shpesh e kishte vrrarë mendjen se ku e kishte parë, nga e njihte ajo, por s'e kishte gjetur dot pse e përshëndeste me aq ngrohtësi.

Një të diel, në lagjen ku jeton dhe detari, nisi një punë vullnetare. Xha Brahua hodhi në sup një lopatë dhe u nis që pa gdhirë. Dhe ja, nga një rrugicë i doli përpara vajza e panjohur. Në sup kishte një kazmë, tehu i së cilës ndriste nga rrezet e para të diellit. Vajza u skuq dhe, duke përkulur kryet me nderim, tha:

- Mirëmëngjesi!

- Mirëmëngjesi, bija ime, - ia ktheu plaku.

Vajza u afrua dhe ia dha dorën.

- Nuk po më njihni?! – pyeti ajo.

- Eh, të them të vërtetën, kemi kohë që përshëndetemi, po unë ende nuk të sjell ndër mend se ku të kam parë, - tha detari plak.

- Ne njihemi prej kohësh, - tha vajza.

Dhe duke ecur rrugës, vajza nisi të tregonte.

- Unë isha nxënëse në shkollën fillore. Bashkë me shokët e shoqet e shkollës do të bënim një shëtitje nëpër det. Në mëngjes u zgjova vonë. U veshja shpejt e shpejt dhe vrapova për në port, nga ku do të bëhej nisja. Sirena e anijes po oshëtinte. Të gjithë nxënësit e shkollës ishin mbi të dhe po këndonin. Menjëherë anija lëvizi nga vendi dhe u nis. Unë mbeta në breg vetëm, e hutuar dhe thërrisja:

- Ndaluni, ej, ndaluni!

Një detar, që kaloi pranë meje, më tha të mos thërrisja kot, se nuk mund të ndalej anija për një njeri. E dëshpëruar po bëhesha gati të

kthehem kur, për çudi, m'u duk sikur anija u ndal. Prej saj u shkëput një sandall dhe filloi të vinte drejt bregut. Zemra sa nuk më fluturoi nga gëzimi. Sandalli po i afrohej bregut. Një detar me shtat vigan u hodh në tokë dhe u drejtua nga unë.

- Pse erdhe kaq vonë, moj vajzë? – më pyeti.

Unë s' dija ç'të thosha dhe ula kokën e turpëruar.

Detari, duke qeshur, më tha:

- Ne u ndalëm për të marrë ty. Anijen e ndalëm disa minuta, por kohën e humbur, moj bijë, nuk e kthejmë dot.

Pastaj, duke më përkëdhelur kokën, tha:

- Të jetë hera e fundit që nuk i përmbahesh orarit.

I hipëm sandallit dhe shkuam në anije. Isha shumë e tronditur. Shokët dhe shoqet më pritën me buzë të varura. Kishin të drejtë. Në vesh më dukej se më kumbonin ende fjalët: “Të jetë hera e fundit që nuk i përmbahesh orarit!”

- Po, - thosha me vete, - do të jetë hera e fundit. Të jap fjalën!

Dhe ashtu bëra. Kurrë nuk shkova vonë gjëkundi...Por edhe atë fytyrë të dashur të detarit nuk e kam harruar... A ju kujtohet?

- Tani më kujtohet, tha xha Brahua. – Sa qenke rritur, moj bijë!

Dhe unë vrisja mendjen gjithnjë dhe thosha me vete:

“Ku e kam parë këtë vajzë?”

Javer Karalliu



FJALË DHE SHPREHJE

e kisha vrrarë mendjen – e lodha mendjen
pa gdhirë – pa aguar, herët në mëngjes
sandal – kajak uji, barkë
shtat vigan – trupmadh



BISEDË RRETH TEKSTIT

Përse bëhet fjalë në tekst?
Kush përshëndeste çdo mëngjes detarin?
Ç'ndodhi me shëtitjen në det?
Pse s'u ndal anija?

Si veproi detari xha Braho?
Me cilat fjalë e qortoi detari vajzën?



DETYRË

Shkruani dy fjali që porositi xha Brahua?



Njohim gjuhën tonë

FOLJA

Ditë maji

Zalli **shkëlqen**
Drita zë **gdhihet**,
Drita po **vjen**,
Mjegulla **ngrihet**.
Djemtë me gas
Udhës **këndojnë**,
Çupat më pas
Tufat **lëshojnë**.
Ëmbël **tingëllon**
Dashit këmbora,
Malit ku **shkon**
Flakë si dëbora.

Asdreni

Ç'kuptojmë me fjalët e shkruara me ngjyrë të zezë?
Ç'emërtojnë ato?



MBANI MEND

Fjalët që emërtojnë një veprim, një punë a një ndodhi ose të qenë quhen folje. Për ta gjetur foljen bëjmë pyetjen ç'bëj?

Dalloni grupin foljor në këto fjali:

1. Livadhet gjelbërojnë për bukuri.
 2. Fluturat krahëshkruara fluturojnë lule më lule.
- Marinarët lundrojnë në det.



MBANI MEND

Pjesa kryesore në grupin emëror është emri (kryefjala) kurse në grupin foljor është folja (kallëzuesi, ose fjalët që emërtojnë veprim).

KOHËT E FOLJES

Ky djalë do të kërcejë.

Ky po kërcen.

Ky ka kërcyer.

Ky zog do të fluturojë. Ky po fluturon. Ky ka fluturuar.

- Genc, ç'bën ashtu?

- Po **lexoj** një libër me tregime.

- Po nesër **ç'do të bësh?**

- Nesër **do të shkoj** te gjyshja. Atje **do të ndihmoj** në vjeljen e pemëve.

- E ti **ç'do të bësh?**

- Unë **do të shkoj** në teatër me motrën.


- Sigurisht **do ta shohësh** atë pjesë që e **kam parë** unë.

Një punë, një vprim a një ndodhi mund të ndodhë në një kohë të caktuar. Tregoni se në ç'kohë bëhen veprimet që janë shprehur me fjalët e shkruara me shkronja të zeza. Bëni pyetjen – KUR? dhe përgjigjuni duke e përcaktuar kohën me fjalët; së shpejti (nesër); dje (para ca kohësh).



MBANI MEND

Një veprim mund të bëhet (të ndodhë) në kohën e tashme, në kohën e ardhme dhe në kohën e shkuar. Pra, folja ka tri kohë kryesore: kohën e tashme, kohën e ardhme dhe kohën e shkuar.



USHTRIME DHE DETYRA

1. Lexoni këtë tekst, dalloni foljet dhe tregoni se në cilën kohë janë.

Kur Valoni lëviz telat e kitarës, ata lëshojnë një zë të ëmbël. Ai po luan në kitarë. Agroni i vogël kënaqet kur e dëgjon.

KOHA E ARDHME

2. Shndërroni këtë tekst në kohën e tashme.

Nesër grupi artistik do të japë një shfaqje. Agimi do të dalë për herë të parë në skenë. Ai do ta ndiejë veten të shqetësuar. Agimi do t'i vazhdojë provat. Zëri i tij i ëmbël është herë i lartë e herë i ulët.

3. Shndërroni këtë tekst në kohë të kaluar

Perdja hapet. Një vajzë del përpara shikuesve dhe shpall programin. Pas pak këndon kori. Djemtë dhe vajzat duken të qetë. Ata këndojnë dy këngë popullore. Salla kënaqet nga zërat e fuqishëm të fëmijëve.

4. Nga kjo tabelë formoni 5 fjali në kohën e tashme, 5 fjali në kohën e ardhme dhe 5 fjali në kohën e kaluar.

Një djalë i vogël (ndalem) para një librarie..
.....vajzë e (qëndroj) pranë.
(shikoj) te një vitrinë plot me lodra.
Disa djem të vegjël (vrapoj) një fushë të gjerë.
Vajza të vogla (lexoj) një libër shumë interesant.
Kini kujdes në lidhjet e pamundshme.

5. Lexoni këto fjali dhe tregoni se kush flet, me kë flet dhe për kë flet (flitet).

Unë do të kërcej. Ti do të luash me top.
Ajo do të luajë me kukull.

Ne po luajmë me top. Ju luani me kukulla.
E ata le të kërcejnë.

Kush mund të bëjë një punë a një veprim?
Për kë mund të flasim në një fjali?

Personi që flet Personi me të cilin flasim Personi për të cilin flasim
është veta e parë. është veta e dytë. është veta e tretë



MBANI MEND

Folja ka tri veta: vetën e parë, vetën e dytë dhe vetën e tretë njëjës dhe shumës.

6. Shkruani në vetën e parë të numrit shumës këto fjali.

| | |
|--|----|
| Unë | Ne |
| Unë luaj me top..... | |
| Unë u ndihmoj prindërve të mi..... | |
| Unë mbledh lule për nënën time..... | |
| Unë kam dëshirë të madhe të lexoj..... | |

| | |
|----------------|--------------|
| Unë shko-j | Ne shko-jmë |
| Ti shko-n | Ju shko-ni |
| Ai shko-n | Ata shko-jnë |
| → në shkollë ← | |

Tregoni me se mbaron folja shkoj në vetën e parë, të dytë dhe të tretë të numrit njëjës dhe shumës.



MBANI MEND

Folja pëson ndryshim në vetë dhe në numër. Ndryshimi që bën folja sipas vetave (në numrin njëjës dhe në numrin shumës) quhet zgjedhim.

1. Bashkoni fjalitë sipas shembullit të dhënë.

P.sh. Unë shkoj në shkollë. Ajo shkon në shkollë. Ne shkojmë në shkollë.

Unë shikoj një emision televiziv. Ti shikon një emision televiziv.

Ju përgatiteni për mësim. Ajo përgaditet për mësim.

Ai është punëtor i mirë. Ajo është punëtore e mirë.

Unë e dua mëmëdhenë. Edhe ata e duan mëmëdhenë.

Unë kam lexuar shumë ngjarje për fëmijët e vendeve të ndryshme.

Ti ke lexuar shumë ngjarje për fëmijët e vendeve të ndryshme.

2. Shkruani këto fjali në kohën e ardhme, sipas këtij shembulli:

Unë punoj në një restorant të madh.

Unë do të punoj në një restorant të madh.

Ju i bëni detyrat e shtëpisë në kohë.

Ai zgjedh një palë rroba të mira..

Ajo gjen shumë kërpudha.

Unë e zë shokun tim për dore.



KUR UDHËTOJMË

Jeta e njerëzve nuk është e mundshme pa lëvizje prej një vendi në një vend tjetër. Disa shkojnë në punë, disa të tjerë shkojnë në miqësi, në vizita dhe ekskursione, teatër, kinema etj. Nxënësit shkojnë në shkollë... Shumë herë njerëzit shkojnë në këmbë, por kur dubet të shkobet në ndonjë vend të largët, atëherë nevojitet mjet udhëtimi.

Mjetet e udhëtimit janë të ndryshme: për njerëz dhe për bartjen e mallrave. Disa mjete udhëtimi qarkullojnë në tokë, kurse disa në ujë dhe në ajr.

Kujdes! Kur udhëtoni me autobusin e qytetit, trolejbus ose tramvaj, mos harroni:

Të pritni në radhë!

Të hipni dhe të zbritni pa u shtyrë!

T'ju lironi vend njerëzve të moshuar!

Bisedoni ngadalë dhe mos i pengoni të tjerët!

A mund të tregoni se cilat mjete udhëtimi qarkullojnë në tokë, cilat në ujë e cilat në ajër? Si quben ata njerëz që i drejtojnë këto mjete udhëtimi në vendbanimin tënd?

- Me çfarë mjete udhëtimi ke udhëtuar deri tash?...



LUMI U BË DRITË

Qe një lumë i madh,
Lumë me ujëra shumë;
Por përtac na ishte,
S'bënte asnjë punë.

Sa her' binin shirat,
Shtrihej gjerë e gjatë,
Dëmtonte të mbjellat,
Derdhej fushës larg.

Por një dit' punëtorët,
Lumin e sulmuan
Dhe mbi shtrat të tij,
Një digë ndërtuan.

Lumi tha me vete:
“ Kush po më pengon?
Ç' është kjo kala
Që po më rrethon?”

Edhe menjëherë,
Ra në katarakt,
Digën e pandehu
Si kullë të lartë.

Unë s'jam kala,
As kull' me bedena,
Vallë ku ke parë
Kështjella me tela?

Ti ke krah' të fortë,
Kraharor të gjerë;
Për shekuj me radhë
Asgjë nuk ke bërë.

Po shtrohu njëherë,
O lumë i tërbuar;
Mbi turbina bjer
Duke i rrotulluar.

U mendua lumi,
Lumi leshrashkumë,
U mendua pakë,
S'u mendua shumë.

Buçiti plot valë,
Ngjiti ujërat lart,
Ra përmbi turbina
Poshtë në katarakt.

Punoi nat' e ditë,
Ky lumi vigan
Dhe shpërndau dritë
Fshattrash anë e mbanë.

Kjo nuk është përrallë,
Kjo është e vërtetë,
Ju hidrocentralin
E kini parë vetë.

Frederik Reshpija



FJALË DHE SHPREHJE

digë – pendë

turbinë – një rrotë që lëviz elektromotorët



BISEDË RRETH VJERSHËS

- Si vepruan punëtorët?
- Si mund ta shfrytëzojmë ujin e lumit?
- Ç'mendoni si fitohet rryma elektrike?
- A kemi dobi nga hidrocentralet?



DETYRË

Ritregoje vjershën me fjalët tua, duke shtuar hollësira të tjera për ndërtimin e ndonjë hidrocentrali të afërm.



Njohim gjuhën tonë

KOHA E KRYER E THJESHTË

Lexoni me vëmendje paragrafin e parë të tekstit dhe vëreni fjalët e shkruara me të zeza. Ç` tregojnë ato?

Sa e mërzitur dukej atë ditë Vera! Gjatë katër orëve të mësimit s'e **pa** njeri të qeshë. Kishte lënë Arbenin, vëllanë më të vogël, të sëmurë, prandaj ishte mërzitur. Kur **tingëlloi** zilja e orës së fundit **doli** e para nga klasa dhe **shkoi** shpejt në shtëpi.

- Nënë, si **u bë** Beni?- **e pyeti** nënën me një frymë.

Fjalët s`**pa**, **tingëlloi**, **doli**, **shkoi**, **u bë** dhe **pyeti** janë folje në kohën e kryer të thjeshtë. Tregojnë një veprim që është kryer në të kaluarën.

Gjeni dhe shkruani në fletore foljet e tjera të paragrafit të dytë në këtë tekst.

FOLJET jam dhe kam NË KOHËN E KRYER TË THJESHTË

Lexoni tekstin e mëposhtëm dhe vëreni fjalët e shkruara me shkronja të zeza.

Naim Frashëri **qe** atdhetar dhe poet i shquar. Tërë jetën **punoj** për të mirën e popullit shqiptar. Të gjithë e donin shumë jo vetëm se **qe** i ditur, po edhe se **qe** i dashur me të gjithë. Njerëzit e thjeshtë e **patën** mikun më të afërt.

Fjalët: **qe**, **punoj**, **patën** janë folje në kohën e kryer të thjeshtë.



MBANI MEND

Veprimi ndodh në kohën e shkuar dhe është i përfunduar.

Më poshtë po zgjedhjmë foljet **kam** dhe **jam** në kohën e kryer të thjeshtë.

| | kam | jam |
|----------|------------|------------|
| Unë | pata | qeshë |
| Ti | pate | qe |
| Ai, ajo | pati | qe |
| Ne | patëm | qemë |
| Ju | patët | qetë |
| Ata, ato | patën | qenë |

1. Lidhni me shigjetë dhe shkruani zgjedhimin e foljes jam në kohën e kryer të thjeshtë.

| | | |
|-----------|---------------------------------|-------------------|
| Unë | qemë të gjithë të gëzuar. | Unë qeshë - _____ |
| Ti | qetë në Kongresin e Manastirit. | _____ |
| Ai | qe i pari në garat sportive. | _____ |
| Ne | qeshë në Prespë. | _____ |
| Ju | qenë nxënës të mirë. | _____ |
| Ata (ato) | | _____ |

2. Vini foljet në kllapa në kohën e kryer të thjeshtë.

Njëherë një baba (kam) tre djem. Djemtë (jam) të rritur. Ai (jam) i sëmurë dhe i thirri djemtë pranë shtratit.

Drita (jam) infermiere e mirë. (Jam) e vendosur dhe (kam) zemër të fortë. Shokët (kam) respekt për këtë vajzë trime.

Zgjedhoni foljen kam në kohën e kryer të thjeshtë.



DREJTSHKRIM

Folja kam në vetën e parë dhe të tretë shumës shkruhet me **ëm, ën** në fund (patëm, patën). Ndërsa folja jam në vetën e parë njëjës dhe në të tria vetat e shumësit shkruhet me **ë** në fund (qeshë, qemë, qetë, qenë).

DY DHITË

Përrallë

Dy dhi, duke kullotur një herë në një mal të lartë, hasën në një udhë fort të ngushtë. Udhë ishte aq e ngushtë sa mezi kalonte njëra prej tyre. Por edhe të kthehesh prapa ishte e pamundur. Nga ana e sipërme e udhës ndodhej një shkrep guri i lartë. Kurse nga ana e poshtme e udhës, ndodhej një rrëpirë e thellë.

Ç'thoni ju, si vepruan dy dhitë?

Njëra prej tyre u ul në gjunjë ngadalë, duke u mbështetur mirë pas shkëmbit të gurit. Kurse dhia tjetër kaloi me kujdes të madh, mbi kurrizin e shoqes së vet, që rrinte ulur në gjunjë dhe doli në anën tjetër.

Kështu, të dy dhitë shpëtuan dhe morën udhën e vet, duke kullotur gjethë të egra nëpër ato kodra.

Dy dhi të tjera, duke kullotur nëpër disa kodra, u puqën në buzë të një përroi të rrëmbyeshëm. Përmbi atë përrua ndodhej një vig për të kapërcyer matanë ujit.

Dhitë vështruan njëra-tjetrën në sy. Secila prej tyre dëshironte të kalonte para shoqes. Ato qëndruan një copë herë me një këmbë në buzë të përroit dhe me këmbën tjetër mbi vig, duke pritur njëra – tjetrën që t'i lëshonte vendin për të kaluar. Por asnjëra nuk lëshoi rrugë.

Atëherë u nisën që të dyja gjer në mes të vigut të ngushtë dhe filluan të zihen e të shtyjnë me brirë njëra-tjetrën, gjersa rrëshqitën të dyja, ranë në përrua dhe u mbytën në ujë.

Po t'i kishin lëshuar udhë njëra-tjetrës, të dyja do të kishin shpëtuar.

Kristoforidhi



FJALË DHE SHPREHJE

shkrep guri – shkëmb guri

rrëpirë e thellë – vend i thellë

vig – dru mbi lumë

u poqën – u takuan

buzë një përroi – pranë një përroi




BISEDË RRETH PËRRALLËS

Si vepruan dy dhitë e para për të kaluar shkëmbin?

Po dy dhitë e tjera çfarë bënë?

Ç'u ndodhi atyre, pse?

Si duhet vepruar?



SHQIPONJA

Njëherë një shqiponjë e kishte ndërtuar folenë në majë të një peme të madhe, jo larg bregut të detit. Kishte aty edhe zogjtë e vet.

Një ditë, nën pemën ku ndodhej foleja, u mbledhën disa njerëz për të pushuar. Atë kohë shqiponja po kthehej në fole me një peshk të madh në kthetra. Njerëzit, porsa e panë, e rrethuan pemën dhe filluan të thërresin e ta gjuajnë shqiponjën me gurë.

Shqiponja e lëshoi peshkun në tokë. Njerëzit, sapo ra peshku, e morën dhe ikën.

Shpendi i lodhur u ul në kënd të folesë, ndërsa zogjtë e vegjël filluan të ngrenë kokat dhe të hapin gojën. Ata të shkretët i kishte marrë uria. Po mama ishte lodhur aq shumë, sa nuk kishte më fuqi të fluturonte deri në breg të detit. Prandaj u ul mirë dhe mbuloi me krahë zogjtë e saj të vegjël. Pastaj filloi t'i ledhatojë me pendë. Sa më shumë i ledhatonte, aq më shumë ata thërrisnin.

Atëherë shqiponja u ngrit dhe fluturoi në majë të pemës. Zogjtë vazhdonin të thërrisnin më shumë dhe me zë të dhimbshëm.

Nëna e tyre briti njëherë: “Krëk... krëk”, pastaj hapi krahët dhe u nis drejt detit.

Shqiponja nënë u kthye vonë në mbrëmje. Fluturonte ngadalë dhe shumë afër tokës. Në kthetra mbante prapë një peshk të madh.

Kur iu afrua pemës, ku gjendej foleja, vuri re me kujdes se mos kishte përsëri njerëz. Kur pa se nuk kishte, uli krahët dhe u ndal në folenë e saj.

Zogjtë e vegjël ngritën kokat dhe prisnin gojëhapur që t'i ushqente e ëma. Atëherë shqiponja filloi ta copëtojë peshkun dhe t'i ushqejë të vegjlit.

Leon Tolstoj



FJALË DHE SHPREHJE

kthetra – thonjtë e fortë e të mprehtë të kafshëve e të shpendëve rrëmbyes

t'i lehdatojë – t'i marrë me të mirë, t'i përkëdhelë

me zë të dhimbshëm – me zë që të vinte keq ta dëgjosh



BISEDË RRETH TEKSTIT

Pse i quajmë njerëz pa zemër ata që ia morën peshkun nënës shqiponjë?

Pse shqiponja mori prap një rrugë të largët deri në breg të detit?

Me çka e krahason ti dashurinë e madhe të shqiponjës për zogjtë e saj?

Ç'titull tjetër i kishe vënë ti këtij tregimi?



DETYRË

Përkruani një shqiponjë që keni parë.



ASTRONOMI I VOGËL

Një natë, dy burra trokitën në portën e shtëpisë të një fermeri të varfër, duke thërritur:

“Ju flini, ndërsa djali juaj endet natën nëpër rrugë!”

Fermeri u ngrit nga shtrati dhe hapi portën. Para tij qëndronin dy burra, të cilët vinin nga një kodrinë e vogël aty pranë...

Ndërkaq ulur mbi një gur, djali i vogël i fermerit vështronte me ngulm qiellin.

“Zbrit që andej!” i thërriti babai vogëlushit. “Çfarë bën atje natën?”

“Baba, të lutem mos më qorto, por vështro qiellin njëherë. A i shikon yjet lart sa të bukur janë? Unë po studjoj yjet dhe i njoh të gjitha emrat e tyre. Për këtë, mund të pyesësh edhe mësuesin tim...”

Të nesërmen në mëngjes babai shkoi në shkollë dhe mësoi për habinë e tij të madhe, se me të vërtetë Pjerri, djali i tij i vogël ishte i fortë në lëndën e astronomisë. Por shpesh shokët e tij të klasës talleshin me “astronomin e vogël”.

Një mbrëmje korriku, Pjerri ishte në kopësht me shokët e tij. Hëna ndiçonte në qiell, midis disa reve të bardha të bukura. Për t'u tallur me Pjerrin, njëri nga shokët u tha të tjerëve:

“Si mund të bindemi ne, nëse hëna vrapon përpara këtyre reve apo retë lëvizin prapa hënës? Këtë gjë, sigurisht as i dituri ynë nuk e di.

Shumë i qetë, Pjerri iu përgjigj shokëve:

“Uluni nën këtë pemë këtu pranë dhe ngrini kokën. Hëna qëndron gjithmonë midis këtyre dy degëve, ndërsa retë largohen.”

Që nga ai çast asnjë nga shokët nuk e tallte më Pjerrin, “astronomin e vogël”. A e dini ju se kush ishte ky “vogëlush i ditur”?

Ky ishte astronomi i ardhshëm Pjerr Gasend.

*Përshtatur nga
Elta Deveja*



FJALË DHE SHPREHJE

astronom – njeri që merret me vëzhgimin e yjeve



BISEDË RRETH TEKSTIT

Ku shkante natën astronomi i vogël dhe ç'bënte atje?
Dy burrat çfarë i thanë fermerit, babait të djalit Pjerr?
Babai i tha ç'bën aty djalë; si iu përgjegj djali?
Pse talleshin shokët me astronomin e vogël?
Kush ishte astronomi i vërtetë?



SHKOPI MAGJIK

Ishte mëngjes. Klaudi i vogël luante para derës së shtëpisë. Rrugës, i kërrusur e duke u mbështetur për shkopi, ecte plaku me syza të praruara. Afër derës lëshoi shkopin. Klaudi që gjendej aty e mori atë dhe ia ofroi plakut. Ky qeshi duke i thënë: - Të falemnderit! Mua ky shkop nuk më duhet. Unë mund të gjendem mjaft mirë edhe pa të. Mbaje për vete po deshe.

Dhe shkoi duke mos pritur përgjigjen. Klaudi mbeti me shkop në dorë, duke mos ditur se ç' të bëj me të. Qe një shkop druri me këryle lartë e në pjesën e poshtme me maje metali. Asgjë të panatyrshme nuk kishte në të.

Klaudi i ra dy herë tokës me shkop dhe pastaj i hipi si të jetë ndonjë kalë druri. Dhe menjëherë u gjend mbi një pelë të zezë me yll të bardhë në ballë. Kali hingëlloi dhe me vrap mësyri oborritin derisa nga thundrat e tij shpërthenin shkëndija.

Kur zbriti nga kali ishte pak i frikësuar. Shkopi përsëri iu bë i zakonshëm. Në të s'kishte as thundra, as jele – ishin vetëm maja e metalit dhe dorëza kryle e shkopit.

“E çka tani të provojmë” – mendoj Klaudi.

Ai përsëri i hipi shkopit. Kësaj here shkopi u shndërrua në deve të bukur me dy gunga. Kurse oborri iu shndërrua në shkretëtirë të madhe. Por, Klaudi nuk u frikësua. U mundua ta gjejë oazën, vend ku ka ujë e blerim. “Ky është shkop magjik – tha Klaudi dhe për të tretën herë hipi në të. Tani ngiste automobil të kuq sikur të ishte në shtegun e vrapimeve. Prej anash dëgjoheshin bërtimat e simpatizuesve. Klaudi arriti i pari në cak.

Pastaj, shkopi u shndërrua në anije kozmike ndërsa oborri – në liqe të gjelbër dhe të gjatë. Klaudi u gjend në anijen kozmike dhe pas vetes linte gjurmë yjesh.

Sa herë që Klaudi lëshohej në tokë, shkopi e merrte pamjen e vet të rëndomtë: me krylen dhe majen e metaltë.

Në lojë kaloi shpejt dita. Në mbrëmje Klaudi përsëri e takoi plakun, por në të asgjë nuk hetoi: plak i rëndomtë, pak i lodhur nga rruga e gjatë.

A të pëlqeu shkopi – e pyeti plaku atë?

Klaudi mendoi se plaku do ta marrë shkopin, prandaj i skuqur ia zgjati atë duke i thënë:

- Të falemnderit!

Por, plaku e lëkundti kokën duke i thënë: mbaje për vete. Ç' më duhet mua tani ai shkopi?

Ti me të mund të fluturosh, kurse unë vetëm mbahem.

Shkoi i buzëqeshur sepse në botë s'ka njeri më të lumtur se ai që fëmijës i dhuron diçka.

Xhani Rodari



SHËNIM

Brenda vetëm një dite shkopi magjik u shndërrua në kalë, në deve, në automobil, në anije motorike, por ai në asnjë çast nuk ndryshoi. Mbeti shkopi i njejtë. Edhe oborri mbeti oborr. Ty me siguri të kujtohen edhe kuajt e fëmijërisë prej shkopi. Në çka të shndërroheshin ty ata?



BISEDË RRETH TEKSTIT

Pse shkopi në duart e plakut nuk dukej magjik?

Pse themi fëmijët fantazojnë dhe luajnë, kurse të rinjtë kur fantazojnë edhe krijojnë?

Pse në fund u gëzua aq shumë plaku?

Gjë e gjëzë:

Ikën e ikën e të lodhur s'ka
e bën gjurmën sa një para.

Shkon, shkon, e bën gjurmën
sa një napoleon.
(bastuni)

DY BALONAT

Përralla jonë këtë herë tregon për dy balona prej letre që dolën në një oborr të madh një ditë pranvere dhe u ngjitën lart në qiellin e kaltër.

Dy balonat megjithëse dukeshin njësoj ndryshonin shumë nga njëra-tjetra: ato ishin të bëra me kallama, të veshur me letër të hollë dhe kishin bishta të gjatë dhe terezitë i kishin shumë të mira, por, siç thamë, ndryshonin shumë njëra nga tjetra. E para, balona me letër të kuqe dhe ca shirita të bardhë, kishte dëshirë të fluturonte lartë dhe nuk u trembej lartësive; kurse e dyta, balona me letër të verdhë, nuk kishte guxim të ngjitej lart, por fluturonte ulët.

E kështu pra duke u ngjitur dy balonat po fjaloseshin:

- E bukur, por sikur fryn shumë erë – u përgjigj tjetra.

- Aq më mirë. Era të ngre më lart.

- Jo unë nuk vij më lart. Ti shko po të duash. Unë po qëndroj këtu, - tha balona me letër të verdhë.

- Pse tregohesh kaq e frikëshme? – i tha balona e kuqe. – Duhet të jesh më e guximshme. Shiko sa i bukur është qielli sa i pastër, e, po të ngjitemi më lart, do të na dalë një panoramë më e bukur.

Balona e verdhë u mendua disa çaste dhe pastaj tha:

- Jo, jo, pse të rrezikohem kot! Ç'më duhet të ngjitem aq lart! Më mirë rri këtu pranë tokës. Unë nuk e marrë vesh se çfarë kënaqësie provon ti duke fluturuar aq lart.

Balona e kuqe vuri buzën në gaz dhe tha:

- Habitem se si flet kështu. Ti je e ngjashme me mua dhe je po aq e madhe dhe e fortë dhe megjithatë ke frikë të fluturosh lart. Pastaj si nuk e kupton se është gjë e bukur të arrish lartësi të reja, të ndjesh më afër diellin, të shikosh zogjtë e të përshëndetesh me ta. Një ditë unë hipa aq lart sa pashë edhe detin që shtrihet përtej qytetit. Sa i bukur

ishte! Sa i madh! Sa i kaltër: aty po lundronin disa anije të mëdha, që çanin valët dhe u binin sirenave. Një herë tjetër më kaloi pranë një helikopter dhe prej tij u hodhën disa vajza me parashutë. E di ti kujt i thonë parashutë?

- Jo – u përgjigj balona e verdhë.

- Si mund ta dish kur rri gjithmonë në një vend, fluturon ulët dhe s'mëson asgjë. Parashutë është një çadër e madhe, herë e bardhë dhe herë me ngjyra, që e hapin njerëzit kur hidhen nga aeroplani dhe zbresin ngadalë. Është gjë e bukur shumë t' i shohësh, të duket sikur në mes të qiellit çelin disa lule të çuditshme të bukura, që zbresin ngadalë nga toka.

Balona e kuqe mbaroi tregimin dhe vuri re se balonës së verdhë i bënë përshtypje fjalët e saj. Priti edhe pak dhe tha:

- E, do të vish lart? Eja, mos ki frikë!

- Jo, jo, sot. Ndoshta ndonjëherë tjetër – u përgjigj balona e verdhë.

Balona e kuqe nuk e priti më shoqen frikamane. Ajo u ngrit drejt qiellit.

Balona e verdhë e ndoqi me sy dhe të themi të vërtetën ia pat zili shoqes së vet trimëreshë, që ngjitej aq lart, por nuk i shkoi pas.

Si kaluan disa minuta, balona e kuqe u ngjit edhe më lart dhe tani dukej e vogël. Balona e verdhë e shihte duke u ngjitur pareshtur, ajo nganjëherë anohej, por shpejt drejtonte trupin dhe prap ecte drejt dhe era e merrte në krahët e veta dhe e çonte gjithmonë lart.

Balona e verdhë duke fluturuar ulët, pa u ngjitur lart, shëtiste nëpër oborr, pastaj era e mori me vete dhe e çoi jashtë oborrit, në mes të një rruge. Ajo u tremb dhe u bë gati të zbresë në tokë. Një shoqe e saj, që po fluturonte sipër shtëpive, i thirri nga lart:

- Mos zbrit se do të mbetesh në telat e telefonit. Ngjitu lart edhe eja tek unë. Këtu është mirë dhe nuk ka rrezik.


Por balona e verdhë u tremb dhe nuk pati guxim të ngjitej lart. Ajo zuri të ulej. Por nuk vonoi dhe papandehur u përplas pas një gjëje të

fortë. Bishti iu ngatërrua dhe iu bë kutullaç dhe ajo mbeti e varur kokëposht. Kishte ngecur te telat e telefonit.

- Ndhimë! Ndhimë! – thirri ajo e trembur. Por askush nuk iu përgjigj.

Në këtë kohë balona e kuqe fluturonte e lumtur në mes të qiellit dhe shikonte tokën poshtë vetes, shikonte qytetin e bukur me ndërtesa e fabrika, shikonte rrugët plot njerëz, shikonte detin dhe shkëlqente si një pasqyrë. Era e përkëdhelte dhe zogjtë e përshëndetnin me zëret e tyre gazmore.

Gjergj Vlashi





FJALË DHE SHPREHJE

balonë,a – këtu ka kuptimin lodër fëmijësh, që bëhet me letër të hollë të nderë mbi fije kallamash dhe që lëshohet lart në ajër e mbajtur me pe të fortë; tullumbace me ngjyra

kallami,a, - kërcell bimësh i hollë, i gjatë e bosh përbrenda

terezi,a – peshore me dy krahe të barabartë dhe me dy pjata mbi të cilat në njërin vihen gurët e peshës e në tjetrën sendi që peshohet. Këtu - të qenët në rregull e diçkaje, në vendosjen e çdo gjëje si duhet

panoramë – pamja e natyrës që na rrok syri zakonisht kur jemi në një vend të lartë

sirena – pajisje që lëshon tinguj të mprehtë e të vazhdueshëm e që përdoret si mjet për të paralajmëruar diçka

parashutë – mjet prej pëlhure të fortë, të lidhur me litar nëpër cepa, që hapet në ajër si çadër për t'u hedhur nga një aeroplan e për të rënë ngadalë në tokë

pareshitur – vazhdueshëm, pandërprerë

kutullaç – në trajtë rrotullameje, si rreth, kokorreth

vuri buzën në gaz – buzëqeshi



BISEDË RRETH TEKSTIT

Pse balona e kuqe i donte lartësitë?

Pse balona e verdhë u frikësohej lartësive?

Cilin balon do ta shoqëronit ju?

Çka don të thotë shkrimtari me shembullin e dy balonave?

POROSIA

Ne fëmijët
të bardhë,
të verdhë,
të zinj,
njerëzve të mbarë botës
po ua drejtojmë këtë porosi:
bomba atomike
tanksa
dhe topa
NUK DUAM, JO!
Në vend të tyre:
fabrika të reja,
shkolla,
banesa
si dhe shumë ushqim,
lodra e libra
për çdo fëmijë
të ketë kudo!
Atëherë,
bota do të jetë e bukur,
do të ketë lumturi,
Plot gëzim e hare
dhe në çdo zemër
këngë e dashuri...

Dushko Avramov



BISEDË RRETH VJERSHËS

Çfarë nuk don të ketë në botë?
Çka u porosisin fëmijët e të gjitha ngjyrave njerëzve të mbarë botës?
Po çka do të ketë në vend të armëve?
Kur do të jenë të lumtur të gjithë njerëzit e botës?

SHENJA VERE

Erdhën ditët e para të qershorit. Dielli ka filluar të qesë fytyrën e tij të plotë. Dhe pa kursim lëshon tufat e dendura të rrezeve të ngrohta. Fresku i ditëve të majit i lëshon vend zhegut, që merr krahët më me guxim nga dita në ditë.

Bulëzat janë shndërruar në bisqe, gonxhet në lule dhe lulet shndërrohen në kokrra e frut. Kallinjte nisin të zverdhen. Sa e shëndoshë duket fusha! Ajo është e mbarsur nga pjella e re. Prandaj është e begatshme dhe me kraharor të bujshëm.

Çdo gjë merr ngjyrën e verdhë. Ngjyrën e diellit të artë.

Shpezët i kanë pakësuar këngët e tyre. Më të gjalla janë në orët e freskëta të mëngjesit.

Rrugët e fshatit i ka mbuluar pluhuri. Në ato të qytetit shkrihet asfalti. Njerëzit shihen në rrugë rrallë. Fshatarët tërë ditën derdhin djersën nëpër ara. Në mesditë, kur vapa arrin kulmin, nën hijen e kurorave të drunjve pushojnë e gazmohen punëtorët – zbukuruesit e fushës.

Tufat e dhenve, duke vrapuar si të tërbuara, kërkojnë hijet për të mërizur. Buajt zhyten në ujën e hurdhave e jashtë u duken vetëm kokat e zeza.

Lumenjtë dhe përrenjtë s'e kanë gjallërinë e dikurshme. Shtretërit e tyre ngelin për gjysmë të zbrazët. Fushën e molis melodia monotone e gjinkallave, të cilat i thurin lavde ngrohtësisë që fal dielli.

Natyra përjeton ndërrim. Çdo gjë djerëson, zverdhon duke vjedhur ngjyrën e diellit. Fusha përgatitet për drapër e kosë. Për vjelje...

Fejzi Bojku



FJALË DHE SHPREHJE

pa kursim – pa dhimbje
zheg – nxehtësi e madhe
i tërbuar – i egërsuar, pa kontrollë
molisje – lodhje e tepërt, i këputur



BISEDË RRETH TEKSTIT

Autori verën e pikturon si me brushë dhe na jep një tablo të qartë se ç'ndodh në verë.

Si duket moti në verë?

Tregoni si e përshkruan autori në verë natyrën, fshatin, qytetin.

Për se përgaditet bujku në verë?



Njohim gjuhën tonë

PJESËT PLOTËSUESE TË FJALISË

Analizoni dy fjalitë e mëposhtme dhe vëreni si është bërë zgjerimi i tyre.

Djali luan.

Djali i vogël luan.

Djali i madh luan.

Cili djalë?

Djali i vogël i xha Selimit luan.


Djali i madh i xha Selimit luan.

I kujt?

Djali i vogël i xha Selimit luan me qenin. (Me kë?)
Djali i madh i xha Selimit luan me top në oborrin e shtëpisë. (Ku?)

Fjalët: i vogël, i madh, i xha Selimit, që u përgjigjen pyetjeve : Cili (djalë)?, i kujt? të drejtuara kryefjalës, janë pjesë plotësuese të kryefjalës.

Fjalët ose grupet e fjalëve: me qenin, me top, në oborrin e shtëpisë, që u përgjigjen pyetjeve: Me kë?, me se?, ku? etj., që i drejtohen kallëzuesit, janë pjesë plotësuese të kallëzuesit.



USHTRIME

1. Pjesëve kryesore të fjalisë shtojuni fjalë plotësuese.

Molla _____ është e ëmbël.

Ajri _____ pastron mushkëritë.

Këngëtari _____ këndon _____

Fëmijët _____ ndihmojnë _____

Dielli _____ ndriçon _____

Zogu _____ këndon _____

2. Gjeni kryefjalët, kallëzuesit dhe pjesët plotësuese të tyre.
Pulëbardhat e trembura fluturuan në qiell.
Qielli i kaltër u mbush me balonat e fëmijëve .
Dimri i ftohtë po mbaronte .Era e lehtë po lajmëronte ardhjen e pranverës.
Rrugët e fshatit i ka mbuluar pluhuri.



MBANI MEND

Pjesët kryesore mbajnë kuptimin kryesor të fjalisë .
Pjesët plotësuese e plotësojnë kuptimin e fjalisë dhe e bëjnë atë më të qartë.
Pjesët plotësuese mund të jenë të kryefjalës dhe të kallëzuesit.

Ndani këto fjali në pjesë më të vogla. Kini kujdes në ndarjen e tyre.
Fjalja më e vogël patjetër duhet të ketë kuptim .

Edlira e vogël shikon nga dritarja e shtëpisë.
Era e çon lundrën prej letre .
Valmira e shikon me kënaqësi lundrën.
Agroni ka konstruktuar një aeroplan të vogël .
Macja e zezë vrapon pas një miu .

Po këto, a janë fjali?
Bariu kullot.
Peshkatari zë. Pse nuk janë fjali?! Plotësojini me fjalët e duhura.



MBANI MEND

Kemi fjali më të vogël vetëm atëherë kur plotësohet kuptimi i saj.

RENDI I FJALËVE NË FJALI

Lexoni tekstin e mëposhtëm dhe vëreni si janë renditur fjalët në fjali.

Bardhi del në kopsht.

Dielli i ngrohtë ka rënë prapa maleve.

Qetësi...


Fryn zefiri dhe era kalon nëpër fytyrën e Bardhit. E gicilon, sikur do të mahnitet me të

- E bukur je, mbrëmje!- dëgjohet prej dikah.


- Madje shumë e bukur ! – përgjigjet Bardhi, kur ditën e kalon në punë.

Prej sa fjalish është përbërë ky tekst ?

Prej sa pjesësh është e përbërë fjalia e veçuar nga ky tekst?



Kjo fjali përbëhet nga dy grupe kryesore fjalësh: nga grupi i kryefjalës: Dielli i ngrohtë, dhe nga grupi i kallëzuesit: ka rënë prapa maleve. Secili grup ka nga një pjesë plotësuese.



USHTRIME

1. Ndani fjalitë e mëposhtme në grupe fjalësh.
Një zog i vogël fluturoi nëpër fërfëllimë.
Era e furishme fryn kopshteve.

Disa pika shiu trokëllinë mbi xhamat e dritareve.
Puna e mirë lëvdohet prej secilit.

2. Lidhni grupin e kryefjalës me grupin foljor.

| | |
|------------------------|---------------------------|
| Bardhi i vogël | xixëllojnë lart në qiell. |
| Hëna si drapër | fluturon lart në qiell. |
| Aeroplani i udhëtarëve | e kalon kohën në punë. |
| Drini i rrëmbyeshëm | shndrit natën. |
| Yjet e vegjël | bien në tokë. |
| Gjethet e verdha | kalon aty pranë kufirit. |

3. Në këto fjali gjeni grupet e domosdoshme dhe jo të domosdoshme.

Hiqni grupe fjalësh derisa fjalia nuk e humbet kuptimin

Godinat e mëdha e stolisin kryeqytetin tonë.

Zogjtë e vegjël cicërojnë mbi pemë.

Dje pas dite të gjithë shokët shkuan në stadiumin e qytetit.

Nëna e Blertës gatuan gjellë të shijshme.

Si shembull po marrim fjalinë e dytë:

Zogjtë e vegjël cicërojnë mbi pemë.

Zogjtë cicërojnë mbi pemë.

Zogjtë cicërojnë.



MBANI MEND

Fjalët në fjali renditen dhe lidhen në mes tyre sipas rregullave të gjuhës.

Në gjuhën tonë rendi i zakonshëm është ky: Në fillim vjen kryefjala me pjesët plotësuese të saj e pastaj kallëzuesi me pjesët plotësuese të tij. Psh: Gjethet e pemëve bien në vjeshtë. (rend i zakonshëm). Po mund të themi: Në vjeshtë bien gjethet e pemëve. (rend i mundshëm)

Tema për kulturën e medias


RADIOJA JONË E VJETËR

Pothuaj se të gjithë e kishin harruar, përveç gjyshit që dëgjonte lajmet e para të ditës. Të tjerët e kishin televizorin. Radion kish filluar ta mbuloj pluhuri.

Kur gjyshi ishte i ri radioja ishte gjëja më e dashur. Ua tregonte kohën dhe sukseset në ndërtimin e vendit. Atë e donin edhe fëmijët dhe pleqtë. Tregonte përralla dhe tregime. Me valët e saj vinin aktorët e teatrit. Dhe këngët e bukura popullore. Me të këndonte tërë shtëpia. Na ftonte po ashtu në valle dhe në lojë.

Qëndron radioja thuajse e harruar fare. Dëgjohet në veturat dhe autobusët e udhëtimit. Ajo i hidhërohet televizorit, atij që ia mori “bukën”, që përveç zërit ka edhe fotografinë, dhe çfarë fotografie të bukur në kolor që të bën të harrosh detyrat, të mbetesh pa gjumë dhe të vonohesh për në shkollë.

Por, çdo gjë shkon me kohën: e reja ia zë vendin të vjetrës, e cila mbetet në kujtime dhe në muzeume.



Tema për kulturën e medias

DRITARJA E VOGËL E BOTËS SË MADHE



Dritani m'u afrua te veshi dhe më tha se sonte jepet një lojë e madhe ndërmjet Spanjës dhe Shqipërisë. Mësuesi e pa Dritanin, por, kur kuptoi për lojën e futbollit, detyrat e nesërme i shtyu për javën tjetër.

Pas lojës filloi një film frantastiko-popullor. Duke pritur fundin, kaloi gjysma e natës...

Shpesh vonohem në shkollë. Në klasë më mbyllen sytë. Për këtë ka vetëm një fajtor: ajo kutia e bukur para së cilës kalojmë orë të tëra.

Po si mos i dëgjosh përrallat e bukura, të përshkruara me tëra ngjyrat e ylberit, të treguara nga zëri i ëmbël i artistëve?

Po si mos i dëgjosh këngët e festivaleve, të talentëve të rinj që të kënaqin shpirtin?

Po kuizet ku shokët tregojnë çka dijnë dhe deri ku kanë arritur?

Aty, brenda në të, kanë futur çdo gjë! E kanë bërë burim të dijes, argëtimit dhe shoqërimit me njerëzit, botën dhe kohën.

Tema për kulturën e medias

ÇKA ËSHTË FILMI?


Filmi është art që paraqet jetën nëpërmjet imazheve, figurave lëvizëse. Ky është bashkim artesh të ndryshme: letërsi dramatike, art i aktorit, i kinoprojektorit, i pikturës, art i muzikës, etj.

Filmi artistik krijohet nga bashkëpunimi i ngushtë i një grupi artistësh profilesh të ndryshme: **skenaristi** që shkruan skenarin, **aktorët** që interpretojnë rolet e ndryshme, **kompozitori** që krijon muzikën dhe me anë të tingujve zbulon botën e brendshme të personazheve etj., **skenografi** që krijon dekoret, kostumet; operatori që përdor kamerën, etj.

Tërë këtë punë të ndërlikuar e planifikon, e organizon dhe e drejton **kinoregjisori**.

Këto arte të ndryshme nuk ekzistojnë të shkëputura e të ndara. Ato shkrihen në një tërësi të vetme në film dhe kështu formojnë së bashku një art krejt të ri sintetik – kinematografinë.

Filmi shfaqet në sallën e madhe në kinema dhe ka shumë afërsi me artin teatral, por ka edhe ndryshime me të.



Tema për kulturën e medias

TEATRI

Teatër quajmë ndërtesën e bukur ku shkojmë të shohim shfaqje. Në **shfaqjet teatrore** mund të argëtohem dhe të mësojmë gjëra të reja, të cilat luhen nga **aktorët në skenë**. Aktorët japin **shfaqje për të rritur** dhe **për fëmijë**, por edhe për më të vegjëlit japin **shfaqje kukullash**.



Në teatër shfaqen **drama** me përmbajtje të ndryshme, herë qesharake apo **komedi**, herë të rënda e me fund tronditës që quhen **tragjedi**, etj.

Drama është një lloj letrar që shkruhet për t'u shfaqur në teatër. Drama përbëhet nga fjalët që thonë **personazhet** dhe nga të dhënat për skenën, mënyrën si flasin dhe si sillen personazhet etj.

Drama ndërtohet sipas disa **akteve** dhe çdo akt ka një ndodhi. Vetë akti përbëhet nga disa **skena**. Çdo skenë ka një pjesë të ngjarjes që ndodh brenda një akti.

Përveç **personazheve kryesore** në dramë ka edhe shumë **personazhe dytësore** (që plotësojnë tërë ngjarjen).

Tema për kulturën e medias

SHTYPI PËR FËMIJË, GAZETAT, REVISTAT...

Me fjalën shtyp kuptojmë gazetat që çdo ditë na sjellin ngjarje nga largësia, si dhe revistat që dalin për ne. Gazetat mund të jenë ditore ose javore, kurse revistat tona janë mujore, përplot tregime dhe vjersha, materiale interesante dhe zbavitëse...

Unë çdo ditë gjyshit ia blej gazetën “Lajmi”, kurse Drita babit të saj ia blen gazetën “Fakti” ose “Koha”.

Në klasën tonë të katërt vjen revista “Nxënësi”. Motra ime e klasës së dytë e merr revistën e bukur “Yllkat”.

Mësuesja shpesh nga revista na jep ndonjë vjershë, të cilën e mësojmë përmendsh dhe e recitojmë në orën e gjuhës.

Gjyshi gëzohet për lajmet e mira dhe më jep të holla për ndonjë libër ose për akullore. Kur gazeta lajmëron diçka jo të mirë, gjyshi mërzitet dhe e flak gazetën.

Edhe ne dy herë në vit botojmë revistën e shkollës, ku paraqiten gazetarët e rinj dhe poetët që kanë filluar të bëjnë emër.



BIBLIOTEKA



Beni iu lavdërua mikut nga qyteti se jo vetëm shkolla, por edhe fshati i tij kishte bibliotekë të re plot libra, revista e gazeta.

Në pyetjen se çfarë librash kishte në bibliotekën e shkollës, Beni i tha se aty kishte libra me vjersha, me përralla e tregime, romane për fëmijë dhe libra për lexues të rritur. Në bibliotekë tha se kishte nga disa kopje nga të gjitha lektyrat dhe tekstet shkollore.

Beni tha se dallimi ndërmjet bibliotekës së shkollës dhe asaj të fshatit nuk ishte aq i madh. Në bibliotekën e fshatit, Beni tha se ka edhe gazeta për bujq, revista për nëna dhe amvise, dhe libra të tjerë që u nevojiten fshatarëve.

Një ditë shoku nga qyteti e vizitoi bibliotekën e fshatit dhe u habit nga rendi dhe pastërtia në ndërtesën e re për të cilën kishin dhënë para dhe punë vetë fshatarët.

F. Bojku

PËRMBAJTJA

| | |
|--|----|
| SHKOLLA JONË - Fejzi Bojku | 5 |
| DITA E PARË E SHKOLLËS - Edmond de Amiçis | 6 |
| TEKSTI DHE FJALIA | 8 |
| DORA E NJERIUT - Qamil Batalli..... | 10 |
| GJUHA E FOLUR DHE GJUHA E SHKRUAR..... | 12 |
| GJUHA SHQIPE - Naim Frashëri..... | 14 |
| HARTIMI - Rifat Kukaj | 16 |
| SHENJAT E PIKËSIMIT | 18 |
| DEGA E HARDHISË - Sulejman Fuga | 20 |
| DHEU ËSHTË FLORI - Sami Frashëri | 22 |
| NË MANASTIR - Ali Huruglica | 23 |
| EMRI | 25 |
| TRAJTA E EMRIT | 26 |
| GJINIA E EMRIT | 27 |
| NUMRI I EMRAVE | 29 |
| BUKURIA QË VRET - Migjeni | 33 |
| DIALEKTET E GJUHËS SHQIPE | 36 |
| GJUHA STANDARDE | 38 |
| MIKPRITJA SHQIPTARE - Mark Millani | 41 |
| BLETA DHE ARËZA - Alqi Kristo | 43 |
| VEHJA ËSHTË PJESE E MIRËSJELLJES | 45 |
| TRE MJEKËT E MËDHENJ | 46 |
| NDARJA E FJALËVE NË RROKJE..... | 47 |
| NDARJA E FJALËVE NË FUND TË RRESHTIT..... | 48 |
| ZANORET DHE BASHKËTINGËLLORET..... | 49 |
| NË FAMILJEN TONË - Bedri Dedja | 51 |
| Ç'TË MBJELLËSH, DO TË KORRËSH - Tregim popullor..... | 53 |
| NË CIRK - Eva Kiri | 56 |
| TEKSTI DHE PARAGRAFI | 58 |
| MBRËMË BIJA IME - Mehmedali Hoxha | 59 |
| KTHIMI I YMER AGËS - (Legjendë shqiptare) | 61 |

| | |
|---|-----|
| FJALË TË URTA PËR BESËN | 63 |
| BLETË NË MJEKËSI - Ramadan Zejneli..... | 64 |
| KOHA E ARDHME..... | 65 |
| SKËNDERBEUN E DONTE GJITHË POPULLI - Skënder Drini | 67 |
| NË DITËLINDJE | 70 |
| LETËR AGRONIT - Grigor Vitez..... | 71 |
| LUSHI SHPËTIMTARI - Arif Demolli | 73 |
| QENI DHE BESA E TIJ - Naim Frashëri | 75 |
| TRE FËMIJËT - Rrahman Dedaj | 77 |
| AFËR BUSTIT TË HEROIT - Ali Huruglica | 79 |
| ZGJEDHIMI I FOLJEVE kam dhe jam NË KOHËN E TASHME | 81 |
| ALO. FATON, SI JE?..... | 83 |
| MACJA JONË KITI..... | 84 |
| MBIEMRI..... | 86 |
| SINONIMET..... | 89 |
| ANTONIMET..... | 90 |
| MËMË E BIR - Nonda Bulka | 92 |
| KROI I FSHATIT TONË - Lazgush Poradeci | 94 |
| PJESËT KRYESORE TË FJALISË | 96 |
| GRUPI I KRYEFJALËS DHE GRUPI I FOLJES (Kallëzuesit) | 97 |
| DHURATA PËR NËNËN - Xhun Bar (SHBA) | 100 |
| PUTHJET E HUMBURA - Rita Petro | 104 |
| LLOJET E FJALIVE | 106 |
| NA LUSIN MALET - Agim Deva | 108 |
| KLASA E ZBUKURUAR - Qamil Batalli..... | 109 |
| ATDHEU IM - Muhamed Dib | 112 |
| TREGIMI PËR SHIUN - Vidoe Podgorec | 116 |
| JEMI KOPSHTARË - Xhevat Beqaraj..... | 118 |
| NË EKSKURSIONIN SHKOLLOR | 120 |
| FITON MENDJA, JO FUQIA - Tregim popullor | 121 |
| FJALË POPULLORE PËR DITURINË DHE LIRINË..... | 124 |
| DUART MË TË BUKURA | 125 |
| LULJA E PYLLIT - Johan V. Gete | 128 |
| BASHKIMI ËSHTË I NEVOJSHËM EDHE NË LOJË - Perl Bak.. | 129 |
| GËZIMI I VERËS - Flamur Topi | 131 |

| | |
|---|-----|
| PËREMRRAT VETORË | 133 |
| FJALA ËSHTË E VOGËL SHUMË - Odhise Grillo | 135 |
| VAJZA E PANJOHUR - Javer Karalliu..... | 136 |
| FOLJA | 139 |
| KOHËT E FOLJES | 140 |
| KOHA E ARDHME | 141 |
| KUR UDHËTOJMË?..... | 144 |
| LUMI U BË DRITË - Frederik Reshpja..... | 145 |
| KOHA E KRYER E THJESHTË | 148 |
| DY DHITË - Kristoforidhi | 150 |
| SHQIPONJA - Leon Tolstoi | 152 |
| ASTRONOMI I VOGËL - Elta Deveja | 154 |
| SHKOPI MAGJIK - Xhani Rodari | 156 |
| DY BALONAT - Gjergj Vlasi | 158 |
| POROSIA - Dushko Avramov | 162 |
| SHENJA VERE - Fejzi Bojku | 163 |
| PJESËT PLOTËSUESE TË FJALISË | 165 |
| RENDI I FJALËVE NË FJALI..... | 167 |
| <i>TEMA PËR KULTURËN E MEDIAS</i> | 169 |
| RADIOJA JONË E VJETËR | 169 |
| DRITARJA E VOGËL E BOTËS SË MADHE..... | 170 |
| ÇKA ËSHTË FILMI?..... | 171 |
| TEATRI..... | 172 |
| SHTYPI PËR FËMIJË, GAZETAT, REVISTAT..... | 173 |
| BIBLIOTEKA..... | 174 |
| PËRMBAJTJTA | 175 |

FEJZI BOJKU - ZIHNI OSMANI

GJUHA SHQIPE 4

Për botuesin:?

Redaktor gjuhësor: Islam Karanfili

Korrektura: Arta Bojku

Kopertina dhe përshtatja ilustrative: Arta dhe Lira Bojku

Disenji dhe rradhitja kompjuterike: Besnik Hamiti

Shtypi: ???

Boton: firma, adresa, e-mail, tel.

